

ANEKSI 1

RAPORT I ANALIZËS

SË NJËSIVE

TË QEVERISJES VENDORE

NË SHQIPËRI

1	HYRJE	4
2	QARKU BERAT	5
2.1	PROFILI I QARKUT BERAT DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK	5
2.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT BERAT	9
2.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT BERAT	13
2.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN BERAT	15
2.5	PROFILI SOCIAL	21
3	QARKU DURRËS	23
3.1	PROFILI I QARKUT DURRËS DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK	23
3.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT DURRËS	27
3.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT DURRËS	29
3.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN DURRËS	31
3.5	PROFILI SOCIAL	34
3.6	PËRFUNDIME	36
4	QARKU DIBËR	37
4.1	PROFILI I QARKUT DIBËR DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK	37
4.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT DIBËR	42
4.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT DIBËR	44
4.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN DIBËR	46
4.5	PROFILI SOCIAL	49
4.6	PËRFUNDIME	51
5	QARKU ELBASAN	53
5.1	PROFILI I QARKUT ELBASAN	53
5.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT ELBASAN	58
5.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT ELBASAN	62
5.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN ELBASAN	67
5.5	PROFILI SOCIAL	73
6	QARKU FIER	75
6.1	PROFILI I QARKUT FIER DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK	75
6.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT FIER	80
6.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT FIER	82
6.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN FIER	85
6.5	PROFILI SOCIAL	88
6.6	PËRFUNDIME	90
7	QARKU GJIROKASTËR	92
7.1	PROFILI I QARKUT GJIROKASTËR DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK	92
7.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT GJIROKASTËR	97
7.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT GJIROKASTËR	99
7.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN GJIROKASTËR	102
7.5	PROFILI SOCIAL	106
7.6	PËRFUNDIME	108
8	QARKU KORÇË	110
8.1	PROFILI I QARKUT KORÇË DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK	110
8.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT KORÇË	114
8.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT KORÇË	116
8.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN KORÇË	119

8.5	PROFILI SOCIAL.....	124
8.6	PËRFUNDIME.....	126
9	QARKU KUKËS.....	128
9.1	PROFILI I QARKUT KUKËS DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK.....	128
9.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT KUKËS.....	132
9.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT KUKËS.....	136
9.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN KUKËS.....	140
9.5	PROFILI SOCIAL.....	145
10	QARKU LEZHË.....	147
10.1	PROFILI I QARKUT LEZHË DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK.....	147
10.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT LEZHË.....	152
10.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT LEZHË.....	154
10.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN LEZHË.....	157
10.5	PROFILI SOCIAL.....	162
11	QARKU SHKODËR.....	164
11.1	PROFILI I QARKUT SHKODËR DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK.....	164
11.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT SHKODËR.....	169
11.3	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN SHKODËR....	172
11.4	PROFILI SOCIAL.....	178
12	QARKU TIRANË.....	181
12.1	PROFILI I QARKUT TIRANË DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK.....	181
12.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT TIRANË.....	186
12.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT TIRANË.....	189
12.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN TIRANË.....	192
12.5	PROFILI SOCIAL.....	198
13	QARKU VLORË.....	200
13.1	PROFILI I QARKUT VLORË DHE POZICIONI I NJQV-VE NË QARK.....	200
13.2	PABARAZITË DHE DALLIMET MES NJQV-VE TË QARKUT VLORË.....	206
13.3	PERFORMANCA FINANCIARE DHE FISKALE E NJQV-VE TË QARKUT VLORË.....	208
13.4	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE KONKURRUESHMËRIA E NJQV-VE NË QARKUN VLORË.....	211
13.5	PROFILI SOCIAL.....	215
13.6	PËRFUNDIME.....	216
II	PËRFUNDIME.....	219

1 HYRJE

Ky raport përmban analizën e arsyeve ekonomike, sociale, kulturore, demografike administrative për nevojën dhe avantazhet e riorganizimit administrative-territorial, bazuar në nenin 67 shkronja a) e ligjit 8652.

Raporti është kryer nga grupi I ekspertëve teknik të angazhuar nëpërmjet projektit STAR të financuar nga organizatat ndërkombëtare që mbështesin Reformën Administrativo-Territoriale.

Gjithashtu referuar Kartës Evropiane për Qeverisjen Vendore, Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, procesi i decentralizimit në Shqipëri do duhej të mundësonte: (i) demokratizimin e qeverisjes; (ii) efikasitetin në ofrimin e shërbimeve për qytetarët; (iii) zhvillimin ekonomik lokal si dhe (iv) zhdukjen e pabarazive dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Raporti i mëposhtëm, synon të vlerësojë si janë adresuar këto çështje nëpërmjet një analize të thellë fiskale, financiare, ekonomike, sociale, kulturore, demografike administrative të NJQV-ve në Shqipëri. Kjo analizë shërben si një prej argumenteve kryesore në lidhje me nevojën për një Strategji të re të Decentralizimit në Shqipëri të shoqëruar me një Reformë të thellë Territoriale Administrative.

Nëpërmjet analizave dhe treguesve krahasimorë do të prezantojmë një panoramë të situatës në lidhje me performancën fiskale dhe financiare të NJQV-ve në Shqipëri, efikasitetin në ofrimin e shërbimeve si dhe mundësinë për të garantuar/mbështetur zhvillimin ekonomik.

Për lehtësi të leximit, analizat janë zhvilluar dhe grupuar në nivel Qarku.


2 Qarku Berat

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në Qarkun e Beratit. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

2.1 Profili i qarkut Berat dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Beratit përbëhet nga 25 njësi të qeverisjes vendore në tre rrethe: rrethi i Beratit (12 njësi, qendër Berat); rrethi i Kuçovës (3 njësi, qendër Kuçovë) dhe rrethi i Skraparit (10 njësi, qendër Çorovodë). Popullsia e qarkut të Beratit është 141 944 banorë në vitin 2011, ndër të cilët pothuajse 70% (97 942 banorë) jetojnë në rrethin e Beratit, 19% (27 281 banorë) jetojnë në rrethin e Kuçovës dhe vetëm rreth 12% (16 721 banorë) jetojnë në Skrapar (INSTAT, Census 2011).

Figura 1. NJQV-të në qarkun e Beratit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Qarku i Beratit ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 39% ose mbi 90 000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012 në qarkun e Beratit ishin të regjistruar 231 986 banorë, me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011, pra 67%, 21% dhe 12% të regjistruar përkatësisht në Berat, Kuçovë dhe Skrapar.

Tabela 1. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Berat

Qarku	Rrethi	Njësia	Census 2011	Regjistri civil 2011	Ndryshimi i popullsisë	Ndryshimi në %
Berat	Berat	Tërpan	1716	2793	-1077	-39%
Berat	Berat	Roshnik	2513	4045	-1532	-38%
Berat	Berat	Cukalat	3045	4340	-1295	-30%
Berat	Berat	Sinjë	3351	5389	-2038	-38%
Berat	Berat	Lumas	3981	6898	-2917	-42%
Berat	Berat	Vertop	4919	7290	-2371	-33%
Berat	Berat	Ura Vajgurore	7232	11 825	-4593	-39%
Berat	Berat	Poshnjë	7375	10 049	-2674	-27%
Berat	Berat	Velabisht	8453	11 629	-3176	-27%
Berat	Berat	Otlak	9218	14 470	-5252	-36%
Berat	Berat	Kutalli	9643	12 953	-3310	-26%
Berat	Berat	Berat	36 496	62 850	-26 354	-42%
		Berat gjithsej	97 942	154 531	-56 589	-37%
Berat	Kuçovë	Kozarë	5622	7927	-2305	-29%
Berat	Kuçovë	Perondi	9005	10592	-1587	-15%
Berat	Kuçovë	Kuçovë	12654	30105	-17 451	-58%
		Kuçovë gjithsej	27 281	48 624	-21 343	-44%
Berat	Skrapar	Leshnjë	496	1137	-641	-56%
Berat	Skrapar	Çëpan	740	1137	-397	-35%
Berat	Skrapar	Zhepë	779	1120	-341	-30%
Berat	Skrapar	Gjerbës	813	1419	-606	-43%
Berat	Skrapar	Potom	897	1184	-287	-24%
Berat	Skrapar	Vendreshë	984	1641	-657	-40%
Berat	Skrapar	Bogovë	1098	1734	-636	-37%
Berat	Skrapar	Qendër	2545	4280	-1735	-41%
Berat	Skrapar	Çorovodë	4051	6728	-2677	-40%
Berat	Skrapar	Poliçan	4318	8451	-4133	-49%
		Skrapar gjithsej	16 721	28 831	-12 110	-42%
Qarku Berat gjithsej			141 944	231 986	-90 042	-39%

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet tona

Popullsia e qarkut Berat përbën rreth 6,1% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 5678 banorë/NJQV, ose 30% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Njësitë e rrethit të Skraparit janë veçanërisht të vogla me një mesatare prej 1672 banorësh, ndërkohë që 5 nga 8 njësitë me popullsi më të vogël se 2000 banorë të këtij qarku ndodhen në Skrapar. Kjo është e kuptueshme meqenëse Skrapari është zonë kryesisht malore.

Tabela 2. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Berat sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


	<i>Nr. i njësive</i>	<i>Min.</i>	<i>Maks.</i>	<i>Mesatare / njësi</i>	<i>Shuma</i>	<i>% e popullsisë</i>	<i>Shqipëria</i>
Shqipëria				8016		100%	
Berat				5678	141 944	6,1%	
0-2000	8	496	1716	940	7523	5,3%	27,61%
2001-5000	8	1098	4919	3590	28 723	20,2%	34,58%
5001-10 000	7	5622	9643	8078	56 548	39,8%	26,27%
10 001-20 000	1	12 654	12 654	12 654	12 654	8,9%	6,70%
20 001-30 000							1,61%
30 001-50 000	1	36 496	36 496	36 496	36 496	25,7%	1,07%
50 000-100 000							1,61%
100 000-200 000							0,27%
200 000+							0,27%

Burimi: INSTAT, *Census 2011; Llogaritjet tona*

Dendësia mesatare e popullsisë është 408 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Zonat urbane kanë dendësi më të lartë, por Berati si qendër ekonomike ka dendësi më të ulët (1924 banorë/km²) se Kuçova (4017 banorë/km²) dhe Çorovoda (2340 banorë/km²). Komunat Gjrbës, Leshnjë dhe Zhehtë në Skrapar kanë dendësinë më të ulët, me më pak se 6 banorë për km², ndërkohë që gjysma e njësive kanë dendësi më të ulët se 55 banorë/km².

Pesha e njësive të qarkut Berat në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 5,3% në vitin 2012, me një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2008 (4,4%).

Figura 2. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Berat krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore




Burimi: *Ministria e Financave; Llogaritjet tona*

Shpenzimet operative zënë pjesën dërrmuese të shpenzimeve totale në qarkun e Beratit, mesatarisht 76% në vitet 2008 – 2012, e 82% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë rreth gjysma, ose mesatarisht 41% e shpenzimeve totale të NJQV-ve të

qarkut. Në nivel kombëtar, shpenzimet për personelin në qarkun e Beratit zënë rreth 4,6% të shpenzimeve për paga dhe sigurime, ose 1,7% të shpenzimeve gjithsej. Shpenzimet kapitale zënë një vend shumë të vogël në strukturën totale, me vetëm 18% në vitin 2012 (ose 24% mesatarisht në 5 vite). Ky raport është ndjeshëm më i ulët se mesatarja kombëtare prej 34% në 5 vite ose 26% në vitin 2012. Bashkitë e Beratit dhe Kuçovës, të cilat kanë rreth 34% të popullsisë së qarkut (40% sipas të dhënave administrative), zënë një peshë rreth 44% në totalin e shpenzimeve për paga dhe sigurime, por vetëm 16% në shpenzimet për investime.


Figura 3. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Berat



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve, me rreth 21% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) mesatarisht me rreth 13%.


Figura 4. Shpenzimet sipas sektorëve (funsioneve) në NJQV-të e qarkut Berat



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet tona

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Berat përbëjnë rreth 4,5% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Në vitet 2009 deri 2011 të ardhurat e NJQV-ve të Beratit kanë përbërë rreth 4,7% të totalit, por në vitin 2012 pësha i është rikthyer vlerave mesatare: rreth 4,4%. Nga viti 2010 deri në 2012 të ardhurat vendore të njësive të Beratit kanë rënë me mesatarisht 9% në vit.


Figura 5. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Berat kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë më pak se 33% të totalit në qarkun e Beratit, ndërkohë që mbi 34% e të ardhurave vijnë nga transferata e pakushtëzuar. Në vitin 2012 të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë më pak se 25%, ndërkohë që ka pasur një rritje të ndjeshme të granteve të kushtëzuara (37%). Këto të fundit kanë pasur rritje të ndjeshme gjatë viteve 2009 – 2011, për t’u ulur sërish në vitin 2012.

Figura 6. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Beratit



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

2.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Berat

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Berat, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shohim një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.

Njësitë me buxhete (të ardhura totale) më të mëdha në vitin 2012 janë natyrisht bashkia e Beratit (376 milionë); bashkia e Kuçovës (161 milionë) dhe Çorovoda (110 milionë). Njësitë e tjera të qarkut, veçanërisht bashkitë si Ura Vajgurore, komunat Velabisht, Otlak, Poshnje dhe Kutalli, të cilat kanë popullsi relativisht të madhe, kanë buxhete që luhaten rreth mesatares së qarkut (70 milionë). Ndërkohë, të gjitha komunat në rrethin e Skraparit kanë buxhete mjaft modeste, që luhaten nga 15 - 40% të mesatares për qarkun. Po të hedhim një vështrim mbi strukturën e të ardhurave gjendja paraqitet disi më e ndryshme: 52% e të ardhurave nga burimet e veta gjithsej realizohet në Berat (39%) dhe Kuçovë (13%). Bashkia Ura Vajgurore realizon rreth 7% të të ardhurave të veta vendore të qarkut, ndërsa Çorovoda rreth 5%.

- a. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banorë.

Tabela 3. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me të mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor

		2010		2011		2012						
		Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Biznesi vogël	Taksa pasuri	Ndikim infrastrukture	Regjistrimi automjeteve	Tarifë pastrimi	Transf. e pakusht.	Transf. e kusht.	
BR	Berat	Berat	83%	94%	87%	139%	70%	0%	97%	106%	102%	13%
BR	Berat	Cukalat	63%	18%	17%	37%	46%	0%	39%	0%	98%	522%
BR	Berat	Kutalli	40%	32%	32%	28%	54%	0%	69%	24%	72%	67%
BR	Berat	Lumas	25%	21%	40%	42%	107%	3%	25%	5%	74%	87%
BR	Berat	Otlak	48%	36%	47%	63%	76%	0%	62%	48%	68%	60%
BR	Berat	Poshnje	70%	40%	49%	62%	136%	4%	67%	35%	68%	96%
BR	Berat	Roshnik	42%	40%	16%	4%	44%	1%	12%	1%	49%	81%
BR	Berat	Sinjë	17%	17%	17%	9%	79%	0%	34%	1%	132%	58%
BR	Berat	Tërpan	33%	23%	23%	9%	118%	0%	30%	3%	206%	143%
BR	Berat	Ura Vajg.	75%	77%	83%	118%	94%	0%	130%	145%	84%	63%
BR	Berat	Velabisht	39%	20%	112%	182%	308%	22%	176%	49%	221%	140%
BR	Berat	Vertop	43%	51%	51%	41%	193%	16%	48%	30%	113%	119%
BR	Kuçovë	Kozare	44%	37%	47%	61%	115%	0%	0%	18%	70%	164%
BR	Kuçovë	Kuçovë	66%	55%	64%	110%	35%	0%	45%	36%	92%	22%
BR	Kuçovë	Perondi	29%	19%	34%	81%	87%	0%	30%	29%	83%	51%
BR	Skrapar	Bogovë	21%	72%	201%	96%	940%	0%	79%	42%	246%	98%
BR	Skrapar	Çepan	25%	34%	40%	0%	115%	0%	15%	0%	311%	280%
BR	Skrapar	Çorovodë	56%	81%	110%	168%	54%	0%	82%	117%	240%	168%
BR	Skrapar	Gjerbës	41%	21%	58%	4%	19%	7%	20%	16%	267%	0%
BR	Skrapar	Leshnjë	29%	19%	43%	1%	71%	0%	14%	0%	367%	290%
BR	Skrapar	Poliçan	47%	51%	57%	101%	148%	0%	42%	63%	149%	70%
BR	Skrapar	Potom	76%	24%	27%	4%	34%	0%	36%	0%	295%	148%
BR	Skrapar	Qendër	39%	30%	32%	9%	107%	13%	22%	3%	177%	50%
BR	Skrapar	Vendreshe	19%	13%	30%	4%	32%	12%	15%	0%	187%	171%
BR	Skrapar	Zhepë	15%	9%	44%	0%	41%	3%	9%	0%	421%	205%
Berat total			43%	37%	43%	37%	125%	3%	48%	31%	168%	127%
Shqipëria			100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Siç shihet në tabelën 14, të ardhurat e veta për banor në qarkun e Beratit luhaten në rreth 43% të mesatares kombëtare. Edhe njësitë më të pasura të qarkut si Berati nuk arrijnë mesataren kombëtare për banor (83%, 94% dhe 87% mesatarisht në vitet 2010, 2011 dhe 2012). Po të vrojtojmë burimet kryesore të të ardhurave, vërehet se të gjitha bashkitë kryesore të qarkut luhaten mbi ose rreth mesatares kombëtare për vlerat e taksës së biznesit të vogël. Ndërkohë, të ardhurat nga tarifa e pastrimit për banor mbeten modeste në të gjitha njësitë, ndërkohë që vërehen luhatje të mëdha në vlerat për llojet e tjera të të ardhurave. Komunitet mesatare janë më të prirura të kenë rezultate më të mira në treguesit e pasurisë se bashkitë e mëdha, ndoshta kjo ndodh pasi komunitet detyrohen të shfrytëzojnë këtë taksë në mungesë të burimeve alternative. Komunitet Velabisht dhe Bogovë kanë rezultate mbresëlënëse në treguesit e të ardhurave për vitin 2012, në ndryshim nga vitet paraardhëse.

- b. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 4. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve

Qarku	Rrethi	Njësia	2010		2011		2012		Investime/ frymë në % të mes. kombëtare
			Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shp. personeli/ frymë në % të mes. kombëtare	Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shp. personeli/ frymë në % të mes. kombëtare	Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shpenzime personeli/ frymë në % të mes. kombëtare	
Berat	Berat	Berat	83%	107%	94%	110%	90%	104%	31%
Berat	Berat	Cukalat	46%	66%	37%	59%	72%	67%	99%
Berat	Berat	Kutalli	48%	69%	42%	69%	36%	26%	75%
Berat	Berat	Lumas	44%	51%	56%	55%	59%	42%	106%
Berat	Berat	Otlak	48%	63%	41%	56%	44%	40%	76%
Berat	Berat	Poshnje	51%	92%	41%	72%	44%	37%	67%
Berat	Berat	Roshnik	70%	101%	75%	105%	28%	29%	47%
Berat	Berat	Sinjë	57%	81%	53%	71%	58%	70%	68%
Berat	Berat	Tërpan Ura-	120%	89%	80%	91%	62%	91%	0%
Berat	Berat	Vajgurore	69%	121%	73%	108%	78%	117%	16%
Berat	Berat	Velabisht	45%	61%	36%	58%	106%	73%	230%
Berat	Berat	Vertop	61%	61%	59%	52%	51%	52%	84%
Berat	Kuçovë	Kozare	70%	69%	289%	64%	85%	69%	140%
Berat	Kuçovë	Kuçovë	67%	80%	68%	76%	70%	70%	0%
Berat	Kuçovë	Perondi	49%	67%	32%	40%	80%	88%	41%
Berat	Skrapar	Bogovë	75%	93%	83%	147%	185%	173%	289%
Berat	Skrapar	Çepan	115%	159%	113%	224%	135%	216%	0%
Berat	Skrapar	Çorovodë	111%	243%	105%	240%	174%	223%	112%
Berat	Skrapar	Gjerbës	113%	201%	124%	179%	133%	177%	173%
Berat	Skrapar	Leshnjë	148%	219%	56%	112%	104%	168%	0%
Berat	Skrapar	Poliçan	75%	117%	78%	136%	82%	146%	0%
Berat	Skrapar	Potom	147%	173%	108%	179%	94%	144%	0%
Berat	Skrapar	Qendër	110%	92%	86%	99%	75%	95%	97%
Berat	Skrapar	Vendreshe	107%	108%	117%	103%	88%	78%	153%
Berat	Skrapar	Zhepë	188%	225%	172%	227%	126%	225%	0%
Berat Min.			44%	51%	32%	40%	28%	26%	0%
Berat Maks.			188%	243%	289%	240%	185%	225%	289%
Berat Mesatarja			85%	112%	85%	109%	86%	105%	76%


Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Krahasimi i shpenzimeve për frymë na jep disa indikacione të rëndësishme: mesatarisht njësitë e qarkut Berat shpenzojnë më pak se mesatarja kombëtare për banor, me përjashtim të vitit 2012 kur mesatarja rritet ndjeshëm. Megjithatë, shpenzimet për personelin mesatarisht janë më të larta se mesatarja kombëtare (112% dhe 109% në 2010-2011) dhe bien lehtësisht në vitin 2012, në 105% mbi mesataren kombëtare, ndërkohë që në njësi të veçanta shpenzimet për personelin për frymë mbeten të larta. Është interesante të vërehet se në mënyrë tipike njësitë që kanë më shumë shpenzime administrative janë ato që gjenerojnë më pak të ardhura nga burimet e veta, por që kanë një shkallë të lartë varësie nga transfertat e pakushtëzuar. I tillë është për shembull rasti i komunës Zhepë dhe i pjesës më të madhe të njësive në Skrapar; apo njësi, si Tërpani, Cukalati dhe Velabishti në Berat.

2.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Berat

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë në NJQV-të e qarkut Berat.

Figura 7. Të ardhurat për banor përkundrejt popullsisë dhe shpenzimeve për personelin në NJQV-të e qarkut Berat 2011



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Mesatarja e të ardhurave për frymë në NJQV-të e qarkut Berat ulet nga 9218 lekë (70 Euro) në vitin 2009, në rreth 7650 lekë (55 Euro) për frymë në vitin 2012. Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë po ashtu ulet nga rreth 15 Euro në 2009 në 13,6 Euro në 2012, në krahasim me përkatësisht 27 Euro dhe 25,4 Euro të mesatares kombëtare në 2009 dhe 2012. Njësitë me të ardhura të veta më të larta për frymë janë në rend zbritës Bogova, Velabishti dhe Çorovoda; ndërsa të ardhurat më të ulëta për frymë janë në Cukalat, Roshnik dhe Sinjë. Berati dhe Kuçova kanë të ardhura për frymë rreth 1,6 dhe 1,2 herë më të larta se mesatarja e qarkut prej 1690 lekë për banor, ndërsa në nivel vendi të ardhurat e veta për frymë janë rreth 3107 lekë për banor në vitin 2012.

Grafiku 6 tregon të ardhurat për frymë nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar, si dhe shpenzimet për paga e sigurime për banor në vitin 2011. Siç shihet, në përgjithësi njësitë me popullsi më të madhe gjenerojnë të ardhura të veta më të larta për banor; ndërkohë që transfertat e pakushtëzuar ndjek drejtimin e kundërt. Ndërkohë, sjellja e treguesit të shpenzimeve për personelin (për banor gjithashtu) përgjithësisht ka lidhje inverse me të ardhurat e veta për frymë dhe popullsinë totale.


Po të shikojmë klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të njërive për qarkun Berat vërehet se ndërsa shpenzimet totale për frymë pësojnë ulje nga viti 2009 deri në vitin 2012, mesatarja e shpenzimeve për personelin rritet. Ndërkohë, mesatarja e investimeve kapitale pëson luhajtje gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, duhet përmendur se ecuria e investimeve kapitale duhet vrojtuar përgjatë një periudhe relativisht të gjatë, ndaj treguesit vjetorë janë më pak domethënës në këtë rast. Siç shikohet në tabelën 5, disa prej njërive që kanë shpenzime administrative shumë të larta në vitin 2012 nuk kanë kryer asnjë investim. Gjithashtu, investimet për frymë tentojnë të jenë më të larta në zonat me popullsi më të vogël se në ato me popullsi më të madhe. Duke vrojtuar strukturën e buxheteve vendore mund të

përfundojmë se shumica e investimeve në njësitë më të vogla financohen me anë të granteve të kushtëzuara dhe ose konkurruese.

Tabela 5. Shpenzimet për frymë 2010 – 2012

Qarku	Rrethi	Njësia	2010			2011			2012		
			Shpenz./ frymë	Shpenz./ personeli	Inv./ për frymë	Shpenz./ frymë	Shpenz./ personeli	Inv./ për frymë	Shpenz./ frymë	Personel/ për frymë	Inv./ për frymë
Berat	Berat	Berat	6042	2590	1066	5871	2593	1416	5738	2473	507
Berat	Berat	Cukalat	3316	1608	507	2304	1382	691	4604	1611	1611
Berat	Berat	Kutalli	3465	1688	432	2625	1621	77	2307	615	1230
Berat	Berat	Lumas	3189	1238	294	3479	1305	1160	3756	1011	1734
Berat	Berat	Otllak	3521	1525	625	2557	1313	276	2821	963	1239
Berat	Berat	Poshnje	3712	2239	467	2587	1692	199	2780	894	1092
Berat	Berat	Roshnik	5048	2463	1015	4697	2472	1731	1802	687	772
Berat	Berat	Sinjë	4134	1964	229	3340	1670	0	3693	1662	1108
Berat	Berat	Tërpan	8733	2153	3602	5013	2148	1074	3987	2175	0
Berat	Berat	Ura-Vajg.	4979	2934	481	4567	2537	1015	5002	2798	254
Berat	Berat	Velabisht	3261	1478	948	2236	1376	430	6753	1751	3752
Berat	Berat	Vertop	4407	1486	1267	3704	1235	1372	3286	1232	1369
Berat	Kuçovë	Kozare	5052	1677	2191	18 040	1514	15 643	5448	1647	2281
Berat	Kuçovë	Kuçovë	4832	1937	325	4252	1794	498	4491	1663	0
Berat	Kuçovë	Perondi	3571	1635	719	1983	944	189	5074	2106	670
Berat	Skrapar	Bogovë	5417	2271	0	5190	3460	0	11 792	4127	4717
Berat	Skrapar	Çepan	8359	3872	427	7036	5277	0	8613	5168	0
Berat	Skrapar	Çorovodë	8084	5908	206	6540	5648	0	11 121	5332	1828
Berat	Skrapar	Gjerbës	8194	4876	135	7752	4228	2819	8463	4231	2821
Berat	Skrapar	Leshnjë	10 776	5320	244	3518	2639	0	6667	4000	0
Berat	Skrapar	Poliçan	5471	2833	546	4851	3195	710	5217	3478	0
Berat	Skrapar	Potom	10 704	4197	2080	6757	4223	845	6019	3439	0
Berat	Skrapar	Qendër	7965	2227	3016	5374	2336	1869	4766	2270	1589
Berat	Skrapar	Vendreshe	7750	2612	2754	7313	2438	3047	5611	1870	2494
Berat	Skrapar	Zhepë	13 675	5476	4246	10 714	5357	1786	8043	5362	0
		Min.	1802	615	0	1983	944	0	3189	1238	0
		Maks.	11 792	5362	4717	18 040	5648	15 643	13 675	5908	4246
		Mesatare	5514	2503	1243	5292	2576	1474	6146	2728	1113
		Mesatare	5074	2106	1108	4697	2336	710	5052	2239	546
		Koeficienti	0,5	0,6	1,0	0,6	0,5	2,1	0,5	0,5	1,1


Figura 8. Shpenzimet për frymë, operative dhe kapitale (pa bashkinë Berat)



Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Shpenzimet operative janë mjaft të larta në njësitë e qarkut Berat, ashtu si dhe në përgjithësi në nivel vendi. Në veçanti, shpenzimet për paga e sigurime zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale për çdo njësi, duke variuar nga 37% (Kuçova) deri në 75% (Gjerbës) në vitin 2012. Pësia relative e zërit të pagave në shpenzimet e përgjithshme operative ka rënë në përgjithësi nga viti 2011 në 2012, ndonëse ka njësi që kanë ndjekur trendin e kundërt.

Figura 9. Pësia relative e shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve operative për njësi 2010 - 2012



Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

2.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Berat


Qeverisja vendore luan një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë seksion do të hedhim një vështrim mbi të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për çdo qark; të dhënat mbi forcën e punës dhe punësimin (për sa të dhënat janë të disponueshme), si dhe sipërmarrjen dhe zhvillimin e bizneseve, të cilat analizohen nga

pikëpamja e përqendrimit në çdo qark dhe nga pikëpamja e të ardhurave që gjenerojnë në nivel kombëtar, si dhe për çdo njësi vendore.

a. Prodhimi i brendshëm bruto.

Pesha specifike e rajonit të Beratit ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është 4,77%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është 3079 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Censurit 2011 (1884 Euro për banor me të dhënat administrative). PBB për frymë në qarkun e Beratit është shumë e përafërt me atë në nivel kombëtar, 3271 Euro për vitin 2012.

Figura 10. Struktura e PBB-së sipas qarqeve 2011




Burimi: INSTAT

Tabela 6. PBB totale dhe PBB për frymë sipas qarqeve

Qarku	PBB çmime korrente (mln lekë)	Pesha specifike	PBB për frymë në lekë	PBB për frymë Euro	PBB për frymë si % e kombëtares
Shqipëria	2 800 138	100%	457 926	3271	100,0%
Dibër	137 047	3,1%	291 528	2082	63,7%
Durrës	262 785	9,4%	458 656	3276	100,2%
Kukës	85 292	2,4%	367 221	2623	80,2%
Lezhë	134 027	3,6%	349 385	2496	76,3%
Shkodër	215 347	6,0%	361 626	2583	79,0%
Elbasan	295 827	9,2%	400 484	2861	87,5%
Tiranë	749 365	36,3%	621 460	4439	135,7%
Berat	141 944	4,8%	431 071	3079	94,1%
Fier	310 331	9,9%	405 412	2896	88,5%
Gjirokastër	72 176	2,7%	473 537	3382	103,4%
Korçë	220 357	6,2%	364 077	2601	79,5%
Vlorë	175 640	6,3%	456 462	3260	99,7%


Figura 11. PBB për frymë si përqindje e PBB-së për frymë në nivel kombëtar



Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Beratit, vërejmë se sektori i bujqësisë sjell vlerën e shtuar bruto më të lartë në qark (34%), i ndjekur nga sektori i tregtisë dhe shërbimeve (27%). Industria dhe ndërtimi sjellin vetëm 17% të vlerës së shtuar bruto në këtë qark.

Figura 12. Struktura e PBB-së sipas sektorëve për qark



Burimi: INSTAT

b. Sipërmarrja dhe bizneset.

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Berat janë të regjistruara 5175 biznese, ndër të cilat 156, ose 30%, janë biznese të mëdha dhe 38 janë biznese të mesme. 3238 biznese (ose 63% e totalit) operojnë në rrethin e Beratit, 2304 (45%) në bashkinë e Beratit, ndër të cilat 71 janë të regjistruara si biznese të mëdha. Në Kuçovë janë të regjistruara 1027 biznese, ndër të cilat 1003 biznese të vogla. 47% e bizneseve operojnë në fushën e tregtisë, 14% janë hotele dhe restorante, ndërsa 10% në industrinë përpunuese.

Të ardhurat nga taksat e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) janë mesatarisht 288 dhe 145 lekë për frymë në vitin 2012 dhe 2011. Këto vlera janë ndjeshëm më të ulëta se mesatarja kombëtare prej 532 dhe 621 lekësh për frymë, përkatësisht në 2012 dhe 2011. Pabarazia brenda qarkut në realizimin e të ardhurave prej kësaj takse është mjaft e madhe, siç tregojnë edhe koeficienti i variacionit që merr vlera mbi 1 për të gjitha vitet. Disa njësi si Berati, Ura Vajguore, Kuçova dhe Çorovoda kanë realizime relativisht të larta, por këto rezultate nuk janë konsistente përgjatë viteve.

Tabela 7. Të ardhurat për frymë nga taksa e biznesit të vogël

			2008	2009	2010	2011	2012
Berat	Berat	Berat	857	797	792	826	727
Berat	Berat	Cukalat	221	189	224	155	195
Berat	Berat	Kutalli	160	163	136	69	147
Berat	Berat	Lumas	150	176	134	70	223
Berat	Berat	Otlak	300	138	140	123	332
Berat	Berat	Poshnje	123	184	167	17	326
Berat	Berat	Roshnik	-	-	516	18	19
Berat	Berat	Sinjë	26	32	34	13	48
Berat	Berat	Tërpan	38	21	31	34	46
Berat	Berat	Ura-Vajgurore	528	560	483	358	620
Berat	Berat	Velabisht	164	143	175	46	952
Berat	Berat	Vertop	158	168	222	59	213
Berat	Kuçovë	Kozare	148	150	157	69	320
Berat	Kuçovë	Kuçovë	603	538	526	367	576
Berat	Kuçovë	Perondi	298	300	200	58	427
Berat	Skrapar	Bogovë	146	166	121	135	502
Berat	Skrapar	Çepan	3	-	-	-	-
Berat	Skrapar	Çorovodë	416	353	475	506	879
Berat	Skrapar	Gjerbës	7	76	99	45	20
Berat	Skrapar	Leshnjë	-	22	-	-	5
Berat	Skrapar	Poliçan	434	398	513	566	531
Berat	Skrapar	Potom	70	26	9	21	21
Berat	Skrapar	Qendër	23	17	30	50	47
Berat	Skrapar	Vendreshe	20	5	-	9	19
Berat	Skrapar	Zhepë	-	-	-	-	-
Mesatare			196	185	207	145	288
Min.			-	-	-	-	-
Max..			857	797	792	826	952
Median			148	150	140	58	213
Koeficienti i variacionit			1,13	1,11	1,04	1,47	1,02

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

a. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (toka bujqësore dhe ndërtesat).

Tabela 8. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Berat, krahasuar me mesataren kombëtare për banor

			2008	2009	2010	2011	2012
Berat	Berat	Berat	0,5	1,4	0,7	0,5	0,7
Berat	Berat	Cukalat	0,6	0,6	0,7	0,6	0,5
Berat	Berat	Kutalli	1,5	1,3	1,3	1,5	0,5
Berat	Berat	Lumas	1,0	1,1	1,6	1,0	1,1
Berat	Berat	Otlak	1,6	1,5	1,3	1,6	0,8
Berat	Berat	Poshnje	2,1	1,8	2,1	2,1	1,4
Berat	Berat	Roshnik	1,4	1,2	0,2	1,4	0,4
Berat	Berat	Sinjë	1,1	1,1	1,3	1,1	0,8
Berat	Berat	Tërpan	1,6	1,4	2,1	1,6	1,2
Berat	Berat	Ura-Vajgurore	1,1	1,0	1,1	1,1	0,9
Berat	Berat	Velabisht	1,8	1,3	1,2	1,8	3,1
Berat	Berat	Vertop	2,4	1,8	2,0	2,4	1,9
Berat	Kuçovë	Kozare	1,6	1,4	1,5	1,6	1,2
Berat	Kuçovë	Kuçovë	0,4	0,4	0,4	0,4	0,4
Berat	Kuçovë	Perondi	1,5	1,6	1,3	1,5	0,9
Berat	Skrapar	Bogovë	0,6	0,5	0,3	0,6	9,4
Berat	Skrapar	Çepan	0,6	0,7	0,6	0,6	1,1
Berat	Skrapar	Çorovodë	0,3	0,3	0,4	0,3	0,5
Berat	Skrapar	Gjerbës	0,1	0,1	0,1	0,1	0,2
Berat	Skrapar	Leshnjë	0,5	0,3	0,4	0,5	0,7
Berat	Skrapar	Poliçan	0,6	0,9	1,0	0,6	1,5
Berat	Skrapar	Potom	0,4	0,7	0,4	0,4	0,3
Berat	Skrapar	Qendër	0,9	0,7	0,8	0,9	1,1
Berat	Skrapar	Vendreshe	0,2	0,2	0,2	0,2	0,3
Berat	Skrapar	Zhepë	0,2	0,3	0,3	0,2	0,4
Mesatare			1,0	0,9	0,9	1,0	1,2
Min.			0,1	0,1	0,1	0,1	0,2
Maks.			2,4	1,8	2,1	2,4	9,4
Mesatare Koeficienti			0,9	1,0	0,8	0,9	0,8
i variacionit			0,65	0,55	0,67	0,65	1,44

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Performanca e njësisve të Beratit në lidhje me taksat e pasurisë nuk është shumë e mirë. Në veçanti, realizimin më të mirë të të ardhurave nga taksa e pasurisë për frymë i kanë disa njësi që nuk kanë burime apo performancë veçanërisht të mirë nga burimet e tjera. Berati dhe Kuçova, dy njësitë e qarkut me nivelin më të lartë të ardhurave të veta kanë performancë mjaft të ulët në mbledhjen e kësaj takse; ndërkohë që komuna si Kozara, Velabishti dhe Poshnja kanë të ardhura për frymë nga taksa e pasurisë më të mëdha se mesatarja kombëtare.

2.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Beratit ka 25 njësi administrative. Popullsia e Beratit në 2013 raportohet rreth 138 484 banorë.
- Qarku i Beratit hyn te grupi i qarqeve popullsia e të cilëve është zvogëluar 28% në krahasim me 2001. Popullsia rurale është zvogëluar me rreth 32% ndërsa ajo urbane me rreth 21%. Dendësia gjithashtu ka ardhur duke u zvogëluar (28%).
- Qarku ka 38 493 familje.
- 8340 persona që përfaqësojnë rreth 5,9% të popullsisë, janë persona me aftësi të kufizuara.
- Popullsia në moshë pune është 96 974 persona ose 68,3% e totalit të popullsisë. Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun Berat janë 6521 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 236 përfitojnë pagesë papunësie.
- 6735 persona janë të kthyer nga emigracioni, ku 75% e të gjithë të kthyerve janë meshkuj.

Strehimi

- 38 493 familje, 36 698 në pronësi ose në proces pronësimi, 1053 me qira, 742 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Beratit ka mesatarisht 2,69 dhoma.
- 621 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 2939 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 38 021 banesa të banuara) ose 9,3% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 2500 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër nga 38 021 banesa të banuara) ose 6,5%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Beratit shënon një nivel varfërie prej 12,7%. Thellësia e varfërisë është 2,4% dhe ashpërsia 0,7%. Këta tregues janë më të mirë krahasuar me nivelin kombëtar të varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Pak më shumë se 5000 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Beratit ose rreth 5% në rang vendi (2010)
- Koeficienti GINI për qarkun e Beratit është 26,3.
- Konsumi total për familje në këtë qark është 47 802 Lekë krahasuar me konsumin për person që është 12 060 Lekë.

Shëndetësia

- 8340 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç e barabartë me rreth 7,8%
- Në këtë qark ndodhen 4 spitale me një kapacitet prej 378 shtretërish, si dhe 93 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Beratit kemi një numër total mjekësh prej 172.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 15 minuta, ndërsa në zonat rurale 14 minuta.
- Sipas ndarjes të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 13 minuta për jo të varfrit dhe 21 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 3858 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç e barabartë me 3%.

Shërbimet

Sipas inventarizimit të shërbimeve sociale në këtë qark vihet re mungesa e shërbimeve për gra dhe vajza.

Berat	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	0	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	0
Shërbime sociale për gra dhe vajza	1	3
Shërbime sociale për fëmijët	0	1 ¹
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	1	2
Shërbime sociale për PAK	0	1
Gjithsej	2	7

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

¹ Shërbime që adresojnë problemet e familjeve dhe fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian


3 Qarku Durrës

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Durrësit. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

3.1 Profili i qarkut Durrës dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Durrësit përbëhet prej dy rretheve: atij të Durrësit dhe të Krujës dhe prej 16 njësive të qeverisjes vendore (NJQV) të organizuara - 10 në rrethin e Durrësit (Durrës, Gjepalaj, Ishëm, Katund i Ri, Maminas, Manëz, Rrashbull, Shijak, Sukth dhe Xhafzotaj) dhe 6 në rrethin e Krujës (Bubq, Cudhi, Fushë Krujë, Kodër Thumanë, Krujë, Nikël). Qarku i Durrësit ka një popullsi prej 262 785 banorësh (në rrethin e Durrësit janë 202 971 banorë dhe në rrethin e Krujës janë 59 814 banorë) (INSTAT, Census 2011).

Figura 13. NJQV-të në qarkun e Durrësit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Këto shifra paraqiten konsiderueshëm më të ulura referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në janar 2012 popullsia e qarkut të Durrësit rezulton 414 677 (në rrethin e Durrësit 336 524 banorë dhe në rrethin e Krujës 78 153 banorë).

Tabela 9. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Durrës

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011	RGJC 2011	DIFERENCA
DURRËS	DURRËS	113 249	20 918	-90 669
DURRËS	RASHBULL	24 081	28 071	-3990
DURRËS	SUKTH	15 966	25 844	-9878
DURRËS	XHAFZOTAJ	12 381	17 656	-5275
DURRËS	KATUND I RI	10 161	15 384	-5223
DURRËS	SHIJAK	7568	12 961	-5393
DURRËS	MANËZ	6652	11 181	-4529
DURRËS	ISHEM	5001	8708	-3707
DURRËS	MAMINAS	4463	7003	-2540
DURRËS	GJEPALAJ	3449	5798	-2349
TOTAL DURRËS		202 971	336 524	-133 553
KRUJË	FUSHË KRUJË	18 477	24 973	-6496
KRUJË	KODËR THUMANË	12 335	15 603	-3268
KRUJË	KRUJË	11 721	16 212	-4491
KRUJË	NIKEL	9518	9898	-380
KRUJË	BUBQ	5951	8264	-2313
KRUJË	CUDHI	1812	3203	-1391
TOTAL KRUJË		59 814	78 153	-18 339
TOTAL QARKU		262 785	414 677	-151 892

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet tona

Popullsia e qarkut Durrës përbën rreth 9,4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 16 424 banorë/NJQV. Kjo mesatare është gati dy herë më e lartë se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV).

Tabela 10. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Durrës sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


Klasifikimi i NJQV-ve sipas numrit të popullsisë	Qarku Durrës	Shqipëria
Popullsia	9,38%	100,00%
Popullsia Mesatare për NJQV	16 424	8016
< 2000	6,25%	27,61%
2000-5000	12,50%	34,58%
5000-10 000	31,25%	26,27%
10 000-20 000	37,50%	6,70%
20 000-30 000	6,25%	1,61%
30 000-50 000	0,00%	1,07%
50 000-100 000	0,00%	1,61%
100 000-200 000	6,25%	0,27%
> 200 000	0,00%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Dendësia mesatare e popullsisë është 473 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Durrësi (2985 banorë/km²) dhe Shijaku (1552 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa Cudhi (22 banorë/km²) dhe Ishëm (55 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët.

Njësitë vendore të qarkut Durrës zënë një vend të rëndësishëm në totalin e shpenzimeve vendore. Ato shpenzojnë rreth 8,5% të totalit të shpenzimeve vendore ose 0,2% të PBB-së.

Figura 14. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Durrës krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Pjesa më e madhe e shpenzimeve në të gjitha NJQV-të e qarkut shkon për shpenzime operative – rreth 60%, nga të cilat pagat dhe sigurimet përbëjnë 34% ose mesatarisht 2,85% të totalit të shpenzimeve vendore në Shqipëri.

Shpenzimet kapitale pësojnë një rritje të ndjeshme në raport me shpenzimet operative gjatë viteve 2009 dhe 2010, por fillojnë të bien në 2011, për të arritur nivelin më të ulët prej vetëm 25% të totalit të shpenzimeve në nivel qarku në vitin 2012.

Figura 15. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Durrës




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Nëse shikojmë ndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve, pjesa më e madhe e shpenzimeve rezultojnë në dy funksione kryesore: atë të shërbimeve publike – mesatarisht 47% e

shpenzimeve të NJQV-ve të qarkut Durrës i përkasin këtij funksioni, dhe të transportit – mesatarisht 37% e shpenzimeve shkojnë për këtë funksion.


Figura 16. Shpenzimet sipas sektorëve (funksioneve) në NJQV-të e qarkut Durrës



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet tona

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Durrës përbëjnë rreth 8,7% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Ndryshe nga tendenca e të ardhurave vendore në nivel kombëtar, të ardhurat në NJQV-të e qarkut Durrës pësojnë një rritje në raport me të ardhurat totale gjatë vitit 2010, për të ndjekur trendin rënës të të ardhurave vendore në nivel kombëtar gjatë vitit 2012.


Figura 17. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Durrës kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Durrës përbëhen në pjesën më të madhe (thuhetse 60%) prej të ardhurave të grumbulluara prej vetë njësive vendore, dhe në rreth 34% prej transfertës së pakushtëzuar. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2011 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin.

Figura 18. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Durrësit



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

3.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Durrës

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Durrës, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.

Tabela 11. Raporti mes buxheteve të NJQV-ve me mesataren e buxheteve të NJQV-ve të qarkut Durrës

Qarku DURRËS		TR/ATR		
		2011	2010	2009
Durrës	B	826%	996%	798%
Shijak	B	46%	21%	41%
Manëz	B	35%	29%	55%
Sukth	B	78%	63%	76%
Rashbull	K	114%	90%	96%
Khafzotaj	K	79%	53%	48%
Gjepalaj	K	18%	14%	20%
Katund i Ri	K	46%	45%	38%
Maminas	K	24%	19%	23%
Ishëm	K	26%	22%	34%
Krujë	B	78%	62%	117%
Fushë-Krujë	B	119%	86%	136%
Nikël	K	29%	33%	35%
Bubq	K	21%	20%	23%
Kodër Thumanë	K	43%	36%	47%
Cudhi	K	16%	12%	14%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet autorët

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 12. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor

	OSR për frymë /AOSR për frymë		
	2011	2010	2009
Durrës	149%	152%	180%
Shijak	48%	59%	54%
Manëz	39%	51%	35%
Sukth	39%	43%	41%
Rashbull	179%	164%	173%
Khafzotaj	189%	138%	92%
Gjepalaj	22%	22%	13%
Katund i Ri	58%	99%	22%
Maminas	91%	70%	37%
Ishëm	35%	54%	102%
Krujë	88%	93%	73%
Fushë-Krujë	122%	95%	88%
Nikël	57%	142%	125%
Bubq	10%	55%	11%
Kodër Thumanë	17%	28%	19%
Cudhi	3%	3%	2%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 13. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve

Qarku DURRËS	TE për frymë/ATE për frymë		
	2011	2010	2009
Durrës	139%	135%	81%
Shijak	52%	101%	119%
Manëz	51%	62%	120%
Sukth	68%	59%	66%
Rashbull	122%	102%	101%
Khafzotaj	78%	100%	98%
Gjepalaj	97%	114%	43%
Katund i Ri	89%	79%	65%
Maminas	49%	57%	112%
Ishëm	117%	98%	288%
Krujë	94%	75%	144%
Fushë-Krujë	94%	101%	114%
Nikël	90%	92%	162%
Bubq	35%	48%	85%
Kodër Thumanë	60%	55%	45%
Cudhi	71%	71%	87%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet autorët


Duke iu referuar të tre treguesve të zhvilluar në tabelat e mësipërme evidentojmë disa prej NJQV-ve të qarkut Durrës, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve

mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banor. Këto janë komunat e Bubqit, Kodër Thumanës, Cudhi, e Gjepalaj.

3.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Durrës

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë në NJQV-të e qarkut Durrës.

Figura 19. Të ardhurat dhe shpenzimet për banor në NJQV-të e qarkut Durrës (2008 – 2011)




Të ardhurat totale/banor

Shpenzimet totale / banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tonë

Mesatarja e të ardhurave për frymë në NJQV-të e qarkut Durrës është rreth 54 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. E ardhura më e lartë për frymë rezulton në Krujë dhe Fushë Krujë (rreth 70 Euro/banor), ndërsa më e ulëta në Bubq (rreth 38 Euro/banor). Thuajse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banor.

Figura 20. Shpenzimet totale për banor krahasuar me të ardhurat e veta të NJQV-së për banor në qarkun e Durrësit



Shpenzimet totale/banor

Të ardhurat e veta të NJQV-së/banor


Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tonë

Referuar hartës për të ardhurat e veta të NJQV/banor, vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë

nga 15 Euro/banor (Bubq) në 59 Euro/banor (Durrës), të ardhurat e vetë njësisë vendore variojnë nga 1 Euro/banor (Cudhi) në 74 Euro/banor (Xhafzotaj).

Le të shikojmë se çfarë ndodh në lidhje me investimet kapitale në NJQV-të e qarkut Durrës, duke përdorur si bazë krahasimore investimet kapitale për frymë në NJQV-të ndryshme.

Figura 21. Investimet kapitale krahasuar me shpenzimet totale të NJQV-ve dhe grantet e kushtëzuara për banor në NJQV-të e qarkut Durrës



Investimet kapitale/Totalin e Shpenzimeve


Grantet e kushtëzuara/banorë

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Niveli i investimeve kapitale për banorë varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësisë të qeverisjes vendore (Shijak, Manëz, Bubq, Krujë, Cudhi, Maminas e Gjepalaj). Po ashtu ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011 niveli më i ulët i investimeve kapitale për frymë është në komunën Manëz 1,3 Euro/banorë dhe më i lartë në bashkinë Durrës 27 Euro/banorë. Kujtojmë se mesatarja e investimeve kapitale për banorë në nivel vendor është 14,3 Euro.

Më e qëndrueshme paraqitet shpërndarja e granteve të kushtëzuara në NJQV-të e qarkut Durrës. Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banorë në NJQV-të e Durrësit është rreth 23,4 Euro në vitin 2011, krahasuar me mesataren kombëtare prej rreth 30 Euro/banorë. Duke i referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për banorë e ka komuna Rashbull (15 Euro/banorë) dhe nivelin më të lartë Komuna Cudhi (42 Euro/banorë).

Figura 22. Shpenzimet operative dhe shpenzimet për paga e sigurime të NJQV-ve të qarkut Durrës



Shpenzimet operative / Shpenzimet totale

Shpenzimet për paga e sigurime / shpenzimet operative

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Durrës zënë mesatarisht 62% të totalit të shpenzimeve, e krahasueshme me mesataren në nivel vendi prej 66%. Megjithatë, për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë veçanërisht të larta (Shijak, Manëz, Krujë, Cudhi në vlera mes 80-90%).

Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Durrës mesatarisht 66%, raport gati 10% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve, vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Kodër Thumanë, Bubq, Ishëm, etj.).

3.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Durrës

NJQV-të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Ato janë bashkë-përgjegjëse për të sjellë/nxitur dhe mbajtur investime në territorin e tyre duke përmirësuar klimën për biznesin. Instrumentet më efektive për zhvillimin ekonomik lokal janë një sërë strategjish/aksionesh që mundësojnë infrastrukturën dhe lehtësirat e nevojshme për biznesin. Referuar kësaj logjike, disa prej treguesve që mund të konsiderojmë për të vlerësuar klimën dhe mundësinë për zhvillim ekonomik që ofron një NJQV, janë listuar më poshtë dhe do të shtjellohen më tej në dokument.

- c. Të ardhurat nga taksat e biznesit për banorë (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 14. Taksa e biznesit të vogël (TBV) për banorë sipas NJQV-ve të qarkut Durrës krahasuar me mesataren për banorë në nivel kombëtar

Qarku Durrës	TBV/banorë			
	2008	2009	2010	2011
Durrës	8,26	9,33	7,26	6,97
Shijak	4,31	4,12	5,15	5,48
Manëz	2,16	2,05	1,39	1,36
Sukth	2,16	1,79	1,72	1,36
Rashbull	3,55	3,60	3,08	3,70
Xhafzotaj	3,53	3,63	3,49	3,70
Gjepalaj	0,34	0,37	0,39	0,61
Katund i Ri	0,67	0,58	0,55	0,10
Maminas	1,39	1,49	1,34	1,38
Ishëm	1,44	2,03	2,04	1,72
Krujë	2,63	2,22	1,80	2,01
Fushë-Krujë	1,98	2,04	2,22	2,07
Nikël	0,63	0,94	0,66	1,06
Bubq	0,90	0,45	0,25	0,68
Kodër Thumanë	0,20	0,18	0,31	0,18
Cudhi	-	-	-	-
Mesatarja kombëtare	4,34	4,30	4,12	4,37

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Referuar këtij treguesi, janë fare pak NJQV në qarkun Durrës që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banorë prej biznesit. Ato janë Durrësi, Shijaku, Xhafzotaj dhe Rashbulli.

Le të shikojmë edhe treguesit e tjerë për të vlerësuar se cilat prej NJQV-ve të qarkut të Durrësit mundësojnë kushte për zhvillimin ekonomik e cilat jo.

- d. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (tokë dhe ndërtesë), nga taksa e automjeteve etj.

Tabela 15. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banorë sipas NJQV-ve të qarkut Durrës, krahasuar me mesataren kombëtare për banorë


Qarku Durrës	Taksa e pasurisë/banorë			
	2008	2009	2010	2011
Durrës	6,04	5,51	5,17	5,48
Shijak	1,09	0,98	1,04	0,92
Manëz	0,66	0,73	0,69	0,73
Sukth	0,71	0,74	0,95	0,92
Rashbull	4,84	5,22	5,61	6,63
Xhafzotaj	2,33	2,21	3,05	4,92
Gjepalaj	0,43	0,26	1,81	2,91
Katund i Ri	0,62	0,25	1,37	1,16
Maminas	1,60	2,19	4,88	3,71
Ishëm	0,77	0,71	0,69	0,35
Krujë	0,61	0,65	4,12	6,32
Fushë-Krujë	6,11	2,84	3,12	2,76
Nikël	2,86	2,77	3,34	3,04
Bubq	0,99	0,60	0,68	0,99
Kodër Thumanë	0,90	0,66	0,92	0,70
Cudhi	-	0,37	0,45	0,30
Mesatarja në vend	3,11	2,85	3,10	3,24

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Një pjesë e NJQV-ve që rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë janë po ashtu njësi që gjenerojnë të ardhura të larta për banorë nga TBV-ja krahasuar me NJQV-të e tjera të qarkut. Duket se bashkia Durrës dhe komunat Xhafzotaj dhe Rashbull i plotësojnë më mirë këto kritere.


e. Numri i bizneseve sipas NJQV-ve; numri i bizneseve për banorë

Figura 23. Numri i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve sipas NJQV-ve në qarkun Durrës



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet tona

Figura 24. Numri i bizneseve për 1,000 banorë në NJQV-të e qarkut Durrës



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet tona

3.5 Profili social

- Qarku i Durrësit ka 16 njësi administrative. Popullsia është 266 823 banorë – i katërti në Shqipëri.
- Qarku i Durrësit ka shënuar një rritje të lehtë 9% në krahasim me 2001. Rritje veçanërisht të madhe kanë parë zonat urbane (56%), ndërsa zona rurale ka ardhur duke u tkurrur në mënyrë të konsiderueshme (-46%). Dendësia gjithashtu ka ardhur duke u rritur (9%).
- Durrësi njihet ashtu si Tirana për efektin tërheqës të migrimit të brendshëm. Qarku ka rreth 66 650 familje.
- Popullsia rinore (15 – 29 vjeç) përbën 25% të popullsisë.
- Ndërsa pjesa tjetër, 11 883 persona që përfaqësojnë rreth 4,5% të popullsisë, janë persona me aftësi të kufizuara.
- Popullsia në moshë pune 15 - 64 vjeç është 178 150 persona ose rreth 66,7%, ndërsa moshë e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 10%. Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun Durrës janë 8947 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 548 përfitojnë pagesë papunësie.
- 11 498 persona janë kthyer nga migracioni prej vitit 2001 deri më 2011, ku 70,8% të të gjithë të kthyerve e zënë meshkujt.

Strehimi

- 66 650 familje, 60 918 në pronësi ose në proces pronësimi, 3361 me qira, 2371 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Durrësit ka mesatarisht 3,08 dhoma.
- 2328 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 7176 janë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 65 694 banesa të banuara) ose rreth 14,5% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 2900 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër nga 65 694 banesa të banuara) ose 4,4%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Durrësit shënon një nivel varfërie prej 16,2%. Thellësia e varfërisë është 3,3% dhe ashpërsia 1,1%. Këta tregues janë më të lartë se niveli kombëtar i varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Pak më shumë se 1442 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Durrësit ose rreth 1,47% në rang vendi (viti 2010). I rëndësishëm është kontrasti i varfërisë me numrin e ulët të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike vetëm 2,16% në qark).
- Koeficienti GINI për qarkun e Durrësit është 26,9.
- Konsumi total për familje në këtë qark është 49 347 lekë krahasuar me konsumin për person që është 11 486 lekë.

Shëndetësia

- 11 883 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç e barabartë me rreth 6%
- 2 spitale me 464 shtretër, si dhe 230 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Durrësit kemi një numër total mjekësh prej 386.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 13 minuta, ndërsa në zonat rurale 16 minuta.
- Sipas ndarjes të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 14 minuta për jo të varfrit dhe 15 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 5336 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç e barabartë me 2,3%.

Shërbimet

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	2
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	1
Shërbime sociale për fëmijët	1	9
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	2
Shërbime sociale për PAK	2	4
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	0
Gjithsej	4	18

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

3.6 Përfundime

Popullsia e qarkut Durrës përbën rreth 9,4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 16 424 banorë/NJQV. Kjo mesatare është gati dy herë më e lartë se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV).

Dendësia mesatare e popullsisë është 473 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi.

Njësitë vendore të qarkut Durrës zënë një vend të rëndësishëm në totalin e shpenzimeve vendore. Ato shpenzojnë rreth 8,5% të totalit të shpenzimeve vendore ose 0,2% të PBB-së.

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Durrës përbëhen në pjesën më të madhe (thujse 60%) prej të ardhurave të grumbulluara prej vetë njërive vendore dhe në rreth 34% prej transfertës së pakushtëzuar.

Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Durrës: Janë evidentuar disa prej NJQV-ve të qarkut Durrës, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banorë, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banorë. Të tilla janë komunat e Bubqit, Kodër Thumanës, Cudhi e Gjepalaj.

Performanca financiare dhe fiskale: Vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banorë të gjeneruara nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banorë sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërsa shpenzimet totale për banorë variojnë nga 15 Euro/banorë (Bubq) në 59 Euro/banorë (Durrës), të ardhurat e vetë variojnë nga 1 Euro/banorë (Cudhi) në 74 Euro/banorë (Xhafzotaj). Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Durrës zënë mesatarisht 62% të totalit të shpenzimeve, e krahasueshme me mesataren në nivel vendi prej 66%. Megjithatë, për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë veçanërisht të larta (Shijak, Manëz, Krujë, Cudhi në vlera mes 80-90%) Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Durrës mesatarisht 66%, raport gati 10% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Kodër Thumanë, Bubq, Ishëm etj.)

Konkurrueshmëria mes NJQV-ve dhe mundësia për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor: janë fare pak NJQV në qarkun Durrës që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banorë prej biznesit. Ato janë Durrësi, Shijaku, Xhafzotaj dhe Rashbulli. Një pjesë e NJQV-ve që rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë janë po ashtu njësi që gjenerojnë të ardhura të larta për banorë nga TBV-ja krahasuar me NJQV-të e tjera të qarkut. Duket se bashkia Durrës dhe komunat Xhafzotaj dhe Rashbull i plotësojnë më mirë këto kritere.


4 Qarku Dibër

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Dibrës. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

4.1 Profili i qarkut Dibër dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Dibrës përbëhet prej tre rretheve: rrethi i Dibrës, i Bulqizës dhe i Matit dhe prej 35 njësive të qeverisjes vendore (NJQV) të organizuara - 15 në rrethin e Dibrës, 8 në rrethin e Bulqizës dhe 12 në rrethin e Matit. Qarku i Dibrës ka një popullsi prej 137 047 banorësh (në rrethin e Dibrës janë 61 619 banorë, në rrethin e Matit janë 44 218 banorë dhe në rrethin e Bulqizës janë 31 210 banorë) (INSTAT, Census 2011).


Figura 25. NJQV-të në qarkun e Dibrës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Referuar të dhënave të INSTAT-it gjatë periudhës mes dy Census-eve 2001 dhe 2011, popullsia në qarkun e Dibrës ka pësuar ndryshime të ndjeshme. Në tetor të vitit 2011 popullsia në qarkun e Dibrës rezulton rreth 53 000 banorë më pak se në vitin 2001. Të gjitha NJQV-të e qarkut Dibër kanë humbur mesatarisht rreth 710 banorë gjatë 10 vjetëve. Rrethi i Dibrës ka humbur rreth 27 400 banorë gjatë viteve 2001 – 2011.

Figura 26. Ndryshimi i popullsisë në NJQV-të sipas rretheve dhe qarqeve 2001 – 2011



Burimi: INSTAT 2011, Llogaritjet tona

Edhe në rrethin e Dibrës vihen re ndryshime të dukshme në të dhënat për popullsinë mes dy burimeve, INSTAT-it dhe RGJC-së.

Tabela 16. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Dibër

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011	RGJC 2011	DIFERENCA
Bulqizë	Bulqizë	8177	12 328	-4151
Bulqizë	Fushë Bulqizë	3342	4012	-670
Bulqizë	Gjoricë	4214	5265	-1051
Bulqizë	Martanesh	1836	2437	-601
Bulqizë	Ostren	3034	4210	-1176
Bulqizë	Shupenzë	5503	6748	-1245
Bulqizë	Trebisht	993	5149	-4156
Bulqizë	Zerqan	4111	-	4111
Total Bulqizë		31 210	40 149	-8939
Dibër	Arras	3055	3908	-853
Dibër	Fushë Çidhën	2909	3657	-748
Dibër	Fushë Muhurr	2780	3484	-704
Dibër	Kala e Dodës	2252	3091	-839
Dibër	Kastriot	6200	7418	-1218
Dibër	Lurë	1096	1477	-381
Dibër	Luzni	2433	3167	-734
Dibër	Maqellarë	10 662	13 367	-2705
Dibër	Melan	3649	4456	-807
Dibër	Peshkopi	13 251	18 747	-5496
Dibër	Qendër Tomin	7590	8557	-967
Dibër	Selishtë	1605	1933	-328
Dibër	Sllovë	2405	3234	-829
Dibër	Zall Dardhë	1051	-	1051
Dibër	Zall Reç	681	-	681
Total Dibër		61 619	76 496	-14 877
Mat	Baz	2228	3198	-970
Mat	Burrel	10 862	16 842	-5980
Mat	Derjan	1102	3528	-2426
Mat	Gurrë	3369	4031	-662
Mat	Klos	7873	10 137	-2264
Mat	Komsi	4283	5232	-949
Mat	Lis	3824	4732	-908
Mat	Macukull	1565	2368	-803
Mat	Rukaj	2507	3604	-1097
Mat	Suç	2716	3466	-750
Mat	Ulëz	1229	1989	-760
Mat	Xibër	2660	3390	-730
Total Mat		44 218	62 517	-18 299
Total qarku Dibër		137 047	179 162	-42 115

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet tona

Duke pasur parasysh morfologjinë e territorit, njësitë e qeverisjes vendore në qarkun Dibër prezantohen fare të vogla për sa i përket numrit të popullsisë. Kjo reflektohet edhe në dendësinë relativisht të lartë krahasuar me mesataren e vendit – 159 banorë/km² krahasuar me 94 banorë/km² në nivel vendi. Dendësia më e ulët është në komunën e Lurës, në rrethin Mat – 8 banorë/km² dhe dendësia më e lartë është në bashkinë e Peshkopisë – 2985 banorë/km². Më tepër se 75% e NJQV-ve të qarkut kanë më pak se 5000 banorë dhe 26% e tyre kanë më pak se 2000 banorë.


Tabela 17. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Dibër sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi

Klasifikimi i NJQV-ve sipas numrit të popullsisë	Qarku Dibër	Shqipëria
Popullsia	4,89%	100,00%
Popullsia mesatare për NJQV	3916	8016
< 2000	25,71%	27,61%
2000-5000	51,43%	34,58%
5000-10 000	14,29%	26,27%
10 000-20 000	8,57%	6,70%
20 000-30 000	0,00%	1,61%
30 000-50 000	0,00%	1,07%
50 000-100 000	0,00%	1,61%
100 000-200 000	0,00%	0,27%
> 200 000	0,00%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Njësitë vendore të qarkut Dibër zënë mesatarisht 3,9% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,1% të PBB-së.


Figura 27. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Dibër krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Shpenzimet kapitale në NJQV-të e qarkut Dibër përbëjnë mesatarisht 40% të shpenzimeve, ndërsa shpenzimet për personelin rreth 34% të totalit të shpenzimeve.


Figura 28. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Dibër



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Të ardhurat e NJQV-ve në qarkun Dibër ndjekin pak a shumë tendencën e shpenzimeve. Por ajo që bie në sy në rastin e qarkut Dibër është se niveli i të ardhurave të NJQV-ve përbën rreth 7% të të ardhurave totale vendore, e kjo vjen kryesisht si rezultat i granteve të kushtëzuara të destinuara për këtë qark.


Figura 29. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Dibër kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Grafiku më poshtë tregon pikërisht përbërjen e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Dibrës. Ajo që bie në sy edhe në këtë grafik është vendi që zënë të ardhurat prej granteve të kushtëzuara në totalin e të ardhurave vendore – rreth 60% të totalit të të ardhurave.

Figura 30 Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Dibrës




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

4.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Dibër

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Dibër, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.


Figura 31. Raporti mes buxheteve të NJQV-ve me mesataren e buxheteve të NJQV-ve të qarkut Dibër



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banorë në qarkun Dibër krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banorë.


Figura 1. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor (në qarkun Dibër) krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 1. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor (në qarkun Dibër) krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve


Referuar të tre treguesve të zhvilluar në figurat e mësipërme evidentojmë disa prej NJQV-ve të qarkut Dibër, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të

qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banorë. Të tilla janë mbi 50% e NJQV-ve të qarkut Dibër, si Tomin, Kastriot, Zall Dardhë, Fushë Bulqizë, Komsj, Rukaj, Xibër etj.

4.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Dibër

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë në NJQV-të e qarkut Dibër.

Figura 2. Të ardhurat dhe shpenzimet për banor në NJQV-të e qarkut Dibër (2008 – 2011)




Të ardhurat totale/banor

Shpenzimet totale/banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Mesatarja e të ardhurave për frymë në NJQV-të e qarkut Dibër është rreth 93,51 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. Kjo mesatare ndjeshëm më e lartë se ajo kombëtare rezulton kryesisht si rezultat i granteve të kushtëzuara të alokuara në këtë qark. E ardhura më e lartë për frymë rezulton në Lurë, Zall Dardhë dhe Zall Reç (mbi 150 Euro/banor), ndërsa më e ulëta në Maqellarë e Tomin (rreth 55 Euro/banor). Thuajse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banorë.

Figura 3. Shpenzimet totale për banorë krahasuar me të ardhurat e veta të NJQV-së për banorë në qarkun e Dibrës



Shpenzimet totale/banor

Të ardhurat e veta të NJQV-së/banor


Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritja e autorëve

Referuar hartës për të ardhurat e veta të NJQV-së/banor, vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banorë të gjeneruara nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banorë sipas NJQV-ve

vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banorë variojnë nga 13,53 Euro/banor (Fushë Çidhën) në 122,62 Euro/banor (Derjan), të ardhurat e veta variojnë nga 0,22 Euro/banor (Gurë) në 33,46 Euro/banor (Peshkopi).

Le të shohim se çfarë ndodh në lidhje me investimet kapitale në NJQV-të e qarkut Dibër, duke përdorur si bazë krahasimore sërish investimet kapitale për frymë në NJQV-të ndryshme.

Figura 4. Investimet kapitale krahasuar me shpenzimet totale të NJQV-ve dhe grantet e kushtëzuara për banor në NJQV-të e qarkut Dibër



Investimet kapitale/Totalin e Shpenzimeve

Grantet e kushtëzuara/banor


Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësisve të qeverisjes vendore (Macukull, Tomim, Selishtë, Lis, Ulëz, Ostren, Trebisht/Klenjë). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011 niveli më i ulët i investimeve kapitale për frymë është në komunën Arras 1,79 Euro/banor dhe më i lartë në Komunën Suç 102,42 Euro/banor. Ndërkohë janë 5 NJQV që raportojnë zero investime kapitale për vitin 2011 (Shupenzë, Zall Reç, Fushë Çidhën, Macukull dhe Lis). Kujtojmë se mesatarja e investimeve kapitale për banor në nivel vendor është 14,3 Euro.

Më e qëndrueshme paraqitet shpërndarja e granteve të kushtëzuara në NJQV-të e qarkut të Dibrës. Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banor në NJQV-të e Dibrës është rreth 60,16 Euro/banor në vitin 2011, thuajse dy herë më shumë krahasuar me mesataren kombëtare prej rreth 30 Euro/banor.

Duke iu referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për banor e ka komuna Klenjë/Trebisht (30 Euro/banor) dhe nivelin më të lartë Komuna Zall Reç (115,34 Euro/banor)

Figura 5. Shpenzimet operative dhe shpenzimet për paga e sigurime të NJQV-ve të qarkut Dibër



Shpenzimet operative / Shpenzimet totale

Shpenzimet për paga e sigurime/shpenzimet operative

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Dibër zinin mesatarisht 69% të totalit të shpenzimeve, e krahasueshme me mesataren në nivel vendi prej 66%. Megjithatë, për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë veçanërisht të larta (Shupenzë, Zall Reç, Fushë Çidhën, Arras, Macukull, Lis etj., në vlera rreth 100%).


Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Dibër mesatarisht 63%, raport gati 7% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh., në Ulëz, Selishtë, Melan, Fushë Bulqizë etj.)

4.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Dibër

Disa prej treguesve që mund të konsiderojmë për të vlerësuar klimën dhe mundësinë për zhvillim ekonomik që ofron një NJQV, janë listuar më poshtë dhe do të shtjellohen më tej në dokument.

- a. Të ardhurat nga taksat e biznesit për banor (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).


Tabela 2. Taksa e biznesit të vogël (TBV) për banorë sipas NJQV-ve të qarkut Dibër krahasuar me mesataren për banor në nivel kombëtar



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

- b. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (tokë dhe ndërtesë), nga taksa e automjeteve etj.


Tabela 3. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Dibër, krahasuar me mesataren kombëtare për banor



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve


- c. Numri i bizneseve sipas NJQV-ve; numri i bizneseve për banor.

Figura 6. Numri i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve sipas NJQV-ve në qarkun Dibër



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Figura 7. Numri i bizneseve për 1000 banorë në NJQV-të e qarkut Dibër



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Treguesit e mësipërm japin një panoramë më të plotë të mundësisë që NJQV-të e qarkut Dibër kanë për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal e për të gjeneruar rrjedhimisht të ardhura të konsiderueshme prej taksës së biznesit të vogël apo taksës së pasurisë. Janë fare pak NJQV (Bulqizë, Burrel e Peshkopi), të cilat arrijnë të gjenerojnë nga biznesi i vogël të ardhura të krahasueshme me mesataren në nivel vendi. Ndërkohë, për sa i përket taksës së pasurisë

e cila lidhet njëkohësisht edhe me kërkesën për të zhvilluar territorin, asnjë nga NJQV-të nuk e arrin mesataren në nivel vendi.

4.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Dibrës ka 35 njësi administrative. Popullsia e Dibrës në 2013 raportohet rreth 132 876 banorë.
- Qarku i Dibrës hyn te grupi i qarqeve popullsia e të cilëve është zvogëluar konsiderueshëm në krahasim me 2001 (30%). Popullsia rurale është zvogëluar me rreth 35%, ndërsa ajo urbane me rreth 10%. Dendësia gjithashtu ka ardhur duke u zvogëluar (30%).
- Qarku ka 29 573 familje.
- Popullsia në moshë pune në qarkun e Dibrës është 90 513 persona ose e shprehur në përqindje, kjo do të përbënte 66% të totalit të popullsisë së qarkut. Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun Dibrë janë 6448 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 354 përfitojnë pagesë papunësie.
- Popullsia emigruese e kthyer është 3589 persona, ku meshkujt zënë 88% të të gjithë të kthyerve.

Strehimi

- 29 573 familje, 26 813 në pronësi ose në proces pronësimi, 798 me qira, 1962 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Dibrës ka mesatarisht 2,81 dhoma.
- 1923 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 4841 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 28 947 banesa të banuara) ose 23,3% (shifër e lartë) nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Mbi 6000 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër nga 28 947 banesa të banuara) ose më shumë se 21% (shifër e lartë)

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Dibrës shënon një nivel varfërie prej 13%. Thellësia e varfërisë është 2,3% dhe ashpërsia 0,7%. Këta tregues janë më të mirë krahasuar me nivelin kombëtar të varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Rreth 14 000 familje përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Dibrës ose rreth 14% në rang vendi (viti 2010). Konsideruar me numrin e përgjithshëm të familjeve në Dibër – sipas kësaj të dhëne – ndihme ekonomike përfitojnë rreth 47% e familjeve në këtë qark.
- Koeficienti GINI për qarkun e Dibrës është 20,9.
- Konsumi total për familje në këtë qark është 47 551 lekë krahasuar me konsumin për person që është 9862 lekë.

Shëndetësia

- 6152 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 6,3%.
- 3 spitale me 508 shtretër, si dhe 62 qendra shëndetësore.
- Në qarkun Dibër kemi një numër total mjekësh prej 114.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 11 minuta, ndërsa në zonat rurale 23 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më i afërt është 19 minuta për jo të varfrit dhe 24 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 3567 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 3%.

Shërbimet

Sipas raportit të fundit mbi shpërndarjen e shërbimeve sociale vihet re se në qarkun Dibër ekziston vetëm një qendër shërbimesh sociale, e cila është në varësi të Bashkisë Kukës, ndërkohë që në Bulqizë nuk ka asnjë shërbim.

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	0	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	2
Shërbime sociale për fëmijët	0	5
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	3
Shërbime sociale për PAK	1 ²	1
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	0
Gjithsej	1	12

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

4.6 Përfundime

Popullsia e qarkut Dibër përbën rreth 5% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Censurit 2011 (INSTAT 2011).

Dendësia mesatare e popullsisë është 159 banorë/km² krahasuar me 94 banorë/km² në nivel vendi. Dendësia më e ulët është në Komunën e Lurës, në Rrethin Mat – 8 banorë/km² dhe ajo më e larta është në bashkinë e Peshkopisë – 2985 banorë/km². Më tepër se 75% e NJQV-ve të qarkut kanë më pak se 5000 banorë dhe 26% e tyre kanë më pak se 2000 banorë.

Njësitë vendore të qarkut Dibër zënë mesatarisht 3,9% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,1% të PBB-së.

Shpenzimet kapitale në NJQV-të e qarkut Dibër përbëjnë mesatarisht 40% të shpenzimeve, ndërsa shpenzimet për personelin rreth 34% të totalit të shpenzimeve.

Të ardhurat e NJQV-ve në qarkun Dibër ndjekin pak a shumë tendencën e shpenzimeve. Por ajo që bie në sy në rastin e qarkut Dibër është se niveli i të ardhurave të NJQV-ve përbën rreth 7% të të ardhurave totale vendore, e kjo vjen kryesisht prej granteve të kushtëzuara të destinuara për këtë qark, të cilat përbëjnë 60% të totalit të të ardhurave.

Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Dibër: evidentojmë disa prej NJQV-ve të qarkut Dibër, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banorë, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banorë. Të tilla janë mbi 50% e NJQV-ve të qarkut Dibër, si Tomin, Kastriot, Zall Dardhë, Fushë Bulqizë, Komsj, Rukaj, Xibër etj.

Performanca financiare dhe fiskale: Mesatarja e të ardhurave për frymë në NJQV-të e qarkut Dibër është rreth 93,51 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. Kjo mesatare ndjeshëm më e lartë se ajo kombëtare rezulton kryesisht si rezultat i granteve të kushtëzuara të alokuara në këtë qark. E ardhura më e lartë për frymë rezulton në Lurë, Zall Dardhë dhe Zall Reç (mbi 150 Euro/banor), ndërsa më e ulëta në Maqellarë e Tomin (rreth 55 Euro/banor)

² Nën përgjegjësinë e bashkisë

Thujse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banorë.

Vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banorë sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 13,53 Euro/banor (Fushë Çidhën) në 122,62 Euro/banor (Derjan), të ardhurat e veta variojnë nga 0,22 Euro/banor (Gurë) në 33,46 Euro/banor (Peshkopi).

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësisë të qeverisjes vendore (Macukull, Tomin, Selishtë, Lis, Ulëz, Ostren, Trebisht/Klenjë). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011 niveli më i ulët i investimeve kapitale për frymë është në komunën Arras 1,79 Euro/banor dhe më i lartë në komunën Suç 102,42 Euro/banor. Ndërkohë, janë 5 NJQV të cilat raportojnë zero investime kapitale për vitin 2011 (Shupenzë, Zall Reç, Fushë Çidhën, Macukull dhe Lis). Kujtojmë se mesatarja e investimeve kapitale për banor në nivel vendor është 14,3 Euro.

Më e qëndrueshme paraqitet shpërndarja e granteve të kushtëzuara në NJQV-të e qarkut Dibër. Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banor në NJQV-të e Dibrës është rreth 60,16 Euro në vitin 2011, thujse dy herë më shumë krahasuar me mesataren kombëtare prej rreth 30 Euro/banor.

Duke iu referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për banor e ka komuna Klenjë/Trebisht (30 Euro/banor) dhe nivelin më të lartë Komuna Zall Reç (115,34 Euro/banor)

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Dibër zënë mesatarisht 69% të totalit të shpenzimeve, e krahasueshme me mesataren në nivel vendi prej 66%. Megjithatë, për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë veçanërisht të larta (Shupenzë, Zall Reç, Fushë Çidhën, Arras, Macukull, Lis etj., në vlera rreth 100%).

Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Dibër mesatarisht 63%, pra gati 7% më e lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa NJQV vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh., në Ulëz, Selishtë, Melan, Fushë Bulqizë etj.)

Konkurrueshmëria mes NJQV-ve dhe mundësia për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor: Referuar treguesve të përdorur, të cilët japin një panoramë më të plotë të mundësisë që NJQV-të e qarkut Dibër kanë për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal e për të gjeneruar rrjedhimisht të ardhura të konsiderueshme prej taksës së biznesit të vogël apo taksës së pasurisë, themi se janë fare pak NJQV (Bulqizë, Burrel e Peshkopi), të cilat arrijnë të gjenerojnë nga biznesi i vogël të ardhura të krahasueshme me mesataren në nivel vendi. Ndërkohë, për sa i përket taksës së pasurisë e cila lidhet njëkohësisht edhe me kërkesën për të zhvilluar territorin, asnjë nga NJQV-të nuk e arrin mesataren në nivel vendi.


5 Qarku Elbasan

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Elbasanit. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

5.1 Profili i qarkut Elbasan

Qarku i Elbasanit përbëhet nga 50 njësi të qeverisjes vendore në katër rrethe: rrethi i Elbasanit (23 njësi, qendër Elbasan); rrethi i Gramshit (10 njësi, qendër Gramsh), rrethi i Librazhdit (11 njësi, qendër Librazhd) dhe rrethi i Peqinit (6 njësi, qendër Peqin). Popullsia e qarkut të Elbasanit ishte 295 827 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 64% (188 662 banorë) jetojnë në rrethin e Elbasanit, 19% (56 798) jetojnë në rrethin e Librazhdit dhe vetëm nga 9% jetojnë përkatësisht në Gramsh dhe Peqin. (INSTAT, Census 2011).

Figura 8. NJQV-të në qarkun e Elbasanit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Qarku i Elbasanit ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 31% ose mbi 131 000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012, në qarkun e Elbasanit ishin të regjistruar 427 114 banorë, me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011, pra 65% në Elbasan, 17,7% në Librazhd dhe 8,7% dhe 8,4% të regjistruar përkatësisht në Peqin dhe Gramsh.

Tabela 18. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Elbasan

Qarku	Rrethi	Njësia	Census 2011	Regjistri civil 2011	Ndryshimi i popullsisë	Ndryshimi në %
Elbasan	Elbasan	Rrasë	1594	2294	-700	-31%
Elbasan	Elbasan	Zavalinë	1622	2100	-478	-23%
Elbasan	Elbasan	Fierzë	2065	3738	-1673	-45%
Elbasan	Elbasan	Funarë	2122	3137	-1015	-32%
Elbasan	Elbasan	Gracen	2192	2521	-329	-13%
Elbasan	Elbasan	Tregan	3036	4282	-1246	-29%
Elbasan	Elbasan	Grekan	3138	5014	-1876	-37%
Elbasan	Elbasan	Klos	3262	4160	-898	-22%
Elbasan	Elbasan	Gjinar	3478	4808	-1330	-28%
Elbasan	Elbasan	Shalëz	3842	6831	-2989	-44%
Elbasan	Elbasan	Kajan	3925	6423	-2498	-39%
Elbasan	Elbasan	Gjergjan	5126	7532	-2406	-32%
Elbasan	Elbasan	Labinot mal	5291	5474	-183	-3%
Elbasan	Elbasan	Mollas	5530	7673	-2143	-28%
Elbasan	Elbasan	Papër	6348	8895	-2547	-29%
Elbasan	Elbasan	Cërrik	6695	14 711	-8016	-54%
Elbasan	Elbasan	Labinot fushë	7058	6263	795	13%
Elbasan	Elbasan	Shirgjan	7307	9789	-2482	-25%
Elbasan	Elbasan	Gostime	8116	12 297	-4181	-34%
Elbasan	Elbasan	Shushicë	8731	10 543	-1812	-17%
Elbasan	Elbasan	Belsh	8781	13 675	-4894	-36%
Elbasan	Elbasan	Bradashesh	10 700	12 428	-1728	-14%
Elbasan	Elbasan	Elbasan	78 703	123 884	-45 181	-36%
ELBASAN gjithsej			188 662	278 472	-89 810	-32%
Elbasan	Gramsh	Sult	631	1353	-722	-53%
Elbasan	Gramsh	Kushovë	659	1062	-403	-38%
Elbasan	Gramsh	Lenie	779	1807	-1028	-57%
Elbasan	Gramsh	Skënderbegas	1239	2291	-1052	-46%
Elbasan	Gramsh	Poroçan	1269	1050	219	21%
Elbasan	Gramsh	Tunjë	1393	2230	-837	-38%
Elbasan	Gramsh	Kodovjat	2355	3244	-889	-27%
Elbasan	Gramsh	Kukur	2560	3417	-857	-25%
Elbasan	Gramsh	Pishaj	4906	6307	-1401	-22%
Elbasan	Gramsh	Gramsh	8440	13 243	-4803	-36%
Gramsh Total			24 231	36 004	-11 773	-33%
Elbasan	Librazhd	Steblevë	809	1198	-389	-32%
Elbasan	Librazhd	Stravaj	2427	3059	-632	-21%
Elbasan	Librazhd	Lunik	2621	3715	-1094	-29%
Elbasan	Librazhd	Polis	3385	5011	-1626	-32%
Elbasan	Librazhd	Orenjë	3883	5210	-1327	-25%
Elbasan	Librazhd	Hotolisht	5706	6926	-1220	-18%
Elbasan	Librazhd	Prrenjas	5847	8459	-2612	-31%
Elbasan	Librazhd	Librazhd	6937	9760	-2823	-29%
Elbasan	Librazhd	Qukës	8211	10 604	-2393	-23%

Elbasan	Librazhd	Rrajcë	8421	10 289	-1868	-18%
Elbasan	Librazhd	Qendër	8551	11 234	-2683	-24%
Librazhd gjithsej			56 798	75 465	-18 667	-25%
Elbasan	Peqin	Karinë	1350	1799	-449	-25%
Elbasan	Peqin	Shezë	3177	5253	-2076	-40%
Elbasan	Peqin	Përparim	3423	5376	-1953	-36%
Elbasan	Peqin	Gjocaj	5207	7012	-1805	-26%
Elbasan	Peqin	Peqin	6353	9150	-2797	-31%
Elbasan	Peqin	Pajovë	6626	8583	-1957	-23%
Peqin Total			26 136	37 173	-11 037	-30%
Totali			295 827	427 114	-131 287	-31%

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Elbasan përbën rreth 12,8% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 5917 banorë/NJQV, ose 25% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Në secilin qark ka njësi të vogla dhe më të mëdha, por përqendrimi më i madh i njësive me popullsi të vogël vërehet në rrethin e Gramshit, ku mesatarja është 2423 banorë. Njësitë më të vogla në qark janë komunat Steblevë në Librazhd dhe komunat Sult, Kushovë e Lenie në Gramsh.

Tabela 19. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Elbasan sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


	<i>Nr. i njësive</i>	<i>Min.</i>	<i>Maks.</i>	<i>Mesatare/ njësi</i>	<i>Shuma</i>	<i>% e popullsisë</i>	<i>Shqipëria</i>
Shqipëria				8016	2 311 848	100%	
Elbasan				5917	295 827	12,8	
0-2000	10	631	1622	1135	11 345	3,8%	27,61%
2001-5000	18	2065	4906	3100	55 797	18,9%	34,58%
5001-10 000	20	5126	8781	6964	139 282	47,1%	26,27%
10 001 – 20 000	1	10 700	10 700	10 700	10 700	3,6%	6,70%
20 001-30 000						0,0%	1,61%
30 001-50 000						0,0%	1,07%
50 000-100 000	1	78 703	78 703	78 703	78 703	26,6%	1,61%
100 000-200 000							
200 000+						0,0%	0,27%
						0,0%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 335 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Zonat urbane kanë dendësi më të lartë, si qyteti i Elbasanit (3548 banorë/km²), Librazhdit (3778 banorë/km²), Gramshit (3404 banorë/km²) dhe më pak Peqini (1690 banorë/km²). Komunat më të vogla të qarkut kanë gjithashtu edhe dendësinë më të ulët, nga 7 deri në 12 banorë për km², ndërkohë që gjysma e njësive kanë dendësi më të ulët se 63 banorë/km².

Pesha e njësive të qarkut Elbasan në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 7,5% në vitin 2012, me një ulje të ndjeshme krahasuar me vitin 2008 (9,5%).


Figura 32. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Elbasan krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale në qarkun e Elbasanit, mesatarisht 68% në vitet 2008 – 2012, e 74% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë rreth gjysma, ose mesatarisht 37% e shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Në nivel kombëtar, shpenzimet për personelin në qarkun e Elbasanit zënë rreth 8,4% të shpenzimeve për paga dhe sigurime ose 3,2% të shpenzimeve gjithsej. Shpenzimet kapitale kanë një peshë specifike prej 33% në strukturën totale ose 26% në vitin 2012. Ky raport është i ngjashëm me raportet kombëtare prej 34% në 5 vite ose 26% në vitin 2012. Bashkia e Elbasanit, e cila ka rreth 27% të popullsisë së qarkut (29% sipas të dhënave administrative) zë një peshë prej rreth 34% në totalin e shpenzimeve të njëjësive të qarkut, rreth 33% të shpenzimeve për paga dhe sigurime, por vetëm 15% të shpenzimeve për investime.


Figura 33. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Elbasan



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve, me rreth 57% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) me rreth 26% mesatarisht.


Figura 34. Shpenzimet sipas sektorëve (funsioneve) në NJQV-të e qarkut Elbasan



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Elbasan përbëjnë rreth 8,5% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Në vitet 2009 deri 2011 pesha specifike e të ardhurave për njësitë e qarkut të Elbasanit kanë pasur rritje në krahasim me vitin 2008, por kanë pësuar një rënie të lehtë në 2012-ën, në ngjashmëri me trendin e përgjithshëm kombëtar. Në vlera absolute të ardhurat kanë treguar rënie çdo vit nga viti 2010, me rënien më të madhe prej 12% të regjistruar në 2012.


Figura 35. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Elbasan kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë më pak se 23% të totalit në qarkun e Elbasanit, ndërkohë që në vitet 2009 - 2012 mesatarisht gjysma e të ardhurave vinin nga transfertat e kushtëzuara. Në vitin 2012, të ardhurat nga burimet e veta përbënin 21%, ndërkohë që kanë pasur një rritje të transfertës së pakushtëzuar (33%).

Figura 36. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Elbasanit



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

5.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Elbasan

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Elbasan, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- d. Buxhetin vendor i NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.

Njësia me buxhet (të ardhura totale) më të madh është natyrisht bashkia e Elbasanit (703 milionë lekë në vitin 2012). Qyteti i Elbasanit ka një peshë specifike prej 20% në buxhetin total të njësive të qarkut, ndërsa realizon rreth 45% të të ardhurave të veta totale. Bashkitë e tjera të qarkut, si Librazhdi, Gramshi dhe Peqini kanë buxhete më modeste rreth 3-4% të buxhetit total të njësive të Elbasanit. Njësitë e tjera të qarkut, veçanërisht komunat Bradashesh e Belsh në Elbasan, komuna Rrajcë dhe bashkia Përrenjas në Librazhd, të cilat kanë popullsi relativisht të madhe, kanë buxhete deri në 50% më të lartë se mesatarja e qarkut prej 70 milionësh. Gjysma e njësive kanë buxhete më të ulëta se 50 milionë lekë në vitin 2012.

- e. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 20. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor

Rreth	Njësi	2010	2011		Biznesi l vogël	Taksa pasuri	2012				
		Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta			Ndiki m infrastruktur e	Regjistrimi automjeteve	Tarifë pastrimi	Transf. pakusht.	Transf. kusht.
Elbasan	Belsh	26%	35%	40%	81%	64%	17%	76%	22%	107%	104%
Elbasan	Brada shesh	212%	195%	225%	56%	509%	98%	144%	118%	74%	27%
Elbasan	Cërrik Elbasan	38%	33%	51%	72%	44%	4%	91%	63%	118%	74%
Elbasan	Fierzë	75%	96%	84%	108%	57%	70%	135%	80%	94%	13%
Elbasan	Funarë	9%	23%	21%	1%	62%	0%	59%	0%	83%	177%
Elbasan	Gjergjan	25%	8%	7%	18%	14%	0%	15%	4%	144%	298%
Elbasan	Gjinarmë	20%	29%	33%	21%	107%	0%	67%	23%	74%	52%
Elbasan	Gostin	15%	10%	26%	18%	45%	0%	43%	8%	146%	140%
Elbasan	Gracn	41%	39%	39%	25%	84%	45%	67%	14%	76%	34%
Elbasan	Grekn	13%	6%	6%	0%	10%	0%	32%	0%	157%	130%
Elbasan	Kajan	11%	1%	8%	11%	18%	0%	44%	0%	101%	113%
Elbasan	Klos	12%	9%	16%	2%	44%	43%	53%	0%	79%	77%
Elbasan	Labinot	5%	3%	8%	0%	26%	0%	66%	0%	84%	255%
Elbasan	Fushë Labinot	29%	33%	45%	75%	115%	0%	82%	44%	72%	159%
Elbasan	Mal Mollas	30%	13%	11%	6%	34%	0%	41%	0%	131%	148%
Elbasan	Papër	20%	19%	47%	32%	115%	0%	73%	14%	77%	107%
Elbasan	Rrasë	38%	42%	45%	22%	120%	0%	60%	58%	77%	28%
Elbasan	Rrasë	3%	7%	9%	0%	30%	0%	32%	0%	104%	204%
Elbasan	Shalëz Shirgjan	24%	24%	19%	19%	57%	0%	69%	13%	71%	164%
Elbasan	Shushicë	33%	33%	39%	52%	72%	0%	100%	27%	66%	107%
Elbasan	Tregan	24%	24%	18%	17%	35%	0%	63%	0%	73%	39%
Elbasan	Zavallë	63%	52%	65%	53%	83%	0%	60%	20%	79%	90%
Elbasan	Gramsh	18%	9%	20%	3%	50%	0%	27%	0%	210%	982%
Gramsh	Kodovjat	90%	80%	92%	203%	41%	2%	64%	54%	150%	56%
Gramsh	Kukur Kushovë	13%	17%	42%	7%	39%	0%	15%	18%	148%	214%
Gramsh	Kukur Kushovë	7%	3%	7%	2%	15%	0%	6%	0%	162%	74%
Gramsh	Lenie	11%	8%	15%	0%	19%	6%	22%	22%	208%	1125%
Gramsh	Pishaj	40%	17%	28%	0%	65%	0%	22%	33%	246%	354%
Gramsh	Poroçan	26%	16%	20%	4%	47%	0%	28%	6%	105%	79%
Gramsh	Skëndербeg	17%	33%	12%	0%	11%	0%	3%	0%	197%	169%
Gramsh	Sas	10%	7%	16%	2%	10%	0%	12%	0%	170%	131%
Gramsh	Sult	5%	4%	4%	0%	9%	0%	18%	0%	182%	189%
Gramsh	Tunjë	5%	4%	6%	0%	19%	0%	14%	0%	162%	74%

Librazhd	Hoteli sht Librazhd	19%	8%	7%	9%	13%	0%	48%	0%	129%	115%
Librazhd	hd	136%	180%	121%	258%	56%	267%	113%	65%	76%	98%
Librazhd	Lunik Orenj	7%	5%	11%	1%	19%	1%	17%	6%	153%	246%
Librazhd	ë	14%	11%	10%	0%	9%	0%	17%	2%	139%	27%
Librazhd	Polis Prrenj	23%	13%	18%	46%	19%	0%	25%	12%	80%	255%
Librazhd	as Qend	119%	108%	81%	219%	8%	54%	60%	37%	100%	160%
Librazhd	ër	47%	14%	12%	11%	9%	2%	24%	1%	87%	46%
Librazhd	Qukës	25%	21%	21%	15%	19%	17%	33%	16%	106%	40%
Librazhd	Rrajcë Steble	28%	22%	29%	18%	32%	57%	33%	9%	87%	280%
Librazhd	vë Strava	24%	27%	27%	4%	19%	0%	14%	0%	383%	1176%
Librazhd	j	17%	6%	10%	13%	7%	0%	30%	0%	163%	328%
Peqin	Gjocaj Karin	27%	21%	20%	5%	55%	3%	53%	11%	74%	108%
Peqin	ë Pajov	27%	41%	38%	23%	58%	0%	85%	18%	120%	365%
Peqin	ë	31%	47%	26%	36%	16%	4%	91%	13%	83%	69%
Peqin	Peqin Përpa	67%	73%	68%	115%	53%	32%	94%	86%	100%	19%
Peqin	rim	36%	4%	20%	6%	37%	0%	46%	17%	99%	81%
Peqin	Shezë	30%	8%	15%	14%	54%	0%	55%	5%	74%	192%
		34%	34%	31%	34%	51%	14%	51%	19%	122%	192%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Siç shihet në tabelën 30, të ardhurat e veta për banor në qarkun e Elbasanit luhaten në rreth 34% të mesatares kombëtare. Edhe njësitë më të pasura të qarkut, si Elbasani, nuk arrijnë mesataren kombëtare për banor (75%, 96% dhe 84% mesatarisht për vitet 2010, 2011 dhe 2012). Njësitë e Bradasheshit, Librazhdit dhe Përrenjasit kanë të ardhura të veta mesatare për frymë më të larta se mesatarja kombëtare. Po të vrojtojmë burimet kryesore të të ardhurave, vërehet se të gjitha bashkitë kryesore të qarkut luhaten mbi ose rreth mesatares kombëtare për vlerat e taksës së biznesit të vogël. Ndërkohë, të ardhurat nga tarifa e pastrimit për banorë mbeten modeste në të gjitha njësitë, ndërkohë që vërehen luhatje të mëdha në vlerat për llojet e tjera të të ardhurave.

- f. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 21. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve

Qarku	Rrethi	Njësia	2012		2011		2010		
			Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shpenzi me personeli / frymë në % të mes. kombëtare	Investimi / frymë në % të mes. kombëtare	Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shpenzi me personeli / frymë në % të mes. kombëtare	Shpenzi me personeli / frymë në % të mes. kombëtare	
EL	Elbasan	Belsh	53%	63%	57%	48%	53%	55%	62%
EL	Elbasan	Bradashesh	142%	104%	270%	286%	85%	184%	87%
EL	Elbasan	Cërrik	69%	121%	25%	51%	92%	67%	101%
EL	Elbasan	Elbasan	87%	96%	40%	85%	93%	81%	95%
EL	Elbasan	Fierzë	25%	22%	49%	26%	57%	36%	53%
EL	Elbasan	Funarë	30%	13%	79%	112%	68%	256%	58%
EL	Elbasan	Gjergjan	27%	50%	0%	47%	45%	28%	45%
EL	Elbasan	Gjinar	57%	85%	25%	57%	79%	68%	91%
EL	Elbasan	Gostim	40%	47%	64%	51%	41%	71%	45%
EL	Elbasan	Gracen	143%	132%	218%	89%	101%	83%	103%
EL	Elbasan	Grekan	97%	75%	146%	51%	51%	59%	59%
EL	Elbasan	Kajan	92%	65%	208%	77%	40%	58%	56%
EL	Elbasan	Klos	34%	50%	0%	27%	51%	53%	69%
EL	Elbasan	Labinot Fushë	29%	59%	0%	33%	54%	44%	52%
EL	Elbasan	Labinot Mal	106%	74%	206%	99%	62%	247%	72%
EL	Elbasan	Mollas	43%	49%	71%	102%	55%	40%	63%
EL	Elbasan	Papër	49%	51%	95%	49%	67%	63%	66%
EL	Elbasan	Rrasë	27%	54%	0%	35%	74%	43%	73%
EL	Elbasan	Shalëz	30%	18%	53%	54%	43%	72%	46%
EL	Elbasan	Shirgjan	43%	59%	43%	36%	48%	42%	51%
EL	Elbasan	Shushicë	29%	24%	52%	33%	48%	46%	50%
EL	Elbasan	Tregan	57%	57%	97%	56%	89%	65%	89%
EL	Elbasan	Zavalinë	63%	127%	0%	69%	101%	102%	103%
EL	Gramsh	Gramsh	110%	150%	28%	98%	119%	141%	116%
EL	Gramsh	Kodovjakt	81%	89%	130%	99%	92%	76%	93%
EL	Gramsh	Kukur	95%	97%	106%	84%	87%	71%	82%
EL	Gramsh	Kushovë	178%	278%	0%	136%	80%	119%	116%
EL	Gramsh	Lenie	73%	157%	0%	76%	162%	143%	146%
EL	Gramsh	Pishaj	54%	52%	67%	53%	54%	85%	61%
EL	Gramsh	Poroçan	59%	136%	0%	62%	117%	156%	120%
EL	Gramsh	Skënderbegas	55%	92%	27%	56%	111%	73%	101%
EL	Gramsh	Sult	34%	61%	0%	71%	94%	168%	118%
EL	Gramsh	Tunjë	57%	94%	0%	108%	95%	72%	73%

EL	Librazhd	Hotolisht	74%	90%	123%	81%	80%	60%	61%
EL	Librazhd	Librazhd	105%	174%	75%	107%	196%	103%	174%
EL	Librazhd	Lunik	51%	80%	33%	56%	69%	71%	80%
EL	Librazhd	Orenjë	64%	73%	95%	55%	73%	59%	77%
EL	Librazhd	Polis	49%	33%	108%	35%	59%	40%	64%
EL	Librazhd	Prrreja	112%	157%	57%	115%	135%	111%	134%
EL	Librazhd	Qendër	112%	41%	360%	87%	57%	133%	57%
EL	Librazhd	Qukës	53%	67%	57%	56%	64%	90%	60%
EL	Librazhd	Rrajcë	53%	77%	60%	93%	66%	50%	65%
EL	Librazhd	Steblev	129%	229%	56%	134%	213%	150%	204%
EL	Librazhd	Stravaj	98%	110%	120%	68%	83%	71%	99%
EL	Peqin	Gjocaj	60%	77%	78%	62%	61%	41%	71%
EL	Peqin	Karinë	70%	117%	0%	44%	94%	60%	151%
EL	Peqin	Pajovë	41%	53%	56%	45%	84%	48%	106%
EL	Peqin	Peqin	110%	105%	60%	86%	102%	119%	112%
EL	Peqin	Përpari	157%	85%	385%	83%	39%	138%	89%
EL	Peqin	Shezë	30%	32%	46%	30%	48%	35%	79%
Elbasan Min.			25%	13%	0%	26%	39%	28%	45%
Elbasan Maks.			178%	278%	385%	286%	213%	256%	204%
Elbasan Mesatarja			71%	86%	79%	73%	81%	87%	86%



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Krahasimi i shpenzimeve për frymë na jep disa indikacione të rëndësishme: mesatarisht njësitë e qarkut Elbasan shpenzojnë rreth 30% më pak se mesatarja kombëtare për banor. Kujtojmë se mesatarja e të ardhurave të veta për qarkun e Elbasanit është gjithashtu mjaft më e ulët se ajo kombëtare, çka tregon shkallë të lartë varësie të njësive nga transfertat kombëtare (mesatarja e shpenzimeve 73% e mesatares kombëtare në 2011, kundrejt mesatares së të ardhurave të veta 34%). Shpenzimet për personelin janë mesatarisht më të ulëta se mesatarja kombëtare (86% dhe 81% në 2010-2011) dhe rriten disi sërish në vitin 2012, në 86% të mesatares, ndërkohë që në njësi të veçanta shpenzimet për personelin për frymë janë 2-3 herë më të larta se mesatarja kombëtare. Është interesante të vërehet se në mënyrë tipike njësitë që kanë më shumë shpenzime administrative janë ato që gjenerojnë më pak të ardhura nga burimet e veta, por që kanë një shkallë të lartë varësie nga transfertat e pakushtëzuar. I tillë është rasti i një pjese të komunave në Gramsh e Peqin.

5.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Elbasan

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë në NJQV-të e qarkut Elbasan.

Figura 37. Të ardhurat për banor përkundrejt popullsisë dhe shpenzimeve për personelin në NJQV-të e qarkut Elbasan 2011



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Mesatarja e të ardhurave për frymë në NJQV-të e qarkut Elbasan ulet nga 9218 lekë (70 Euro) në vitin 2009, në rreth 7650 lekë (55 Euro) për frymë në vitin 2012. Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë po ashtu ulet nga rreth 15 Euro në 2009 në 13,6 Euro në 2012, në krahasim me përkatësisht 27 Euro dhe 25,4 Euro të mesatares kombëtare në 2009 dhe 2012. Njësitë me të ardhura të veta më të larta për frymë janë në rend zbritës Bradasheshi dhe Librazhdi; ndërsa të ardhurat më të ulëta për frymë janë në Kukur, Lunik, Hotolisht, Grekan, Gracen e një sërë komunash të tjera të rrethit Elbasan. Qyteti i Elbasanit ka të ardhura për frymë rreth 3,6 herë më të lartë se mesatarja e qarkut prej 925 lekë për banor në 2011 (dhe 3,2 herë më të lartë se mesatarja prej 1030 në 2012). Gjithsesi, të ardhurat e veta për frymë në bashkinë Elbasan janë shumë më të ulëta se ato në Bradashesh (6,3 dhe 6,8 herë më lart se mesatarja e qarkut), Librazhdi (5,8 dhe 3,7 herë më të larta në 2011 dhe 2012); por më afër me Përrenjasin. Burimi kryesor i të ardhurave të veta në Bradashesh është taksat e pasurisë, ndërsa në Librazhd, ashtu si dhe në Elbasan, taksat e biznesit të vogël.

Grafiku i figurës 36 tregon të ardhurat për frymë nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar, si dhe raportin shpenzimet për paga e sigurime/banor në vitin 2011. Siç shihet, në përgjithësi njësitë me popullsi më të madhe gjenerojnë të ardhura të veta më të

larta për banor; ndërkohë që transferta e pakushtëzuar ndjek drejtimin e kundërt. Ndërkohë, sjellja e treguesit të shpenzimeve për personelin (për banor gjithashtu) përgjithësisht ka lidhje inverse me të ardhurat e veta për frymë dhe popullsinë totale.



Po të shikojmë klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të njësive për qarkun Elbasan vërehet se ndonëse shpenzimet totale për frymë pësojnë ulje nga viti 2009 deri në vitin 2012, mesatarja e shpenzimeve për personelin rritet. Ndërkohë, mesatarja e investimeve kapitale pëson luhatje gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, duhet përmendur se ecuria e investimeve kapitale duhet vrojtuar përgjatë një periudhe relativisht të gjatë, ndaj treguesit vjetorë janë më pak domethënës në këtë rast. Siç shikohet në tabelën 32, disa prej njësive që kanë shpenzime administrative shumë të larta në 2012-ën nuk kanë kryer asnjë investim. Gjithashtu, investimet për frymë tentojnë të jenë më të larta në zonat me popullsi më të vogël se në ato me popullsi më të madhe. Duke vrojtuar strukturën e buxheteve vendore mund të arrihet në përfundimin se shumica e investimeve në njësitë më të vogla financohen me anë të granteve të kushtëzuara dhe ose konkurruese.

Tabela 22. Shpenzimet për frymë 2010 – 2012

Qar ku	Rrethi	Njësia	2010			2011			2012		
			Shpenz. /frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë	Shpenz. /frymë	Personel/ frymë	inv/ capita	Shpenz. /frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë
EL	Elbasan	Belsh	3967	1514	802	2998	1243	512	3368	1505	932
EL	Elbasan	Bradashes	13 397	2109	8668	17 863	2012	13 679	9068	2488	4413
EL	Elbasan	Cërrik	4877	2465	854	3195	2175	68	4383	2900	405
EL	Elbasan	Elbasan	5889	2297	1397	5311	2196	880	5548	2298	653
EL	Elbasan	Fierzë	2580	1290	231	1605	1338	268	1605	535	802
EL	Elbasan	Funarë	18 581	1408	15 809	7013	1594	4782	1931	322	1287
EL	Elbasan	Gjergjan	2009	1087	57	2921	1062	1328	1710	1184	0
EL	Elbasan	Gjinar	4908	2199	403	3536	1872	208	3666	2037	407
EL	Elbasan	Gostime	5154	1104	2857	3172	976	1382	2578	1128	1047
EL	Elbasan	Gracen	6023	2499	2086	5553	2380	2380	9095	3163	3559
EL	Elbasan	Grekan	4267	1428	1302	3191	1197	997	6180	1794	2392
EL	Elbasan	Kajan	4205	1359	2044	4826	934	3270	5877	1547	3402
EL	Elbasan	Klos	3829	1681	1234	1683	1202	240	2142	1190	0
EL	Elbasan	Labinot									
EL	Elbasan	Fushë	3175	1256	812	2076	1277	479	1877	1408	0
EL	Elbasan	Labinot									
EL	Elbasan	Mal	17 933	1751	14 078	6211	1461	3106	6735	1772	3368
EL	Elbasan	Mollas	2910	1541	295	6386	1303	4561	2723	1167	1167
EL	Elbasan	Papër	4590	1607	2174	3035	1574	675	3120	1226	1560
EL	Elbasan	Rrasë	3154	1774	0	2180	1744	0	1709	1282	0
EL	Elbasan	Shalëz	5250	1106	2989	3367	1025	1903	1889	436	872
EL	Elbasan	Shirgjan	3049	1231	50	2247	1124	102	2721	1411	706
EL	Elbasan	Shushicë	3309	1205	1198	2087	1138	474	1879	564	846
EL	Elbasan	Tregan	4705	2165	1024	3503	2102	467	3636	1364	1591
EL	Elbasan	Zavalinë	7374	2509	1817	4286	2381	952	4044	3033	0
EL	Gramsh	Gramsh	10 265	2830	3443	6116	2794	76	7003	3577	457
EL	Gramsh	Kodovjat	5548	2268	1304	6165	2158	3391	5145	2119	2119
EL	Gramsh	Kukur	5165	1983	558	5268	2049	1756	6076	2315	1736
EL	Gramsh	Kushovë	8655	2826	1798	8475	1883	5650	11 385	6641	0
EL	Gramsh	Lenie	10 401	3553	1230	4762	3810	0	4673	3738	0
EL	Gramsh	Pishaj	6181	1475	2816	3330	1268	951	3416	1242	1087
EL	Gramsh	Poroçan	11 334	2911	5528	3874	2767	0	3794	3252	0
EL	Gramsh	Skënderb									
EL	Gramsh	egas	5275	2454	514	3492	2619	0	3521	2201	440
EL	Gramsh	Sult	12 228	2857	6886	4435	2217	0	2172	1448	0
EL	Gramsh	Tunjë	5228	1769	1563	6726	2242	2691	3607	2254	0
EL	Librazhd	Hotolish	4389	1482	1560	5053	1877	2455	4718	2145	2002
EL	Librazhd	Librazhd	7496	4228	791	6660	4611	102	6691	4146	1225
EL	Librazhd	Lunik	5176	1947	1583	3499	1615	1077	3264	1904	544
EL	Librazhd	Orenjë	4310	1875	563	3455	1727	768	4064	1742	1548
EL	Librazhd	Polis	2909	1557	378	2195	1397	399	3133	783	1762

EL	Librazhd	Prenjas	8086	3254	1860	7211	3192	1655	7128	3739	935
EL	Librazhd	Qendër	9647	1373	7384	5430	1335	3205	7120	979	5874
EL	Librazhd	Qukës	6529	1452	4071	3489	1509	1037	3372	1592	937
EL	Librazhd	Rrajcë	3648	1585	996	5831	1555	3693	3405	1848	973
EL	Librazhd	Steblevë	10 876	4961	2075	8347	5008	0	8219	5479	913
EL	Librazhd	Stravaj	5153	2406	546	4250	1961	654	6223	2620	1965
EL	Peqin	Gjocaj	2989	1722	721	3851	1426	1997	3830	1844	1277
EL	Peqin	Karinë	4347	3662	78	2779	2223	0	4452	2782	0
EL	Peqin	Pajovë	3486	2585	48	2796	1981	233	2647	1266	921
EL	Peqin	Peqin	8676	2724	4492	5355	2404	1311	7001	2516	984
EL	Peqin	Përparim	10 029	2160	7233	5208	930	3906	9994	2036	6293
EL	Peqin	Shezë	2562	1919	283	1904	1142	190	1890	756	756
		Minimum	2009	1087	0	1605	930	0	1605	322	0
		Maksimum	18 581	4961	15 809	17 863	5008	13 679	11 385	6641	6293
		Mesatare	6314	2088	2450	4564	1900	1598	4509	2054	1283
		Mesatarja	5160	1897	1303	3862	1736	916	3730	1819	933
		Koeficienti i variacionit	0,6	0,4	1,3	0,6	0,5	1,4	0,5	0,6	1,1


Figura 38. Shpenzimet për frymë operative dhe kapitale 2011 (pa bashkinë Elbasan)



Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Shpenzimet operative janë mjaft të larta në njësitë e qarkut Elbasan, ashtu si dhe në përgjithësi në nivel vendi. Në veçanti, shpenzimet për paga e sigurime zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale për çdo njësi, duke variuar nga 42% (Peqini) deri në 86% (Poroçan) në vitin 2012. Pësia relative e zërit të pagave në shpenzimet e përgjithshme operative është rritur ndjeshëm nga viti 2010 në 2011-ën dhe ka një rënie të lehtë sërish në 2012-ën, ndonëse ka njësi që kanë ndjekur trendin e kundërt.

Figura 39. Pësia relative e shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve operative për njësi 2010 - 2012




5.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Elbasan

Qeverisja vendore luan një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë seksion do të hedhim një vështrim mbi të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për qarkun e Elbasanit; të dhënat mbi forcën e punës dhe punësimin (për sa të dhënat janë të disponueshme), si dhe sipërmarrjen dhe zhvillimin e bizneseve, të cilat analizohen nga pikëpamja e përqendrimit në çdo qark dhe nga pikëpamja e të ardhurave që gjenerojnë në nivel kombëtar, si dhe për çdo njësi.

a. Prodhimi i brendshëm bruto.

Pësia specifike e rajonit të Elbasanit ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është 9,24%. PBB për frymë në qarkun e Elbasanit është 2861 Euro në vitin 2012 ose 13% më e ulët se ajo në nivel kombëtar.

Figura 40. Struktura e PBB-së sipas qarqeve 2011



Burimi: INSTAT

Tabela 23. PBB totale dhe PBB për frymë sipas qarqeve

Qarku	PBB, çmime korrente (mln lekë)	Pesha specifike	PBB për frymë në lekë	PBB për frymë Euro	PBB për frymë si % e kombëtares
Shqipëria	2 800 138	100%	457 926	3271	100,0%
Dibër	137 047	3,1%	291 528	2082	63,7%
Durrës	262 785	9,4%	458 656	3276	100,2%
Kukës	85 292	2,4%	367 221	2623	80,2%
Lezhë	134 027	3,6%	349 385	2496	76,3%
Shkodër	215 347	6,0%	361 626	2583	79,0%
Elbasan	295 827	9,2%	400 484	2861	87,5%
Tiranë	749 365	36,3%	621 460	4439	135,7%
Berat	141 944	4,8%	431 071	3079	94,1%
Fier	310 331	9,9%	405 412	2896	88,5%
Gjirokastrë	72 176	2,7%	473 537	3382	103,4%
Korçë	220 357	6,2%	364 077	2601	79,5%
Vlorë	175 640	6,3%	456 462	3260	99,7%


Figura 41. PBB për frymë si përqindje e PBB-së për frymë në nivel kombëtar



Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Elbasanit, vërejmë se sektori i tregtisë dhe shërbimeve (28%) së bashku me bujqësinë (26%) prodhojnë më shumë se gjysmën e vlerës së shtuar bruto në qark, të ndjekur nga sektori i industrisë (20%).

Figura 42. Struktura e PBB-së sipas sektorëve për qark



b. Sipërmarrja dhe bizneset.

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Elbasan janë të regjistruara 10 151 biznese, ndër të cilat 370, ose 36% janë biznese të mëdha. 7408 biznese (ose 73% e totalit) operojnë në rrethin e Elbasanit, ku operojnë edhe mbi 70% e bizneseve të mëdha.

Rreth 14% e bizneseve operojnë në rrethin e Librazhdit, ndërsa pjesa tjetër janë shpërndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në Peqin dhe Gramsh.

Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) janë mesatarisht 179 dhe 165 lekë për frymë në vitin 2012 dhe 2011. Këto vlera janë ndjeshëm më të ulëta se mesatarja kombëtare prej 532 dhe 621 lekësh për frymë përkatësisht në 2012 dhe 2011. Pabarazia brenda qarkut në realizimin e të ardhurave prej kësaj takse është mjaft e madhe, siç tregon edhe koeficienti i variacionit që merr vlera mbi 1 për të gjitha vitet. Disa njësi si Librazhdi, Përrenjasi dhe Elbasani kanë realizime mjaft të larta, por këto kanë pësuar ulje vitet e fundit.

Të ardhurat nga taksat e biznesit për banor (ish-taksa e biznesit të vogël, ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 24. Të ardhurat për frymë nga taksa e biznesit të vogël

			2008	2009	2010	2011	2012
Elbasan	Elbasan	Belsh	355	281	303	126	426
Elbasan	Elbasan	Bradashesh	225	192	177	66	293
Elbasan	Elbasan	Cërrik	342	345	308	306	376
Elbasan	Elbasan	Elbasan	646	624	694	593	564
Elbasan	Elbasan	Fierzë	113	75	0	10	4
Elbasan	Elbasan	Funarë	53	70	80	90	96
Elbasan	Elbasan	Gjergjan	51	47	30	52	108
Elbasan	Elbasan	Gjinar	50	32	33	28	92
Elbasan	Elbasan	Gostime	163	160	122	250	129
Elbasan	Elbasan	Gracen	59	16	27	0	0
Elbasan	Elbasan	Grekan	48	311	24	0	58
Elbasan	Elbasan	Kajan	14	37	23	119	10
Elbasan	Elbasan	Klos	14	14	0	0	0
Elbasan	Elbasan	Labinot Fushë	210	140	188	76	391
Elbasan	Elbasan	Labinot Mal	56	49	42	46	33
Elbasan	Elbasan	Mollas	44	51	49	69	169
Elbasan	Elbasan	Papër	64	66	116	123	117
Elbasan	Elbasan	Rrasë	-	0	0	0	0
Elbasan	Elbasan	Shalëz	122	151	156	226	101
Elbasan	Elbasan	Shirgjan	250	231	219	221	271
Elbasan	Elbasan	Shushicë	54	59	63	27	90
Elbasan	Elbasan	Tregan	125	150	182	39	280
Elbasan	Elbasan	Zavalinë	16	8	6	1	17
Elbasan	Gramsh	Gramsh	578	614	773	723	1066
Elbasan	Gramsh	Kodovjat	29	58	22	30	38
Elbasan	Gramsh	Kukur	40	53	30	18	11
Elbasan	Gramsh	Kushovë	39	43	37	19	0
Elbasan	Gramsh	Lenie	72	27	33	0	0
Elbasan	Gramsh	Pishaj	54	62	51	19	23
Elbasan	Gramsh	Poroçan	4	0	0	0	0
Elbasan	Gramsh	Skënderbegas	54	30	14	8	13

Elbasan	Gramsh	Sult	24	17	3	0	0
Elbasan	Gramsh	Tunjë	34	54	29	0	0
Elbasan	Librazhd	Hotolisht	75	0	78	97	50
Elbasan	Librazhd	Librazhd	1390	1275	1246	1336	1352
Elbasan	Librazhd	Lunik	37	30	24	10	6
Elbasan	Librazhd	Orenjë	37	19	10	9	0
Elbasan	Librazhd	Polis	95	0	169	111	240
Elbasan	Librazhd	Prrrenjas	877	863	2081	1559	1148
Elbasan	Librazhd	Qendër	132	140	114	103	56
Elbasan	Librazhd	Qukës	78	98	68	92	81
Elbasan	Librazhd	Rrajcë	75	82	89	93	95
Elbasan	Librazhd	Steblevë	28	9	10	17	21
Elbasan	Librazhd	Stravaj	38	31	65	7	68
Elbasan	Peqin	Gjocaj	54	32	46	139	28
Elbasan	Peqin	Karinë	98	64	194	213	121
Elbasan	Peqin	Pajovë	480	302	277	644	188
Elbasan	Peqin	Peqin	351	318	548	538	605
Elbasan	Peqin	Përparim	21	0	0	0	30
Elbasan	Peqin	Shezë	47	44	43	16	71
		Mesatare	158	148	178	165	179
		Min.	0	0	0	0	0
		Maks.	1390	1275	2081	1559	1352
		Mesatarja	55	56	50	49	70
		Koeficienti					
		i variacionit	1,6	1,6	2,0	1,9	1,7

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

c. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (toka bujqësore dhe ndërtesat).

Tabela 25. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Elbasan, krahasuar me mesataren kombëtare për banor

			2008	2009	2010	2011	2012
Elbasan	Elbasan	Belsh	0,53	0,63	0,61	0,68	0,64
Elbasan	Elbasan	Bradashesh	7,02	6,46	0,37	6,62	5,09
Elbasan	Elbasan	Cërrik	0,66	0,99	0,71	0,51	0,44
Elbasan	Elbasan	Elbasan	0,71	0,67	0,66	0,57	0,57
Elbasan	Elbasan	Fierzë	0,85	0,42	0,40	1,24	0,62
Elbasan	Elbasan	Funarë	0,38	0,36	0,38	0,24	0,14
Elbasan	Elbasan	Gjergjan	0,94	1,07	1,15	1,09	1,07
Elbasan	Elbasan	Gjinar	0,39	0,35	0,67	0,29	0,45
Elbasan	Elbasan	Gostime	1,11	1,03	1,29	1,13	0,84
Elbasan	Elbasan	Gracen	0,47	0,21	0,30	0,24	0,10
Elbasan	Elbasan	Grekan	1,07	0,10	0,86	0,07	0,18
Elbasan	Elbasan	Kajan	0,95	0,57	0,58	0,33	0,44
Elbasan	Elbasan	Klos	0,34	0,25	0,26	0,16	0,26
Elbasan	Elbasan	Labinot Fushë	0,72	0,83	0,08	1,27	1,15
Elbasan	Elbasan	Labinot Mal	0,66	0,71	0,35	0,56	0,34

Elbasan	Elbasan	Mollas	0,79	1,10	0,64	0,85	1,15
Elbasan	Elbasan	Papër	1,80	1,39	1,58	1,59	1,20
Elbasan	Elbasan	Rrasë	0,94	0,30	0,05	0,34	0,30
Elbasan	Elbasan	Shalëz	0,73	0,61	0,97	0,95	0,57
Elbasan	Elbasan	Shirgjan	1,12	1,26	1,05	0,90	0,72
Elbasan	Elbasan	Shushicë	0,60	0,56	0,65	0,58	0,35
Elbasan	Elbasan	Tregan	1,79	1,44	1,70	1,40	0,83
Elbasan	Elbasan	Zavalinë	0,80	1,22	1,05	0,63	0,50
Elbasan	Gramsh	Gramsh	0,44	0,49	0,56	0,49	0,41
Elbasan	Gramsh	Kodovjat	0,25	0,31	0,33	0,49	0,39
Elbasan	Gramsh	Kukur	0,19	0,15	0,09	0,06	0,15
Elbasan	Gramsh	Kushovë	0,47	0,20	0,34	0,26	0,19
Elbasan	Gramsh	Lenie	0,51	0,47	0,56	0,34	0,65
Elbasan	Gramsh	Pishaj	0,71	0,31	0,67	0,56	0,47
Elbasan	Gramsh	Poroçan	0,16	0,18	0,21	0,03	0,11
Elbasan	Gramsh	Skënderbegas	0,15	0,24	0,12	0,03	0,10
Elbasan	Gramsh	Sult	0,22	0,17	0,02	0,17	0,09
Elbasan	Gramsh	Tunjë	0,30	0,31	0,11	0,24	0,19
Elbasan	Librazhd	Hotolisht	0,33	-	0,31	0,14	0,13
Elbasan	Librazhd	Librazhd	0,80	0,91	0,45	0,67	0,56
Elbasan	Librazhd	Lunik	0,11	0,09	0,13	0,01	0,19
Elbasan	Librazhd	Orenjë	0,20	0,09	0,04	0,10	0,09
Elbasan	Librazhd	Polis	0,25	-	0,27	0,24	0,19
Elbasan	Librazhd	Prrenjas	0,74	0,87	0,14	0,21	0,08
Elbasan	Librazhd	Qendër	0,49	0,27	0,18	0,17	0,09
Elbasan	Librazhd	Qukës	0,18	0,17	0,18	0,11	0,19
Elbasan	Librazhd	Rrajcë	0,34	0,31	0,27	0,31	0,32
Elbasan	Librazhd	Steblevë	0,23	0,53	0,52	0,29	0,19
Elbasan	Librazhd	Stravaj	0,07	0,02	0,02	0,02	0,07
Elbasan	Peqin	Gjocaj	0,92	0,69	0,75	0,73	0,55
Elbasan	Peqin	Karinë	1,29	0,88	0,06	1,30	0,58
Elbasan	Peqin	Pajovë	1,30	1,14	0,54	0,93	0,16
Elbasan	Peqin	Peqin	0,64	0,48	0,61	0,61	0,53
Elbasan	Peqin	Përparim	0,55	0,32	0,18	0,18	0,37
Elbasan	Peqin	Shezë	0,97	0,88	0,76	0,40	0,54
		Mesatare	0,8	0,7	0,5	0,6	0,5
		Min.	0,1	0,0	0,0	0,0	0,1
		Maks.	7,0	6,5	1,7	6,6	5,1
		Mesatarja Koeficienti i variacionit	0,6	0,5	0,4	0,4	0,4
			1,7	1,4	0,8	1,5	1,4

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Performanca e NJQV-ve të Elbasanit në lidhje me taksat e pasurisë nuk është shumë e mirë. Në veçanti, realizimin më të mirë të të ardhurave nga taksa e pasurisë për frymë i kanë disa njësi, të cilat nuk kanë burime apo performancë veçanërisht të mirë nga burimet e tjera. Vërehet se qytetet që kanë performancë më të mirë në mbledhjen e të ardhurave të veta

kanë performancë të ulët në mbledhjen e taksave të pasurisë, ndonëse nivelet treguese të kësaj takse janë më të larta në qytetet qendër rrethi; ndërkohë që disa komuna, si Bradasheshi, kanë realizime mbresëlënëse disa herë më të larta se mesatarja kombëtare.

5.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Elbasanit ka shënuar një rënie të popullsisë në krahasim me 2001 (-19%). Rënie kanë pësuar zonat urbane (-10%), por më shumë ato rurale (-23%). Dendësia gjithashtu ka ardhur duke rënë (-19%).
- Qarku i Elbasanit numëron rreth 73 mijë familje – diçka më pak se 10% në shkallë kombëtare.
- 5,6% e popullsisë janë persona me aftësi të kufizuara.
- Popullsia në moshë pune 15 - 64 vjeç është 203 250 ose rreth 69%, ndërsa mosha e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 10%.
- Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun Elbasan janë 16 240 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 716 përfitojnë pagesë papunësie.
- 12 085 persona rezultojnë të jenë kthyer nga migracioni prej vitit 2001 deri më 2011, ku 73,7% e të gjithë të kthyerve janë meshkuj.

Strehimi

- 73 044 familje, 68 044 në pronësi ose në proces pronësimi, 2368 me qira, 2632 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Elbasanit ka mesatarisht 2,91 dhoma.
- 1836 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 7752 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 71 285 banesa të banuara) ose rreth 13,4% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 5487 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 71 285 banesa të banuara) ose 7,7%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Elbasanit shënon një nivel varfërie prej 10,7%. Thellësia e varfërisë është 2,3% dhe ashpërsia 0,8%. Këta tregues janë më të ulët se niveli kombëtar i varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Nga ana tjetër, 12 849 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Elbasanit ose rreth 13,1% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 17% të totalit të familjeve.
- Koeficienti GINI për qarkun e Elbasanit është 24,8%.
- Konsumi total për familje në këtë qark është 45 890 lekë krahasuar me konsumin për person që është 10 747 lekë.

Shëndetësia

- 16 568 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 7,6%.
- 6 spitale me 1020 shtretër, si dhe 170 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Elbasanit kemi një numër total mjekësh prej 311.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më i afërt në zonat urbane është 13 minuta, ndërsa në zonat rurale 22 minuta.
- Sipas ndarjes të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 19 minuta për jo të varfrit dhe 18 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 8953 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 3,65%.

Shërbimet

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	0
Shërbime sociale për fëmijët	1 ³	7
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	2
Shërbime sociale për PAK	0	0
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	0
Gjithsej	1	10

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

³ Shërbim i ofruar nga qarku


6 Qarku Fier

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Fierit. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

6.1 Profili i qarkut Fier dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Fierit përbëhet prej 3 rretheve: Fier, Lushnjë dhe Mallakastër, si dhe 42 NJQV të organizuara - 17 në rrethin e Fierit; 16 në rrethin e Lushnjës dhe 9 në rrethin e Mallakastrës. Qarku i Fierit ka një popullsi prej 310 331 banorësh (në rrethin e Fierit 165 356 banorë; në rrethin e Lushnjës 117 913 banorë dhe në rrethin e Mallakastrës 27 062 banorë) (INSTAT, Census 2011).

Figura 9. NJQV-të në qarkun e Fierit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Këto shifra paraqiten konsiderueshëm më të ulura (rreth 36% më pak) referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në janar 2012 popullsia e qarkut të Fierit rezulton

488 558 banorë (në rrethin e Fierit 266 733 banorë; në rrethin e Lushnjës 178 759 banorë dhe në rrethin e Mallakastrës 43 066 banorë).

Tabela 4. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Fier

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011	RGJC 2011	DIFERENCA
Fier	Cakran	11 722	16 507	-4785
Fier	Dermentas	7788	12 424	-4636
Fier	Fier	55 845	84 632	-28 787
Fier	Frakull	6820	10 466	-3646
Fier	Kuman	5611	8308	-2697
Fier	Kurjan	3618	5346	-1728
Fier	Levan	8159	17 368	-9209
Fier	Libofshë	6149	10 316	-4167
Fier	Mbrostar	7460	10 391	-2931
Fier	Patos	15 397	30 990	-15 593
Fier	Portëz	8259	11 229	-2970
Fier	Qendër	4207	12 107	-7900
Fier	Roskovec	4975	8468	-3493
Fier	Ruzhdie	2326	3298	-972
Fier	Strum	7538	9061	-1523
Fier	Topojë	4246	7567	-3321
Fier	Zharrëz	5236	8255	-3019
Total rrethi Fier		165 356	266 733	-101 377
Lushnjë	Allkaj	4319	6138	-1819
Lushnjë	Ballagat	2461	3594	-1133
Lushnjë	Bubullimë	5548	7111	-1563
Lushnjë	Divjakë	8445	13 644	-5199
Lushnjë	Dushk	7872	11 291	-3419
Lushnjë	Fiershegan	7023	9316	-2293
Lushnjë	Golem	5243	7626	-2383
Lushnjë	Grabian	3638	6371	-2733
Lushnjë	Gradisht	7521	10 664	-3143
Lushnjë	Hyzgjokaj	2603	3548	-945
Lushnjë	Karbunarë	4193	5517	-1324
Lushnjë	Kolonjë	5728	8394	-2666
Lushnjë	Krutje	7564	10 213	-2649
Lushnjë	Lushnjë	31 105	53 522	-22 417
Lushnjë	Rremas	4449	6547	-2098
Lushnjë	Tërbuf	10 201	15 263	-5062
Total rrethi Lushnjë		117 913	178 759	-60 846
Mallakastër	Aranitas	2714	5233	-2519
Mallakastër	Ballsh	7657	11 902	-4245
Mallakastër	Fratar	3221	6776	-3555
Mallakastër	Greshice	1152	2061	-909
Mallakastër	Hekal	2623	4833	-2210
Mallakastër	Kute	1977	3393	-1416
Mallakastër	Ngraçan	588	-	588
Mallakastër	Qendër	6253	8868	-2615
Mallakastër	Selitë	877	-	877
Total rrethi Mallakastër		27 062	43 066	-16 004
Total qarku Fier		310 331	488 558	-178 227

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet tona

Popullsia e qarkut Fier përbën rreth 11,08% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 7389 banorë/NJQV. Kjo mesatare është afër (rreth 7% më e ulët) mesatares së popullsisë

për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV). Rreth 43% e NJQV-ve kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë (kryesisht njësite e rrethit të Mallakastrës) dhe 12% e NJQV-ve kanë popullsi më të lartë se 10 000 banorë.

Tabela 5. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Fier sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


Klasifikimi i NJQV-ve sipas numrit të popullsisë	Fier	Shqipëria
Popullsia	11,08%	100,00%
Popullsia Mesatare për NJQV	7389	8016
< 2000	9,52%	27,61%
2000-5000	33,33%	34,58%
5000-10 000	45,24%	26,27%
10 000-20 000	7,14%	6,70%
20 000-30 000	0,00%	1,61%
30 000-50 000	2,38%	1,07%
50 000-100 000	2,38%	1,61%
100 000-200 000	0,00%	0,27%
> 200 000	0,00%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Dendësia mesatare e popullsisë është 320,28 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Dendësia reflekton kryesisht përqendrimin e popullsisë në njësi vendore me sipërfaqe jo shumë të madhe dhe kjo lidhet kryesisht me morfologjinë e territorit në të cilin shtrihet qarku i Fierit. Fieri (4212 banorë/km²) dhe Ballshi (3085 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa komunat Selitë (25,47 banorë /km²) dhe Kute (35,14 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët. Me dendësi të ulët janë edhe njësitë Hekal, Aranitas, Topojë, etj.

Njësitë vendore të qarkut Fier përbëjnë rreth 8,4% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,21% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve krahasuar me totalin e shpenzimeve vendore vihet re në vitin 2012, rreth 9,4% e buxhetit, vendor krahasuar me 8,0% në vitin 2010, kjo ndonëse në vlerë nominale viti 2010 shënon nivelet më të ulëta të shpenzimeve krahasuar me 2008 - 2012. Tendanca e shpenzimeve të NJQV-ve të qarkut Fier, si pjesë e totalit të shpenzimeve vendore është disi e ndryshme prej pjesës më të madhe të qarqeve, në të cilat vihet re niveli më i lartë i shpenzimeve gjatë vitit 2009 dhe rënie e ndjeshme e tyre gjatë viteve 2010 – 2012. Në qarkun Fier, në vitin 2009 NJQV-të shpenzojnë më tepër krahasuar me vitet e tjera 2008 – 2012, por në raport me totalin e shpenzimeve vendore, niveli më i lartë raportohet në vitin 2012.

Figura 10. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Fier krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet autorëve

Pjesa më e madhe e shpenzimeve në të gjitha NJQV-të e qarkut Fier shkon për shpenzime operative – mesatarisht gjatë viteve 2008 – 2012 rreth 72%, nga të cilat pagat dhe sigurimet përbënin 40,1% ose mesatarisht 10,28% të totalit të shpenzimeve vendore në Shqipëri.

Shpenzimet kapitale kanë pësuar rënie të ndjeshme në raport me shpenzimet operative pas vitit 2009 dhe kanë arritur nivelin më të ulët prej vetëm 23% të totalit të shpenzimeve në nivel qarku në vitin 2012.

Ndërkohë, shpenzimet për paga dhe sigurime arrijnë nivelin më të lartë si në përqindje ashtu edhe në vlerë nominale në vitin 2011 – 44,3% e shpenzimeve vendore. Pjesa që zënë pagat dhe sigurimet në totalin e shpenzimeve të NJQV-ve të qarkut Fier është ndër më të lartat krahasuar me qarqet e tjerë.


Figura 11. Shpenzimet Kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Fier



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Fier përbëjnë rreth 13,7% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Ato ndjekin një tendencë rritëse deri në vitin 2011 dhe bien ndjeshëm në vitin 2012.


Figura 12. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Fier kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Fier përbëhen në më pak se një të tretën e tyre (thujse 29,13%) prej të ardhurave të veta të NJQV-ve. Të ardhurat nga grantet e pakushtëzuara përbëjnë rreth 25,4% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Fier, ndërsa të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara kanë zënë nga 39% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 50% të këtij totali në vitin 2010. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2011 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin.

Figura 13. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Fierit




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

6.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Fier

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Fier, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- a. Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.


Tabela 6. Raporti mes buxheteve të NJQV-ve me mesataren e buxheteve të NJQV-ve të qarkut Fier



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.


Tabela 7. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor (në qarkun Fier) krahasuar me të mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 8. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor (në qarkun Fier) krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banorë të NJQV-ve




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Referuar të tre treguesve të zhvilluar në grafikët më sipër evidentojmë një numër të konsiderueshëm prej NJQV-ve të qarkut Fier, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banor. Të tilla janë komunat Cakran, Dermenas, Hysgjokaj, Ruzhdie, Strumë etj.

6.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Fier

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë NJQV-të e qarkut Fier.

Figura 14. Të ardhurat dhe shpenzimet për banor në NJQV-të e qarkut Fier (2008 – 2011)



Të ardhurat totale/banorë


Shpenzimet totale / banorë

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Mesatarja e të ardhurave për banor në NJQV-të e Qarkut Fier është rreth 59,31 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. E ardhura më e lartë për banor rezulton në Selitë (Kapaj) dhe Qendër Fier (respektivisht 120,5 dhe 117,75 Euro/banor), ndërsa më e ulëta në Fier Shegan, Tërbuf, Dushk (rreth 37 Euro/banor).

Thuajse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banor.

Figura 15. Shpenzimet totale për banor krahasuar me të ardhurat e veta të NJQV-së për banor në qarkun e Fierit



Shpenzimet totale/banorë


Të ardhurat e veta të NJQV-së/banorë

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Referuar hartës për të ardhurat e veta të NJQV-se/banor, vazhdon të ruhet dhe në njësitë e këtij qarku një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 12,30 Euro/banor (Hysgjokaj) në 85,95 Euro/banor (Selitë/Kapaj), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga 3,29 Euro/banor (Selitë/Kapaj) në 95,71EUR/banor (Kuman).

Le të shikojmë se çfarë ndodh në lidhje me investimet kapitale në NJQV-të e qarkut Fier, duke përdorur si bazë krahasimore investimet kapitale për frymë në NJQV-të ndryshme.

Figura 16. Investimet kapitale krahasuar me shpenzimet totale të NJQV-ve dhe grantet e kushtëzuara për banor në NJQV-të e qarkut Fier



Investimet kapitale/Totalin e shpenzimeve


Grantet e kushtëzuara/banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësive të qeverisjes vendore (Ballagat, Karbunarë, Mbrostar, Qendër Mallakastër, Greshicë, Cakran etj). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, NJQV-të në qarkun e Fierit shpenzuan mesatarisht 10,34 Euro/banor për investime kapitale, ndërkohë që mesatarja në rang vendi është 14,3 Euro/banor. 9 NJQV shpenzuan gjatë këtij viti më tepër se mesatarja në nivel vendi për banor për investime kapitale (Kuman, Divjakë, Ballagat, Bubullinjë, Kolonjë, Remas, Fratar, Selitë/Kapaj). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme lexohet qartë që në një pjesë të NJQV-ve investimet kapitale janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara (Ballagat, Remas, Fratar e Selitë/Kapaj).

Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banor në NJQV-të e Fierit është rreth 29,51 Euro/banor në vitin 2011, fare pranë mesatares kombëtare prej rreth 30 Euro/banor. Duke iu referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për banor e kanë Komunitat Dushk, Allkaj, Fier Shegan (rreth 16 Euro/banor) dhe nivelin më të lartë Komunitat Selitë/Kapaj e Ngracan (rreth 70-80 Euro/banor).

Figura 17. Shpenzimet operative dhe shpenzimet për paga e sigurime të NJQV-ve të qarkut Fier



Shpenzimet operative / Shpenzimet totale

Shpenzimet për paga e sigurime / shpenzimet operative

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Fier zënë mesatarisht 75% të totalit të shpenzimeve, diçka më lartë krahasuar me mesataren në nivel vendi prej 66%. Ndërkohë që për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në mbi 90% të buxhetit vendor (Frakull, Cakran, Hysgjokaj, Fier Shegan, Karbunarë, Aranitas, Kute, Ngracan e Greshicë). Kjo lidhet me faktin se këto njësi jo vetëm që nuk kanë pasur mundësi për të kryer investime kapitale me të ardhurat e tyre, por nuk kanë pasur akses as në grantet konkurruese (FZHR) apo nuk kanë përfituar grante të tjera të kushtëzuara. Në rastin e bashkisë Fier po ashtu shpenzimet operative raportohen shumë të larta (mbi 90%). Kjo vjen kryesisht nga fakti se këtu raportohen edhe shpenzimet e pastrimit të qytetit nëpërmjet ndërmarrjes, por edhe si rezultat i pamundësisë për investime kapitale gjatë viteve të fundit.


Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Fier mesatarisht 59%, raport pak më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011 (56%). Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh., në Greshicë, Selitë/Kapaj, Hekal, Divjakë, Strumë, Portëz etj.).

6.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Fier

Disa prej treguesve që mund të konsiderojmë për të vlerësuar klimën dhe mundësinë për zhvillim ekonomik që ofron një NJQV, janë listuar më poshtë dhe do të shtjellohen më tej në dokument.

- a. Të ardhurat nga taksat e biznesit për banor (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 9. Taksa e biznesit të vogël (TBV) për banor sipas NJQV-ve të qarkut Fier krahasuar me mesataren për banor në nivel kombëtar




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Referuar këtij treguesi janë fare pak NJQV në qarkun Fier që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banor prej biznesit. Ato janë Fieri dhe Lushnja.

Le të shikojmë edhe treguesit e tjerë për të vlerësuar se cilat prej NJQV-ve të qarkut të Fierit mundësojnë kushte për zhvillimin ekonomik e cilat jo.

- b. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (tokë dhe ndërtesë), nga taksa e automjeteve etj.

Tabela 10. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Fier, krahasuar me mesataren kombëtare për banor




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Në lidhje me taksën e pasurisë janë një numër i konsiderueshëm NJQV-sh në qarkun Fier, të cilat rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar

(rreth 40% e NJQV-ve). Komuna Kuman duket se ka një performancë më të mirë në grumbullimin e të ardhurave prej taksës së pasurisë krahasuar me NJQV-të e qarkut Fier.


- c. Numri i bizneseve sipas njësive të qeverisjes vendore; numri i bizneseve për banor.

Figura 18. Numri i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve sipas NJQV-ve në qarkun Fier



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet tona

Figura 19. Numri i bizneseve për 1000 banorë në NJQV-të e qarkut Fier



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet tona

Duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në qark dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t'ju ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitete më të theksuar janë Fieri, Lushnja, Divjaka, Roskoveci etj.

6.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Fierit ka 42 njësi administrative. Popullsia është 304 719 banorë – i dyti në Shqipëri.
- Qarku i Fierit ka shënuar një rënie të popullsisë në krahasim me 2001 (-20%). Rënie të lehtë kanë pësuar zonat urbane (-1,5%), por më shumë ato rurale (-29%). Dendësia gjithashtu ka ardhur duke rënë (-20%).
- Qarku i Fierit numëron rreth 82 mijë familje – diçka më shumë se 11% në shkallë kombëtare.
- Popullsia rinore (15 - 29 vjeç) është rreth 71 000 persona ose rreth 23,3% e popullsisë. Popullsia në moshë pune 15 - 64 është 211 016 persona ose rreth 69%, ndërsa mosha e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 12,2% – diçka më lart se tendenca e rajoneve të tjera.
- 5,2% e popullsisë (16 283 banorë), janë persona me aftësi të kufizuara.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun e Fierit sipas gjinisë është pothuaj e njëjtë (50,7% meshkuj dhe 49,3% femra).
- Popullsia në moshë pune përbën 68% të totalit të popullsisë (ose 211 016 persona). Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun Fier janë 16 364 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 657 përfitojnë pagesë papunësie.
- Popullsia emigruese e kthyer është 16 515 persona, ku 74,8% të të gjithë të kthyerve e zënë meshkujt.

Strehimi

- 82 074 familje, 76 063 në pronësi ose në proces pronësimi, 2570 me qira, 3441 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Fierit ka mesatarisht 2,85 dhoma.
- 1830 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 10 605 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 81 177 banesa të banuara) ose rreth 15,32% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 6218 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër nga 81 177 banesa të banuara) ose 7,65%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Fierit shënon një nivel varfërie prej 17,5%. Thellësia e varfërisë është 3,5% dhe ashpërsia 1,1%. Këta tregues janë më të lartë se niveli kombëtar i varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Nga ana tjetër 3974 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Fierit ose rreth 4% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 4,8% të totalit të familjeve. Koeficienti GINI për qarkun e Fierit është 25,4%.
- Konsumi total për familje në këtë qark është 41 372 lekë krahasuar me konsumin për person që është 10 288 lekë.

Shëndetësia

- 16 283 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 7%.
- 3 spitale me 668 shtretër, si dhe 184 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Fierit kemi një numër total mjekësh prej 332.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 19 minuta, ndërsa në zonat rurale 21 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 19 minuta për jo të varfrit dhe 22 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 8217 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç e barabartë me 3,18%.

Shërbimet

Fier	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	1
Shërbime sociale për fëmijët	0	9
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	3
Shërbime sociale për PAK	0	3
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	1
Gjithsej	1	18

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

6.6 Përfundime

Popullsia e qarkut Fier përbën rreth 11,08% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 7389 banorë/NJQV. Kjo mesatare është afër (rreth 7% më e ulët) mesatares së popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV). Rreth 43% e NJQV-ve kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë (kryesisht njësitë e Rrethit të Mallakastrës) dhe 12% e NJQV-ve kanë popullsi më të lartë se 10 000 banorë.

Dendësia mesatare e popullsisë është 320,28 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Dendësia reflekton kryesisht përqendrimin e popullsisë në njësi vendore me sipërfaqe jo shumë të madhe dhe kjo lidhet kryesisht me morfologjinë e territorit në të cilin shtrihet qarku i Fierit. Fieri (4212 banorë/km²) dhe Ballshi (3085 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa komunat Selitë (25,47 banorë/km²) dhe Kute (35,14 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët. Me dendësi të ulët janë edhe njësitë Hekal, Aranitas, Topojë etj.

Njësitë vendore të qarkut Fier përbëjnë rreth 8,4% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,21% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve krahasuar me totalin e shpenzimeve vendore vihet re në vitin 2012 – rreth 9,4% e buxhetit vendor krahasuar me 8,0% në vitin 2010, kjo ndonëse në vlerë nominale viti 2010 shënon nga nivelet më të ulëta të shpenzimeve krahasuar me 2008 - 2012. Tendenca e shpenzimeve të NJQV-ve të qarkut Fier, si pjesë e totalit të shpenzimeve vendore është disi e ndryshme prej pjesës më të madhe të qarqeve, në të cilat vihet re niveli më i lartë i shpenzimeve gjatë vitit 2009 dhe rënie e ndjeshme e tyre gjatë viteve 2010 – 2012. Në qarkun Fier, në vitin 2009 NJQV-të shpenzojnë më tepër krahasuar me vitet e tjera 2008 – 2012, por në raport me totalin e shpenzimeve vendore, niveli më i lartë raportohet në vitin 2012.

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Fier përbëjnë rreth 13,7% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Ato ndjekin një tendencë rritëse deri në vitin 2011 dhe bien ndjeshëm në vitin 2012. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Fier përbëhen në më pak se një të tretën e tyre (thujse 29,13%) prej të ardhurave të veta të NJQV-ve. Të ardhurat nga grantet e pakushtëzuara përbëjnë rreth 25,4% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Fier, ndërsa të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara kanë përbërë nga 39% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 50% të këtij totali në vitin 2010. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 – 2011 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin.

Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Fier: janë evidentuar një numër i konsiderueshëm prej NJQV-ve të qarkut Fier, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banor. Të tilla janë komunat Cakran, Dermenas, Hysgjokaj, Ruzhdie, Strumë etj.

Performanca financiare dhe fiskale: Vihet re se vazhdon të ruhet dhe në njësitë e këtij qarku ka një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 12,30 Euro/banor (Hysgjokaj) në 85,95 Euro/banor

(Selitë/Kapaj), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga 3,29 Euro/banor (Selitë/Kapaj) në 95,71 Euro/banor (Kuman).

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësive të qeverisjes vendore (Ballagat, Karbunarë, Mbrostar, Qendër Mallakastër, Greshicë, Cakran etj.). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, NJQV-të në qarkun e Fierit shpenzuan mesatarisht 10,34 Euro/banor për investime kapitale, ndërkohë që mesatarja në rang vendi është 14,3 Euro/banor. Nëntë NJQV shpenzuan gjatë këtij viti më tepër sesa mesatarja në nivel vendi për banor për investime kapitale (Kuman, Divjakë, Ballagat, Bubullinjë, Kolonjë, Remas, Fratar, Selitë/Kapaj). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme lexohet qartë që në një pjesë të NJQV-ve investimet kapitale janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara (Ballagat, Rremas, Fratar e Selitë/Kapaj).

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Fier zënë mesatarisht 75% të totalit të shpenzimeve, diçka më lart krahasuar me mesataren në nivel vendi prej 66%. Ndërkohë, për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në mbi 90% të buxhetit vendor (Frakull, Cakran, Hysgjokaj, Fier-Shegan, Karbunarë, Aranitas, Kute, Ngracan e Greshicë). Kjo lidhet me faktin se këto njësi jo vetëm që nuk kanë pasur mundësi për të kryer investime kapitale me të ardhurat e tyre, por nuk kanë pasur akses as në grantet konkurruese (FZHR) apo nuk kanë përfituar grante të tjera të kushtëzuara. Në rastin e bashkisë Fier, shpenzimet operative raportohen po ashtu shumë të larta (mbi 90%). Kjo vjen kryesisht nga fakti se këtu raportohen edhe shpenzimet e pastrimit të qytetit nëpërmjet ndërmarrjes, por edhe si rezultat i pamundësisë për investime kapitale gjatë viteve të fundit. Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Fier mesatarisht 59%, raport pak më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011 (56%). Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Greshicë, Selitë/Kapaj, Hekal, Divjakë, Strumë, Portëz etj.).

Konkurrueshmëria mes NJQV-ve dhe mundësia për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor: janë fare pak NJQV në qarkun Fier që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banor prej biznesit. Ato janë Fieri dhe Lushnja. Në lidhje me taksën e pasurisë janë një numër i konsiderueshëm NJQV-sh në qarkun Fier, të cilat rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar (rreth 40% e NJQV-ve). Komuna Kuman duket se ka një performancë më të mirë në grumbullimin e të ardhurave prej taksës së pasurisë krahasuar me NJQV-të e qarkut Fier. Duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në qark dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t'ju ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitet më të theksuar janë Fieri, Lushnja, Divjaka, Roskoveci etj.


7 Qarku Gjirokastrë

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Gjirokastrës. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

7.1 Profili i qarkut Gjirokastrë dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Gjirokastrës përbëhet prej 3 rretheve: Gjirokastrë, Përmet dhe Tepelenë, si dhe prej 32 NJQV-ve të organizuara – 13 në rrethin e Gjirokastrës, 9 në rrethin e Përmetit dhe 10 në rrethin e Tepelenës. Qarku i Gjirokastrës ka një popullsi prej 72 176 banorësh (në rrethin e Gjirokastrës 35 843 banorë; në rrethin e Përmetit 16 727 banorë dhe në rrethin e Tepelenës – 19 606 banorë) (INSTAT, Census 2011).

Figura 20. NJQV-të në qarkun e Gjirokastrës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritje e autorëve

Këto shifra paraqiten konsiderueshëm më të ulura (rreth 50% më pak) referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në janar 2012 popullsia e qarkut të Gjirokastrës rezultoi 154 483 banorë (në rrethin e Gjirokastrës 82 663 banorë; në rrethin e Përmetit 33 325 banorë dhe në rrethin e Tepelenës 38 495 banorë).

Tabela 11. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Gjirokastrë

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011	RGJC 2011	DIFERENCA
Gjirokastrë	Antigone	998		
Gjirokastrë	Cepo	1727	6692	
Gjirokastrë	Dropull i Poshtëm	2100	9547	
Gjirokastrë	Dropull i Sipërm	971	10 572	
Gjirokastrë	Gjirokastrë	19 836	33 361	
Gjirokastrë	Lazarat	2801	3406	
Gjirokastrë	Libohovë	1992	7219	
Gjirokastrë	Lunxhëri	1941	8744	
Gjirokastrë	Odrje	433		
Gjirokastrë	Picar	937		
Gjirokastrë	Pogon	432	3122	
Gjirokastrë	Qendër Libohovë	1264		
Gjirokastrë	Zagorie	411		
Total Gjirokastrë		35 843	82663	-46 820
Përmet	Ballaban	1047	2216	
Përmet	Çarçovë	918	3092	
Përmet	Dishnicë	1159	2703	
Përmet	Frashër	387		
Përmet	Këlcyrë	2651	5045	
Përmet	Përmet	5945	10 328	
Përmet	Petran	1622	3128	
Përmet	Qendër Piskovë	1742	4175	
Përmet	Sukë	1256	2638	
Total Përmet		16 727	33 325	-16 598
Tepelenë	Buz	737		
Tepelenë	Fshat Memaliaj	1606	2732	
Tepelenë	Krahës	2554	6695	
Tepelenë	Kurvelesh	705		
Tepelenë	Lopës	723		
Tepelenë	Luftinjë	1734	5521	
Tepelenë	Memaliaj	2647	7093	
Tepelenë	Qendër	3179	8324	
Tepelenë	Qesarat	1379		
Tepelenë	Tepelenë	4342	8130	
Total Tepelenë		19 606	38 495	-18 889
Total qarku Gjirokastrë		72 176	154 483	-82 307

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritje autorëve

Popullsia e qarkut Gjirokastrë përbën vetëm 2,58% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 2256 banorë/NJQV. Qarku Gjirokastrë është qarku me popullsinë më të vogël dhe njëkohësisht mesatarja e popullsisë për NJQV është më e ulura në vend – gati 4 herë më e ulët se mesatarja në rang vendi. Janë 72% e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë që kanë më pak se 2000 banorë dhe vetëm 2 njësi vendore që kanë mbi 5000 banorë (Gjirokastra 19 836 banorë dhe Përmeti 5945 banorë).

Tabela 12. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


Klasifikimi i NJQV-ve sipas numrit të popullsisë	Gjirokastrë	Shqipëria
Popullsia	2,58%	100,00%
Popullsia mesatare për NJQV	2256	8016
< 2000	71,88%	27,61%
2000-5000	21,88%	34,58%
5000-10 000	3,13%	26,27%
10 000-20 000	3,13%	6,70%
20 000-30 000	0,00%	1,61%
30 000-50 000	0,00%	1,07%
50 000-100 000	0,00%	1,61%
100 000-200 000	0,00%	0,27%
> 200 000	0,00%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 254 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Përmeti (3123 banorë/km²); Memaliaj (2003 banorë/km²); Tepelena (1791 banorë/km²) dhe Gjirokastra (667 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa Komunitat Pogon, Frashër e Zagorie (2 - 3 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët, ndërkohë që 9 NJQV kanë dendësi më të ulët se 10 banorë/km² (Dropull i Sipërm, Picar, Çarçovë, Buz, Kurvelesh, Lopës, etj.)

Njësitë vendore të qarkut Gjirokastrë shpenzojnë rreth 3,2% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,08% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve vihet re në vitin 2009 – rreth 4,3% e buxhetit vendor krahasuar me 2,9% në vitin 2012.

Figura 21. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona


Pjesa më e madhe e shpenzimeve në të gjitha NJQV-të e qarkut shkon për shpenzime operative – mesatarisht gjatë viteve 2008 - 2012 rreth 67,4%, nga të cilat pagat dhe

sigurimet përbëjnë 38% ose mesatarisht 3,63% të totalit të shpenzimeve vendore në Shqipëri.

Shpenzimet kapitale kanë pësuar një rritje dramatike në raport me shpenzimet operative gjatë vitit 2009, por bien sërish në mënyrë dramatike në vitet 2010 - 2012, për të arritur nivelin më të ulët prej vetëm 23,5% të totalit të shpenzimeve në nivel qarku në vitin 2012.

Ndërkohë, shpenzimet për paga dhe sigurime arrijnë nivelin më të lartë, si në përqindje, ashtu edhe në vlerë nominale në vitin 2012 – 45,5% e totalit të shpenzimeve vendore.


Figura 22. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë përbëjnë rreth 4,7% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Ato ndjekin të njëjtin trend të totalit të të ardhurave vendore, duke pësuar një rritje në vitin 2009 për të vazhduar pastaj me trendin rënës gjatë viteve 2010 - 2012.


Figura 23. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrër kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritje e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrër përbëhen në pjesën më të madhe (thujse 77%) prej të ardhurave prej granteve qeveritare me apo pa kusht. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore përbëjnë vetëm 23% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Gjirokastrër, ndërsa të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara kanë përbërë nga 10,7% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 25% të këtij totali në vitin 2012. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2012 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin, por në raport me qarqet e tjera duket se NJQV-të e qarkut Gjirokastrër përfitojnë më pak.

Figura 24. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Gjirokastrës




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

7.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- a. Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.


Figura 25. Raporti mes buxheteve të NJQV-ve me mesataren e buxheteve të NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.


Figura 26. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor (në qarkun Gjirokastrër) krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Figura 27. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor (në qarkun Gjirokastrër) krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banorë të NJQV-ve




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Duke iu referuar të tre treguesve të zhvilluar në tabelat e mësipërme evidentojmë se rreth 75% e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë na prezantohen në pozitë të vështirë financiare dhe të pabarabarta krahasuar me mesataren në nivel vendi. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banor. Njësitë që prezantohen në nivele të krahasueshme me NJQV-të në nivel vendi janë bashkitë Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Tepelenë, komuna Dropull i Poshtëm etj.

7.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë.

Figura 28. Të ardhurat dhe shpenzimet për banor në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë (2008 – 2011)



Të ardhurat totale/banorë


Shpenzimet totale / banorë

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Mesatarja e të ardhurave për banor në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë është rreth 62,26 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. E ardhura më e lartë për banor rezulton në Kurvelesh (rreth 109 Euro/banor), ndërsa më e ulëta në Dropullin e Sipërm (rreth 30 Euro/banor).

Thuajse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banor.

Figura 29. Shpenzimet totale për banor krahasuar me të ardhurat e veta të NJQV-së për banor në qarkun e Gjirokastrës



Shpenzimet totale/banorë


Të ardhurat e veta të NJQV-së/banorë

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Referuar hartës për të ardhurat e veta të NJQV-së/banor, vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruara nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 17,34 Euro/banor (Lunxhëri) në 108 Euro/banor (Kurvelesh), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga diçka më shumë se 1 Euro/banor (Frashër e Luftinjë) në 53,78 Euro/banor (Gjirokastrë).

Le të shikojmë se çfarë ndodh në lidhje me investimet kapitale në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë, duke përdorur si bazë krahasimi investimet kapitale për frymë në NJQV të ndryshme.

Figura 30. Investimet kapitale krahasuar me shpenzimet totale të NJQV-ve dhe grantet e kushtëzuara për banor në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë



Investimet kapitale/Totalin e Shpenzimeve


Grantet e kushtëzuara/banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, thuhet në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore (Memaliaj, Qesarat, Lopës, Buzë, Deshmnicë, Përmet, Petran, Dropull i Poshtëm, etj.). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, nëntë NJQV në qarkun e Gjirokastrës nuk shpenzuan asnjë lek për investime, ndërkohë që 12 NJQV shpenzuan për investime kapitale më tepër se mesatarja në rang vendi 14,3 Euro/banor (Luftinjë, Buzë, Kurvelesh, Memaliaj, Petran, Frashër, Deshnicë, Dropull i Sipërm, Antigone, Qendër Libohovë). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme është e qartë që investimet kapitale në këto NJQV janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara.

Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banor në NJQV-të e Gjirokastrës është rreth 26,18 Euro/banor në vitin 2011, krahasuar me mesataren kombëtare prej rreth 30 Euro/banor. Duke iu referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për banor e kanë komunat Dropull i Sipërm, Pogon, Odrie (diçka më pak se 10 Euro/banor) dhe nivelin më të lartë komunat Luftinjë, Buz e Kurvelesh (me mbi 40 Euro/banor).

Figura 31. Shpenzimet operative dhe shpenzimet për paga e sigurime të NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë



Shpenzimet operative / Shpenzimet totale

Shpenzimet për paga e sigurime / shpenzimet operative

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë zënë mesatarisht 73% të totalit të shpenzimeve, nivel ndjeshëm më i lartë krahasuar me mesataren në nivel vendi prej 66%. Ndërkohë që për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në 100% të buxhetit vendor (Odrje, Pogon, Zagorie, Krahëz, Qesarat, Lopës etj.).


Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë mesatarisht 63%, raport gati 8% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Krahëz, Qesarat, Picar, Lazarat, Antigone etj.).

7.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Gjirokastrë

Disa prej treguesve që mund të konsiderojmë për të vlerësuar klimën dhe mundësinë për zhvillim ekonomik që ofron një NJQV, janë listuar më poshtë dhe do të shtjellohen më tej në dokument.

- a. Të ardhurat nga taksat e biznesit për banorë (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Figura 32. Taksa e biznesit të vogël (TBV) për banor sipas NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë krahasuar me mesataren për banor në nivel kombëtar




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Referuar këtij treguesi janë fare pak NJQV në qarkun Gjirokastrë që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banor prej biznesit. Ato janë Gjirokastra, Përmeti, Tepelena e disi Këlcyra. Ndërkohë që 14 NJQV (44%) nuk gjenerojnë thujtë asgjë prej taksës së biznesit të vogël.

Le të shikojmë edhe treguesit e tjerë për të vlerësuar se cilat prej NJQV-ve të qarkut të Gjirokastrës mundësojnë kushte për zhvillimin ekonomik e cilat jo.

- b. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (tokë dhe ndërtesë), nga taksa e automjeteve, etj.

Figura 33. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë, krahasuar me mesataren kombëtare për banor




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritje e autorëve

Fare pak NJQV të qarkut rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë. Duket se këtë kusht e plotëson bashkia Gjirokastrë dhe disa njësi të vogla vendore: komuna Dropull i Sipërm, Lopës dhe Antigone.


- c. Numri i bizneseve sipas njësive të qeverisjes vendore; numri i bizneseve për banor.

Figura 34. Numri i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve sipas NJQV-ve në qarkun Gjirokastrë



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Figura 35. Numri i bizneseve për 1000 banorë në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritje autorëve

Duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në qark dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t'ju ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitet më të theksuar janë Gjirokastra, Tepelena, Përmeti e Këlcyra.

7.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Gjirokastrës ka 32 njësi administrative. Popullsia është 68 497 banorë – qarku më i vogël në Shqipëri.
- Qarku i Gjirokastrës shënon një nga rastet më të spikatura të zvogëlimit të popullsisë në krahasim me 2001 (-40%). Rënie kanë pësuar zonat urbane (-20%), por më shumë ato rurale - përgjysmuar me 51%. Dendësia gjithashtu ka rënë në mënyrë drastike (-40%).
- Qarku i Gjirokastrës numëron rreth 21 287 familje.
- Popullsia rinore (15 – 29 vjeç) është rreth 15 660 persona ose rreth 22,8% të popullsisë. Popullsia në moshë pune 15 – 64 vjeç është 48 565 persona ose rreth 71%, ndërsa moshë e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 16,8% – qarku me përqindjen më të madhe të moshës së tretë.
- 6,4% e popullsisë janë persona me aftësi të kufizuara.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun e Gjirokastrës sipas gjinisë është 38 194 meshkuj, e shprehur në përqindje afërsisht 50,8% e popullsisë së qarkut, dhe 36 978 femra, afërsisht 49,2%.
- Popullsia në moshë pune në qarkun e Gjirokastrës është 48 565 persona ose e shprehur kjo në përqindje do të përbënte 67,3% të totalit të popullsisë së qarkut. Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Gjirokastrës janë 5044 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 732 përfitojnë pagesë papunësie.
- Ndërkohe që popullsia emigruese e kthyer është 4550 persona, ku meshkujt përbëjnë 62,4% të të gjithë të kthyerve.

Strehimi

- 21 287 familje, 19 688 në pronësi ose në proces pronësimi, 1022 me qira, 577 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Gjirokastrës ka mesatarisht 2,9 dhoma.
- 404 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 945 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 21 287 banesa të banuara) ose rreth 6,38% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 1421 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 21 287 banesa të banuara) ose 6,7%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Gjirokastrës shënon një nivel varfërie prej 10,7%. Thellësia e varfërisë është 2,2% dhe ashpërsia 0,9%. Këta tregues janë më të ulët se niveli kombëtar i varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Nga ana tjetër, 2332 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Gjirokastrës ose rreth 2,4% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 11% të totalit të familjeve.
- Koeficienti GINI për qarkun e Gjirokastrës është 24,5.
- Konsumi total për familje në këtë qark është 45 717 lekë krahasuar me konsumin për person që është 12 556 lekë.

Shëndetësia

- 4807 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 8,7%.
- 3 spitale me 380 shtretër, si dhe 56 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Gjirokastrës kemi një numër total mjekësh prej 122.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 13 minuta, ndërsa në zonat rurale 21 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 15 minuta për jo të varfrit dhe 30 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 1625 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 2,4%.

Shërbimet

Gjirokastrë	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	2	0
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	0
Shërbime sociale për fëmijët	1	3
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	1
Shërbime sociale për PAK	0	0
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	1
Gjithsej	3	5

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

7.6 Përfundime

Popullsia e qarkut Gjirokastrë përbën vetëm 2,58% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 2256 banorë/NJQV. Qarku Gjirokastrë është qarku me popullsinë më të vogël dhe njëkohësisht mesatarja e popullsisë për NJQV është më e ulura në vend – gati 4 herë më e ulët se mesatarja në rang vendi.

Dendësia mesatare e popullsisë është 254 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Përmeti (3123 banorë/km²), Memaliaj (2003 banorë/km²), Tepelena (1791 banorë/km²) dhe Gjirokastra (667 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësinë më të lartë, ndërsa komunat Pogon, Frashër e Zagorie (2- 3 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët, ndërkohë që 9 NJQV kanë dendësi më të ulët se 10 banorë/km² (Dropull i Sipërm, Picar, Çarçovë, Buz, Kurvelesh, Lopës etj.).

Njësitë vendore të qarkut Gjirokastrë shpenzojnë rreth 3,2% të totalit të shpenzimeve vendore ose 0,08% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve vihet re në vitin 2009 – rreth 4,3% e buxhetit vendor krahasuar me 2,9% në vitin 2012.

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë përbëhen në pjesën më të madhe (thujse 77%) prej të ardhurave prej granteve qeveritare me apo pa kusht. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore përbëjnë vetëm 23% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë, ndërsa të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara kanë përbërë nga 10,7% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 25% të këtij totali në vitin 2012. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2012 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin, por në raport me qarqet e tjera duket se NJQV-të e qarkut Gjirokastrë përfitojnë më pak.

Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë: rreth 75% e NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë na prezantohen në pozitë të vështirë financiare dhe të pabarabarta krahasuar me mesataren në nivel vendi. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banor. Njësitë që prezantohen në nivele të krahasueshme me NJQV-të në nivel vendi janë bashkia Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Tepelenë, komuna Dropull i Poshtëm etj.

Performanca financiare dhe fiskale: vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësi vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 17,34 Euro/banor (Lunxhëri) në 108 Euro/banor (Kurvelesh), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga diçka më shumë se 1 Euro/banor (Frashër e Luftinjë) në 53,78 Euro/banor (Gjirokastrë). Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, thujse në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore (Memaliaj, Qesarat, Lopës, Buzë, Deshmnicë, Përmet, Petran, Dropull i Poshtëm etj.). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, 9 NJQV në qarkun e Gjirokastrës nuk shpenzuan asnjë lek për investime, ndërkohë që 12 NJQV shpenzuan për investime kapitale më tepër se mesatarja në rang vendi 14,3 Euro/banor (Luftinjë, Buzë, Kurvelesh, Memaliaj, Petran, Frashër, Deshnicë, Dropull i Sipërm, Antigone, Qendër Libohovë). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme është e qartë që investimet kapitale në këto NJQV janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara.

Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banor në NJQV-të e Gjirokastrës është rreth 26,18 Euro/banor në vitin 2011, krahasuar me mesataren kombëtare prej rreth 30 Euro/banor. Duke iu referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për

banor e kanë komunat Dropull i Sipërm, Pogon, Odrie (diçka më pak se 10 Euro/banor) dhe nivelin më të lartë komunat Luftinjë, Buz e Kurvelesh (me mbi 40 Euro/banor).

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Gjirokastrë zënë mesatarisht 73% të totalit të shpenzimeve, nivel ndjeshëm më i lartë krahasuar me mesataren në nivel vendi prej 66%. Ndërkohë, për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në 100% të buxhetit vendor (Odrie, Pogon, Zagorie, Krahëz, Qesarat, Lopës etj.)

Po ashtu, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Gjirokastrë mesatarisht 63%, raport gati 8% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Krahëz, Qesarat, Picar, Lazarat, Antigone etj.)

Konkurreshmëria mes NJQV-ve dhe mundësia për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor: janë fare pak NJQV në qarkun Gjirokastrë që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banor prej biznesit. Ato janë bashkitë Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë e disi Këlcyrë. Ndërkohë që janë 14 NJQV (44%) që nuk gjenerojnë thuajse asgjë prej taksës së biznesit të vogël. Pak NJQV rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë. Duket se këtë kusht e plotëson bashkia Gjirokastrë dhe disa njësi të vogla vendore: komuna Dropull i Sipërm, Lopës dhe Antigone. Së fundmi, duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në qark dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t'iu ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitet më të theksuar janë Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet e Këlcyrë.


8 Qarku Korçë

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Korçës. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

8.1 Profili i qarkut Korçë dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Korçës përbëhet prej 4 rretheve: Devoll, Kolonjë, Korçë dhe Pogradec, si dhe 37 NJQV-ve të organizuara; 5 në rrethin e Devollit, 8 në rrethin e Kolonjës, 16 në rrethin e Korçës dhe 8 në rrethin e Pogradecit. Qarku i Korçës ka një popullsi prej 220 357 banorësh (në rrethin e Devollit 26 716 banorë, në rrethin e Kolonjës 11 070 banorë, në rrethin e Korçës 121 041 banorë dhe në rrethin e Pogradecit 61 530 banorë) (INSTAT, Census 2011).

Figura 36. NJQV-të në qarkun e Korçës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Këto shifra paraqiten konsiderueshëm më të ulura (rreth 30% më pak) referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në janar 2012 popullsia e qarkut të Korçës rezultoi 352 151 banorë (në rrethin e Devollit 42 582 banorë, në rrethin e Kolonjës 20 326 banorë, në rrethin e Korçës 198 943 banorë dhe në rrethin e Pogradecit 90 300 banorë).

Tabela 13. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Korçë

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011	RGJC 2011	DIFERENCA
Devoll	Bilisht	6250	10 024	
Devoll	Hoçisht	4461	7092	
Devoll	Miras	6577	10 589	
Devoll	Progër	3988	6024	
Devoll	Qendër Bilisht	5440	8853	
TOTAL DEVOLL		26 716	42 582	-15 866
Kolonjë	Barmash	480		
Kolonjë	Çlirim	355		
Kolonjë	Ersekë	3746	6998	
Kolonjë	Leskovik Komunë	416		
Kolonjë	Leskovik	1525	4305	
Kolonjë	Mollas	1520	4215	
Kolonjë	Novoselë	355		
Kolonjë	Qendër Ersekë	2673	4808	
Total Kolonjë		11 070	20 326	-9256
Korçë	Drenovë	5581	10 446	
Korçë	Gorë	1565	4301	
Korçë	Korçë	51 152	87 015	
Korçë	Lekas	392		
Korçë	Libonik	8922	13 803	
Korçë	Liqenas	3290	5187	
Korçë	Maliq	4290	7901	
Korçë	Moglicë	951		
Korçë	Mollaj	3438	9169	
Korçë	Pirg	7652	9959	
Korçë	Pojan	10 864	17 091	
Korçë	Qendër	9022	13 955	
Korçë	Vithkuq	1519		
Korçë	Voskop	3832	6026	
Korçë	Voskopojë	1058	3621	
Korçë	Vreshtas	7513	10 469	
Total Korçë		121 041	198 943	-77 902
Pogradec	Buçimas	15687	17 362	
Pogradec	Çërravë	7009	9801	
Pogradec	Dardhas	2182	3481	
Pogradec	Hudënisht	5990	7608	
Pogradec	Pogradec	20 848	38 645	
Pogradec	Proptisht	4785	6520	
Pogradec	Trebinjë	2481	3176	
Pogradec	Velçan	2548	3707	
Total Pogradec		61 530	90 300	-28 770
Total qarku Korçë		220 357	352 151	-131 794

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Korçë përbën rreth 7,9% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezultoi

5956 banorë/NJQV. Kjo mesatare është gati 25% më e ulët se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV). Nisur dhe nga morfologjia e territorit rreth 63% e NJQV-ve kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë dhe vetëm 8% e NJQV-ve kanë popullsi më të lartë se 10 000 banorë (Pojan, Buçimas, Pogradec e Korçë).

Tabela 14. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Korçë sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


Klasifikimi i NJQV-ve sipas numrit të popullsisë	Korçë	Shqipëria
Popullsia	7,87%	100,00%
Popullsia mesatare për NJQV	5956	8016
< 2000	29,73%	27,61%
2000-5000	32,43%	34,58%
5000-10 000	27,03%	26,27%
10 000-20 000	5,41%	6,70%
20 000-30 000	2,70%	1,61%
30 000-50 000	0,00%	1,07%
50 000-100 000	2,70%	1,61%
100 000-200 000	0,00%	0,27%
> 200 000	0,00%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 469 banorë/km², krahasuar me 974 banorë/km² në rang vendi. Pogradeci (8616 banorë/km²) dhe Korça (3572 banorë /km²) janë njësitë vendore me dendësinë më të lartë, ndërsa komuna Leskovik (1,7 banorë/km²) dhe Çilirim (3,5 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët, ndërkohë që 10 NJQV kanë dendësi më të ulët se 10 banorë/km² (Barmash, Novoselë, Lekas, Moglicë, Vithkuq, Voskopojë etj.)

Njësitë vendore të qarkut Korçë zënë rreth 7% të totalit të shpenzimeve vendore ose 0,18% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve vihet re në vitin 2009 – rreth 8,4% e buxhetit vendor krahasuar me 6,7% në vitin 2012.

Figura 37. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Korçë krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve


Pjesa më e madhe e shpenzimeve në të gjitha NJQV-të e qarkut të Korçës shkon për shpenzime operative – mesatarisht gjatë viteve 2008 – 2012 rreth 68%, nga të cilat pagat

dhe sigurimet përbëjnë 35% ose mesatarisht 7,23% të totalit të shpenzimeve vendore në Shqipëri.

Shpenzimet kapitale kanë pësuar një farë rritjeje në raport me shpenzimet operative gjatë viteve 2009 dhe 2010, por fillojnë të bien në 2011, për të arritur nivelin më të ulët prej vetëm 22,8% të totalit të shpenzimeve në nivel qarku në vitin 2011.

Ndërkohë, shpenzimet për paga dhe sigurime arrijnë nivelin më të lartë, si në përqindje, ashtu edhe në vlerë nominale në vitin 2012 – 42,1% e totalit të shpenzimeve vendore.


Figura 38. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Korçë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Korçë përbëjnë rreth 10,4% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Ato ndjekin të njëjtin trend të totalit të të ardhurave vendore, duke pësuar një rritje në vitin 2009 për të vazhduar pastaj me trendin rënës gjatë viteve 2010 - 2012.


Figura 39. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Korçë kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Korçë përbëhen në pjesën më të madhe (thuhetse 73%) prej të ardhurave prej granteve qeveritare me apo pa kusht. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore përbëjnë vetëm 27% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Korçë, ndërsa të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara kanë përbërë nga 12% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 63% të këtij totali në vitin 2012. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2012 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin.

Figura 40. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Korçës




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritje e autorëve

8.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Korçë

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Korçë, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.


Figura 41. Raporti mes buxheteve të NJQV-ve me mesataren e buxheteve të NJQV-ve të qarkut Korçë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.


Figura 42. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor (në qarkun Korçë) krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Figura 43. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor (në qarkun Korçë) krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritje e autorëve

Duke iu referuar të tre treguesve të zhvilluar në tabelat e mësipërme evidentojmë një numër të konsiderueshëm prej NJQV-vë të qarkut Korçë, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në nivel vendi për banorë. Të tilla janë komunat e Vithkuqit, Liqenasit, Vreshatsit, Trebinjës, Dardhasit, Velçanit, Propotishtit, Çlirimit etj.

8.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Korçë

Le të shikojmë sesi prezantohen nivelet e të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë në NJQV-të e qarkut Korçë.

Figura 44. Të ardhurat dhe shpenzimet për banor në NJQV-të e qarkut Korçë (2008 – 2011)



Shpenzimet totale/të ardhurat totale


Shpenzimet totale / banorë

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Mesatarja e të ardhurave për banor në NJQV-të e qarkut Korçë është rreth 70,25 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. E ardhura më e lartë për banor rezulton në Barmash dhe në Novoselë (rreth 120 Euro/banorë), ndërsa më e ulëta në Hoçisht, Bulgarec dhe Pojan (rreth 38 Euro/banor).

Thuajse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banor.

Figura 45. Shpenzimet totale për banor krahasuar me të ardhurat e veta të NJQV-së për banor në qarkun e Korçës



Shpenzimet totale/banor


Të ardhurat e veta të NJQV-së/banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Referuar hartës për të ardhurat e veta të NJQV-së/banor, vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 15 Euro/banor (Pirg) në 70 Euro/banor (Piskal-Novoselë), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga 1,36 Euro/banor (Velçan e Trebinjë) në 57 Euro/banor (Pogradec).

Le të shikojmë se çfarë ndodh në lidhje me investimet kapitale në NJQV-të e qarkut Korçë, duke përdorur si bazë krahasimore investimet kapitale për frymë në NJQV-të ndryshme.

Figura 46. Investimet kapitale krahasuar me shpenzimet totale të NJQV-ve dhe grantet e kushtëzuara për banor në NJQV-të e qarkut të Korçës



Investimet kapitale/Totalin e Shpenzimeve


Grantet e kushtëzuara/banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësive të qeverisjes vendore (Moglicë, Vreshtas, Bilisht, Mollas, Trebinjë, Çlirim, Leskovik etj.). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, dhjetë NJQV në qarkun e Korçës nuk shpenzuan asnjë lek për investime, ndërkohë që vetëm 6 NJQV shpenzuan për investime kapitale më tepër se mesatarja në rang vendi 14,3 Euro/banor (Progër, Leskovik, Mollas, Gorë, Mollaj dhe Trebinjë). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme është e qartë që investimet kapitale në këto NJQV janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara.

Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banor në NJQV-të e Korçës është rreth 32,4 Euro/banor në vitin 2011, krahasuar me mesataren kombëtare prej rreth 30 Euro/banor. Duke iu referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për banor e ka komuna Liqenas (11 Euro/banor) dhe nivelin më të lartë komunat Velçan, Trebinjë e Dardhas (rreth 67 Euro/banor).

Figura 47. Shpenzimet operative dhe shpenzimet për paga e sigurime të NJQV-ve të qarkut Korçë



Shpenzimet operative / Shpenzimet totale

Shpenzimet për paga e sigurime / shpenzimet operative

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Korçë zinin mesatarisht 79% të totalit të shpenzimeve, nivel ndjeshëm më i lartë krahasuar me mesataren në nivel vendi prej 66%. Ndërkohë, për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në 100% të buxhetit vendor (Ersekë, Çlirim, Barmash, Qendër Leskovik, Piskal-Novoselë, Maliq, Lekas, Moglicë, Dardhas).


Shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Korçë zënë mesatarisht 63%, raport gati 8% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Barmash, Mollas, Lekas, Pirg, Gorë, Velçan, Trebinjë etj.)

8.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Korçë

Disa prej treguesve që mund të konsiderojmë për të vlerësuar klimën dhe mundësinë për zhvillim ekonomik që ofron një NJQV, janë listuar më poshtë dhe do të shtjellohen më tej në dokument.

- a. Të ardhurat nga taksat e biznesit për banor (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 15. Taksa e biznesit të vogël (TBV) për banor sipas NJQV-ve të qarkut Korçë krahasuar me mesataren për banor në nivel kombëtar




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Referuar këtij treguesi janë fare pak NJQV në qarkun Korçë që arrijnë të gjenerojnë të ardhura prej biznesit të krahasueshme për banor. Ato janë Bilishti, Erseka, Leskoviku, Korça, Maliqi dhe Pogradeci.

Le të shikojmë edhe treguesit e tjerë për të vlerësuar se cilat prej NJQV-ve të qarkut të Korçës mundësojnë kushte për zhvillimin ekonomik e cilat jo.

- b. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (tokë dhe ndërtesë), nga taksa e automjeteve, etj.

Tabela 16. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Korçë, krahasuar me mesataren kombëtare për banor




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Fare pak NJQV rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë. Duket se bashkia Korçë dhe komuna Voskop janë të vetmet që gjenerojnë mbi mesataren në nivel vendi për sa i përket taksës së pasurisë.


- c. Numri i bizneseve sipas njësive të qeverisjes vendore; numri i bizneseve për banor.

Figura 48. Numri i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve sipas NJQV-ve në qarkun Korçë



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Figura 49. Numri i bizneseve për 1000 banorë në NJQV-të e qarkut Korçë



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në qark dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t'ju ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitet më të theksuar janë Bilishti, Erseka, Leskoviku, Korça, Maliqi dhe Pogradeci.

8.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Korçës ka 37 njësi administrative. Popullsia është 216 429 banorë.
- Qarku i Korçës gjithashtu ka pësuar rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-18,5%). Rënie kanë pësuar edhe zonat urbane (-13,5%), por më shumë ato rurale (-21%). Dendësia gjithashtu ka rënë (-18,5%).
- Qarku i Korçës numëron 60 171 familje.
- Popullsia rinore (15 - 29 vjeç) është rreth 50 371 persona ose rreth 23,2%. Popullsia në moshë pune 15 - 64 vjeç është 148 659 persona ose rreth 68,6%, ndërsa mosha e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 14,1% – qarku me përqindje gjithashtu të lartë të moshës së tretë. Ndërsa pjesa tjetër, 11 434 persona që përfaqësojnë rreth 5,2% të popullsisë, janë persona me aftësi të kufizuara.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun Korçë sipas gjinisë është 111 627 meshkuj, e shprehur në përqindje afërsisht 50,6% e popullsisë së qarkut dhe 108 811 femra, afërsisht 49,4%.
- Popullsia në moshë pune në qarkun e Korçës është 148 659 persona, ose e shprehur kjo në përqindje do të përbënte 67,5% të totalit të popullsisë së qarkut.
- Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Korçës janë 9845 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 1060 përfitojnë pagesë papunësie.
- Ndërkohë që popullsia emigruese që është kthyer në qarkun e Korçës është 12 080 persona, të kthyer prej vitit 2001 deri më 2011. Nga ky numër personash 7890 janë meshkuj, që përbëjnë 65,3% të të gjithë të kthyerve, ndërsa pjesa e mbetur janë femra, 4190 persona.

Strehimi

- 60 171 familje, 56 342 në pronësi ose në proces pronësimi, 2046 me qira, 1783 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Korçës ka mesatarisht 2,86 dhoma.
- 695 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 3103 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 60 171 banesa të banuara) ose rreth 6,46% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 4326 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër nga 60 171 banesa të banuara) ose 7,18%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Korçës shënon një nivel varfërie prej 12,2%. Thellësia e varfërisë është 2,5% dhe ashpërsia 0,7%. Këta tregues janë më të ulët se niveli kombëtar i varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Nga ana tjetër 9593 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Korçës ose rreth 9,8% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 16% të totalit të familjeve.
- Koeficienti GINI për qarkun e Korçës është 26%.
- Konsumi total për familje në qarkun e Korçës është 453 968 lekë krahasuar me konsumin për person që është 115 169 lekë.

Shëndetësia

- 11 434 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 6,8%.
- 4 spitale me 752 shtretër, si dhe 150 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Korçës kemi një numër total mjekesh prej 292.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 11 minuta, ndërsa në zonat rurale 16 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 14 minuta për jo të varfrit dhe 12 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 4792 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 2,4%.

Shërbimet

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	0
Shërbime sociale për fëmijët	1	5
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	2
Shërbime sociale për PAK	1	3
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	1	0
Gjithsej	4	11

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

8.6 Përfundime

Popullsia e qarkut Korçë përbën rreth 7,9% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 5956 banorë/NJQV. Kjo mesatare është gati 25% më e ulët se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV). Nisur dhe nga morfologjia e territorit rreth 63% e NJQV-ve kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë dhe vetëm 8% e NJQV-ve kanë popullsi më të lartë se 10 000 banorë (Pojan, Buçimas, Pogradec e Korçë).

Dendësia mesatare e popullsisë është 469 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Pogradeci (8616 banorë/km²) dhe Korça (3572 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësinë më të lartë, ndërsa Komuna Leskovik (1,7 banorë/km²) dhe Çlirim (3,5 banorë/km²) janë njësitë me dendësinë më të ulët, ndërkohë që 10 NJQV kanë dendësi më të ulët se 10 banorë/km² (Barmash, Novoselë, Lekas, Moglicë, Vithkuq, Voskopojë etj.).

Njësitë vendore të qarkut Korçë shpenzojnë rreth 7% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,18% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve vihet re në vitin 2009 – rreth 8,4% e buxhetit vendor krahasuar me 6,7% në vitin 2012.

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Korçë përbëhen në pjesën më të madhe (thujse 73%) prej të ardhurave prej granteve qeveritare me apo pa kusht. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore përbëjnë vetëm 27% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Korçë, ndërsa të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara kanë përbërë nga 12% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 63% të këtij totali në vitin 2012. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2012 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin.

Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Korçë: janë evidentuar një numër i konsiderueshëm i NJQV-ve të qarkut Korçë, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banor. Të tilla janë komunat e Vithkuqit, Liqenasit, Vreshtasit, Trebinjës, Dardhasit, Velçanit, Propotishtit, Çlirimit etj.

Performanca financiare dhe fiskale: vihet re një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 15 Euro/banor (Pirg) në 70 Euro/banor (Piskal-Novoselë), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga 1,36 Euro/banor (Velçan e Trebinjë) në 57 Euro/banor (Pogradec).

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësive të qeverisjes vendore (Moglicë, Vreshtas, Bilisht, Mollas, Trebinjë, Çlirim, Leskovik etj.). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, dhjetë NJQV në qarkun e Korçës nuk shpenzuan asnjë lek për investime, ndërkohë që vetëm 6 NJQV shpenzuan për investime kapitale më tepër se mesatarja në rang vendi 14,3 Euro/banor (Progër, Leskovik, Mollas, Gorë, Mollaj dhe Trebinjë). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme është e qartë që investimet kapitale në këto NJQV janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara.

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Korçë zënë mesatarisht 79% të totalit të shpenzimeve, nivel ndjeshëm më i lartë krahasuar me mesataren në nivel vendi

prej 66%. Ndërkohë që për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në 100% të buxhetit vendor (Ersekë, Çlirim, Barmash, Qendër Leskovik, Piskal-Novoselë, Maliq, Lekas, Moglicë, Dardhas).

Ndërkohë, shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Korçë mesatarisht 63%, raport gati 8% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Barmash, Mollas, Lekas, Pirg, Gorë, Velçan, Trebinjë etj.).

Konkurrueshmëria mes NJQV-ve dhe mundësia për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor: janë fare pak NJQV në qarkun Korçë që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banor prej biznesit. Ato janë Bilishti, Erseka, Leskoviku, Korça, Maliqi dhe Pogradeci. Fare pak NJQV rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë. Duket se bashkia Korçë dhe komuna Voskop janë të vetmet që gjenerojnë mbi mesataren në nivel vendi për sa i përket taksës së pasurisë. Së fundmi, duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në qark dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t'ju ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitet më të theksuar janë Bilishti, Erseka, Leskoviku, Korça, Maliqi dhe Pogradeci.

9 Qarku Kukës

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Kukësit. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

9.1 Profili i qarkut Kukës dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Kukësit përbëhet nga 27 NJQV në tre rrethe: rrethi i Hasit (4 njësi, qendër Krumë); rrethi i Kukësit (15 njësi, qendër Kukës) dhe rrethi i Tropojës (8 njësi, qendër Bajram Curri). Popullsia e qarkut të Kukësit ishte 85 292 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 56% (47 895 banorë) jetojnë në rrethin e Kukësit, 24% (20 517) jetojnë në rrethin e Tropojës dhe rreth 20% (16 790 banorë) jetojnë në rrethin e Hasit. (INSTAT, Census 2011).

Figura 50. NJQV-të në qarkun e Kukësit sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Qarku i Kukësit ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 23% ose mbi 25 000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012 në qarkun e Kukësit ishin të regjistruar 110 826 banorë, me përqendrim shumë të ngjashëm sipas rretheve me atë të raportuar nga Censusi 2011.

Tabela 26. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Kukës

Qarku	Rrethi	Njësia	Census 2011	Regjistri civil 2011	Ndryshimi i popullsisë	Ndryshimi në %
KUKËS	HAS	Fajzë	3491	4168	-677	-16%
KUKËS	HAS	Gjinaj	1106	1320	-214	-16%
KUKËS	HAS	Golaj	6187	7874	-1687	-21%
KUKËS	HAS	Krumë	6006	7466	-1460	-20%
Has Total			16 790	20 828	-4038	-19%
KUKËS	KUKËS	Arrën	462	731	-269	-37%
KUKËS	KUKËS	Bicaj	5631	6375	-744	-12%
KUKËS	KUKËS	Bushticë	1486	1504	-18	-1%
KUKËS	KUKËS	Grykë-Çaje	1440	1330	110	8%
KUKËS	KUKËS	Kalis	827	1315	-488	-37%
KUKËS	KUKËS	Kolsh	1250	1621	-371	-23%
KUKËS	KUKËS	Kukës	16 719	22 547	-5828	-26%
KUKËS	KUKËS	Malzi	3072	4039	-967	-24%
KUKËS	KUKËS	Shishtavec	3835	5274	-1439	-27%
KUKËS	KUKËS	Shtiçen	3438	3603	-165	-5%
KUKËS	KUKËS	Surroj	1099	1469	-370	-25%
KUKËS	KUKËS	Tërthorë	2959	3346	-387	-12%
KUKËS	KUKËS	Topojan	1753	2652	-899	-34%
KUKËS	KUKËS	Ujmisht	1797	2365	-568	-24%
KUKËS	KUKËS	Zapod	2217	3144	-927	-29%
Kukës Total			47 985	61 315	-13 330	-22%
KUKËS	TROPOJË	Bajram Curri	5340	8188	-2848	-35%
KUKËS	TROPOJË	Bujan	2550	3102	-552	-18%
KUKËS	TROPOJË	Bytyç	1563	2119	-556	-26%
KUKËS	TROPOJË	Fierzë	1607	2407	-800	-33%
KUKËS	TROPOJË	Fshat Tropojë	4117	5539	-1422	-26%
KUKËS	TROPOJË	Lekbibaj	1207	2122	-915	-43%
KUKËS	TROPOJË	Llugaj	1787	2237	-450	-20%
KUKËS	TROPOJË	Margegaj	2346	2969	-623	-21%
Tropojë Total			20 517	28 683	-8166	-28%
Totali i përgjithshëm			85 292	110 826	-25 534	-23%

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Kukës përbën më pak se 4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 3159 banorë/NJQV, ose 60% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Rrethi i Tropojës ka mesataren më të ulët të popullsisë në qark. Njësitë më të vogla janë Arrën dhe Kalis në Kukës (më pak se 1300 banorë së bashku).

Tabela 27. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Kukës sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


	<i>Nr. i njësive</i>	<i>Min.</i>	<i>Maks.</i>	<i>Mesatare / njësi</i>	<i>Shuma</i>	<i>% e popullsisë</i>	<i>Shqipëria</i>
Shqipëria				8016	2 311 848	100%	
Kukës				3159	85 292	3.7%	
0-2000	13	462	1797	1337	17 384	20%	27,61%
2001-5000	9	2217	4117	3114	28 025	33%	34,58%
5001-10 000	4	5340	6187	5791	23 164	27%	26,27%
10 001–20 000	1	16 719	16 719	16 719	16 719	20%	6,70%
20 001-30 000							1,61%
30 001-50 000							1,07%
50 000-100 000							1,61%
100 000-200 000							0,27%
200 000+							0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritje e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është çuditërisht më e lartë se kombëtarja: 141 banorë/km² përkundrejt 97,4 banorë/km² në rang vendi. Megjithatë, shumica e njësive kanë dendësi shumë të ulët: gjysma janë nën nivelin 28 banorë/km², ndërkohë që dendësia mesatare e komunave është 33 banorë/km². Zonat urbane kanë dendësi më të lartë, si qyteti i Kukësit (1222 banorë/km²), Bajram Currit (1749 banorë/km²), ndërkohë që Kruma ka dendësi të ulët (81 banorë/km²).

Pesha e njësive të qarkut Kukës në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 2,8% në vitin 2012, me një rritje të lehtë krahasuar me vitet paraardhëse (2,5%, përfshirë edhe rritje në vlerë absolute).


Figura 43. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Kukës krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale në qarkun e Kukësit, mesatarisht pothuajse 70% në vitet 2008 - 2012 dhe 65% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë më shumë se gjysma e shpenzimeve operative gjithsej, ose mesatarisht 38% e shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Shpenzimet kapitale kanë një peshë specifike prej 31% në strukturën totale, ose 35% në vitin 2012, me rritje në krahasim me 2011 (29%). Ky raport është më i ulët se raportet kombëtare prej 34% në 5 vite, por më i lartë për vitin e fundit (26% në vitin 2012 në nivel kombëtar). Bashkia e Kukësit, e cila ka rreth 19% të popullsisë së qarkut, zë një peshë prej rreth 26% në totalin e shpenzimeve të njëjësive të qarkut, por vetëm 19% në shpenzimet për investime. Ndërkohë, pothuajse gjysma (49%) e të ardhurave të veta të qarkut të Kukësit gjenerohen në bashkinë Kukës.


Figura 44. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Kukës



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve edhe në qarkun e Kukësit, me rreth 63% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) me rreth 23% mesatarisht.


Figura 45. Shpenzimet sipas sektorëve (funksioneve) në NJQV-të e qarkut Kukës



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Kukës përbëjnë rreth 3,5% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Në vitin 2009 të ardhurat janë më shumë se trefishuar në krahasim me vitin 2008, por kanë rënë gradualisht çdo vit në vitet 2010 - 2012 në vlerë absolute.


Figura 46. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Kukës kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë më pak se 8% të totalit në qarkun e Kukësit, ndërkohë që në vitet 2009 - 2012 mbi 60% e të ardhurave vijnë nga transfertat e kushtëzuara. Në vitin 2012 të ardhurat nga burimet e veta përbënë 6%, ndërkohë që ka pasur një rritje të transfertës së pakushtëzuar (32%).

Figura 47. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Kukësit



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

9.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Kukës

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Kukës, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- a. Buxhetin vendor i NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.

Njësia me buxhet (të ardhurat totale) më të madh është natyrisht bashkia e Kukësit (178 milionë në vitin 2012). Qyteti i Kukësit ka një peshë specifike prej 12% në buxhetin total të njësive të qarkut, ndërsa realizon rreth 49% të të ardhurave të veta totale. Bashkitë e tjera të qarkut si Bajram Curri dhe Kruma kanë buxhete më modeste rreth 7% të buxhetit total të njësive të Kukësit, ndërsa realizojnë përkatësisht 20% dhe 9% të të ardhurave të veta totale për njësitë e qarkut Kukës. Në përgjithësi komunat e qarkut realizojnë të ardhura modeste në përpjesëtim me popullsitë përkatëse.

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 28. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor

Qark	Rreth	Njësi	2010	2011	2012							
			Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Biznesi vogël	Taksa pasurisë	Ndiki m infrastrukturë	Regjistrimi automjeteve	Tarifë pastri mi	Transf. e pak.	Transf. e kusht
Ku	Has	Fajzë	0,13	0,02	0,01	-	-	-	0,20	-	1,25	2,44
Ku	Has	Gjinaj	0,09	0,04	0,08	-	-	-	0,49	-	2,77	14,56
Ku	Has	Golaj	0,18	0,01	0,12	-	0,07	0,27	0,12	0,01	1,30	1,13
Ku	Has	Krumë	0,93	0,45	0,36	-	0,26	0,21	0,35	0,40	1,72	1,91
Ku	Kukës	Arrën	0,29	-	0,01	-	-	-	0,11	-	3,06	4,62
Ku	Kukës	Bicaj	0,21	0,01	0,02	-	-	-	0,29	0,02	1,27	0,92
Ku	Kukës	Bushtricë	0,22	0,20	0,07	-	-	-	0,10	-	2,03	3,40
Ku	Kukës	Grykë-Çaje	0,02	-	0,01	-	-	-	0,20	-	3,62	11,87
Ku	Kukës	Kalis	0,10	-	0,02	-	-	-	0,05	-	2,07	4,61
Ku	Kukës	Kolsh	0,24	0,03	0,36	-	-	-	0,19	-	1,58	2,17
Ku	Kukës	Kukës	0,97	0,78	0,69	0,12	0,67	0,81	0,70	0,78	1,68	0,38
Ku	Kukës	Malzi	0,16	0,01	0,07	-	-	0,24	0,27	-	1,84	3,29
Ku	Kukës	Shishta vec	0,05	-	0,01	-	0,04	-	0,10	-	1,21	1,50
Ku	Kukës	Shtiqen	0,20	0,06	0,15	-	0,01	-	0,34	0,24	1,28	2,12
Ku	Kukës	Surroj	0,90	0,03	0,08	-	-	0,03	0,39	-	2,35	1,18
Ku	Kukës	Tërthorë	0,24	0,10	0,64	-	-	3,63	0,56	-	1,37	2,28
Ku	Kukës	Topojan	0,13	-	0,00	-	-	-	0,07	-	1,65	1,92
Ku	Kukës	Ujmisht	0,09	0,01	0,01	-	-	-	0,18	-	1,49	2,82
Ku	Kukës	Zapod	0,24	0,01	0,02	-	0,01	-	0,07	0,03	1,20	2,86
Ku	Tropojë	Bajram Curri	0,70	0,48	0,74	1,48	0,31	0,17	0,35	1,11	1,52	1,63
Ku	Tropojë	Bujan	0,11	0,02	0,01	-	-	-	0,14	-	1,70	1,66
Ku	Tropojë	Bytyç	0,03	0,01	0,03	-	-	-	0,13	-	2,54	2,69
Ku	Tropojë	Fierzë	1,35	0,16	0,18	0,11	0,40	-	0,22	0,18	1,88	2,86
Ku	Tropojë	Fshat Tropojë	0,16	0,05	0,05	0,04	-	-	0,15	-	1,70	1,08
Ku	Tropojë	Lekbibaj	0,42	-	0,29	-	-	-	0,04	0,03	2,98	3,62
Ku	Tropojë	Llugaj	0,28	-	0,01	-	-	-	0,06	-	1,82	7,06
Ku	Tropojë	Margegaj	0,24	0,13	0,16	-	-	-	0,10	-	2,34	2,33
Kukës Average			34%	34%	32%	10%	7%	20%	22%	10%	190%	329%
Shqipëria			100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Siç shihet në tabelën e mësipërme, të ardhurat e veta për banor në qarkun e Kukësit luhaten në rreth 34% të mesatares kombëtare. Edhe njësitë më të pasura të qarkut, si Kukësi nuk arrijnë mesataren kombëtare për banor për të ardhurat e veta (97%, 78% dhe 69% mesatarisht në vitet 2010, 2011 dhe 2012). Mesatarja për frymë për të ardhurat e veta është tejet e ulët për shumicën dërrmuese të njëjve në Kukës, ndërkohë që mesatarja për frymë për të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe kushtëzuar janë mesatarisht 2 dhe 3 herë më të larta se ajo kombëtare në vitin 2012.

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 29. Shpenzimet totale të NJQV-së për banorë krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banorë të NJQV-ve

Qarku	Rrethi	Njësia	2012			2011		2010	
			Shp./frymë në % të kombëtare	Shpenzime personeli/frymë në % të kombëtare	Investime/frymë në % të kombëtare	Shp./frymë në % të kombëtare	Shpenzime personeli/frymë në % të kombëtare	Shp./frymë në % të kombëtare	Shpenzime personeli/frymë në % të kombëtare
Ku	Has	Fajzë	0,3	0,71	0,15	0,54	0,81	0,77	0,77
Ku	Has	Gjinaj	0,7	1,59	-	0,97	1,61	0,95	1,48
Ku	Has	Golaj	0,6	1,01	0,39	0,49	0,81	0,52	0,74
Ku	Has	Krumë	2,5	1,40	6,07	2,14	1,70	0,88	1,53
Ku	Kukës	Arrën	1,3	1,71	-	1,31	1,74	1,11	1,81
Ku	Kukës	Bicaj	0,4	0,80	-	0,50	0,60	0,46	0,72
Ku	Kukës	Bushtricë	0,4	0,83	-	0,64	1,41	0,75	1,26
Ku	Kukës	Grykë-Çaje	1,1	1,57	0,46	1,32	1,91	1,26	1,63
Ku	Kukës	Kalis	0,6	0,95	-	0,61	0,97	0,97	0,98
Ku	Kukës	Kolsh	0,6	0,80	-	0,49	0,79	1,32	1,16
Ku	Kukës	Kukës	1,4	1,52	1,44	1,23	1,52	1,06	1,76
Ku	Kukës	Malzi	0,6	0,96	0,31	0,59	0,84	0,70	0,84
Ku	Kukës	Shishtavec	0,4	0,73	-	0,42	0,56	0,71	0,60
Ku	Kukës	Shtiçen	1,2	1,51	1,19	0,71	0,71	0,72	0,67
Ku	Kukës	Surroj	1,4	1,70	1,66	1,42	1,73	1,12	1,23
Ku	Kukës	Tërthorë	0,8	0,89	0,93	0,57	0,51	0,62	0,38
Ku	Kukës	Topojan	0,5	0,64	0,23	0,36	0,48	0,63	0,56
Ku	Kukës	Ujmisht	0,4	0,72	-	0,54	0,72	0,54	0,75
Ku	Kukës	Zapod Bajram	0,3	0,68	-	0,36	0,67	0,44	0,60
Ku	Tropojë	Curri	1,9	1,38	3,88	1,02	1,30	1,30	1,36
Ku	Tropojë	Bujan	0,9	0,28	2,70	0,72	0,96	1,21	0,81
Ku	Tropojë	Bytyç	1,0	1,20	1,17	0,91	1,00	1,03	0,92
Ku	Tropojë	Fierzë Fshat	2,4	2,28	4,36	1,86	1,41	2,43	1,27
Ku	Tropojë	Tropojë	0,4	0,46	0,78	0,61	0,69	0,73	0,74
Ku	Tropojë	Lekbibaj	1,0	1,70	0,62	0,98	1,40	1,08	1,50
Ku	Tropojë	Llugaj	1,2	0,38	3,65	2,58	1,14	2,56	1,11
Ku	Tropojë	Margegaj	2,4	1,69	1,85	1,73	0,29	1,31	0,78
Kukës Min.			30%	28%	0%	0,36	0,29	0,44	0,38
Kukës Maks.			254%	228%	607%	2,58	1,91	2,56	1,81
Kukës Mesatarja			99%	111%	118%	0,95	1,05	1,01	1,03

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve


Krahasimi i shpenzimeve për frymë na jep disa indikacione të rëndësishme: mesatarisht njësitë e qarkut Kukës shpenzojnë afërsisht sa mesatarja kombëtare për banor, me pak rritje në vitin 2012. Kujtojmë se mesatarja e të ardhurave të veta për qarkun e Kukësit është gjithashtu mjaft më e ulët se ajo kombëtarja, çka tregon shkallë të lartë varësie të njësive

nga transfertat kombëtare (mesatarja e shpenzimeve 95% dhe 101% e mesatares kombëtare në 2011 dhe 2010, përkundrejt mesatares së të ardhurave të veta 34%). Shpenzimet për personelin gjithashtu vërtiten rreth mesatares kombëtare (105% dhe 103% në 2011-2010) dhe rriten në 111% të mesatares kombëtare në vitin 2012, ndërkohë që në njësi të veçanta shpenzimet për personelin për frymë shkojnë në mbi 2 herë mbi mesataren kombëtare në vitin 2012. Është interesante të vërehet se në mënyrë tipike njësitë që kanë më shumë shpenzime administrative janë ato që gjenerojnë më pak të ardhura nga burimet e veta, por që kanë një shkallë të lartë varësie nga transfertat e pakushtëzuara.

9.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Kukës

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë NJQV-të e qarkut Kukës.

Figura 48. Të ardhurat për banor përkundrejt popullsisë dhe shpenzimeve për personelin në NJQV-të e qarkut Kukës 2011



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në NJQV-të e qarkut Kukës ulet nga 453 lekë (3,2 Euro) në vitin 2009, në rreth 290 lekë (2 Euro) për frymë në vitin 2011 dhe rritet në 485 lekë në vitin 2012 (3,5 Euro). Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në nivel kombëtar është përkatësisht 27 Euro dhe 25,4 Euro të mesatares kombëtare në 2009 dhe 2012. Të ardhurat totale për frymë në Kukës janë 19 Euro në vitin 2009 dhe 17 në vitin 2012. Siç është përmendur edhe më lart, vetëm bashkia Kukës gjeneron pothuaj 50% të të ardhurave të veta në rang qarku, ndërkohë që të ardhurat e veta për frymë edhe në bashkinë Kukës janë vetëm 70% e mesatares kombëtare (në ulje nga 97% në vitin 2010).

Grafiku 47 tregon të ardhurat për frymë nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuara, si dhe shpenzimet për paga e sigurime për frymë në vitin 2011. Siç shihet, në përgjithësi njësitë me popullsi më të madhe gjenerojnë të ardhura të veta më të larta për banor, ndërkohë që transfertat e pakushtëzuara ndjek drejtimin e kundërt. Ndërkohë, sjellja e treguesit të shpenzimeve për personelin (për banor gjithashtu) përgjithësisht ka lidhje inverse me të ardhurat e veta për frymë dhe popullsinë totale.


Po të shikojmë klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të njëjësive për qarkun Kukës vërehet se ndonëse shpenzimet totale për frymë pësojnë ulje nga viti 2009 deri në vitin 2012, mesatarja

e shpenzimeve për personelin rritet. Ndërkohë, mesatarja e investimeve kapitale pëson luhatje gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, duhet përmendur se ecuria e investimeve kapitale duhet vrojtuar përgjatë një periudhe relativisht të gjatë, ndaj treguesit vjetorë janë më pak domethënës në këtë rast. Siç shikohet në tabelën 5, disa prej njësive që kanë shpenzime administrative shumë të larta në 2012-ën nuk kanë kryer asnjë investim. Gjithashtu, investimet për frymë tentojnë të jenë më të larta në zonat me popullsi më të vogël se në ato me popullsi më të madhe. Duke vrojtuar strukturën e buxheteve vendore mund të arrihet në përfundimin se shumica e investimeve në njësitë më të vogla financohen me anë të granteve të kushtëzuara dhe ose konkurruese.

Tabela 30. Shpenzimet për frymë 2010 – 2012

Qar ku	Rrethi	Njësia	2010			2011			2012		
			Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë	Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë	Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë
Ku	Has	Fajzë	5561	1863	2427	3359	1919	0	2167	1686	241
Ku	Has	Gjinaj	6871	3596	275	6061	3788	0	4549	3791	0
Ku	Has	Golaj	3793	1803	227	3048	1905	0	3797	2405	633
Ku	Has	Krumë	6364	3721	907	13 394	4018	8304	16 220	3351	9920
Ku	Kukës	Arrën	8038	4397	0	8208	4104	0	8152	4076	0
Ku	Kukës	Bicaj	3310	1749	0	3137	1412	627	2860	1907	0
Ku	Kukës	Bushtricë	5442	3053	574	3989	3324	0	2647	1985	0
Ku	Kukës	Grykë- Çaje	9163	3953	2071	8271	4511	752	6737	3743	749
Ku	Kukës	Kalis	7070	2375	2595	3802	2281	0	3785	2271	0
Ku	Kukës	Kolsh	9582	2829	5394	3085	1851	617	3839	1919	0
Ku	Kukës	Kukës	7685	4268	226	7673	3592	1020	9112	3636	2347
Ku	Kukës	Malzi	5060	2035	757	3714	1981	990	3551	2283	507
Ku	Kukës	Shishtave c	5145	1449	2531	2655	1327	379	2310	1732	0
Ku	Kukës	Shtiçen	5248	1616	1502	4441	1665	1665	7479	3601	1939
Ku	Kukës	Surroj	8145	2993	0	8850	4084	2042	8790	4057	2705
Ku	Kukës	Tërthorë	4532	912	2413	3586	1195	299	5158	2124	1517
Ku	Kukës	Topojan	4577	1363	1687	2262	1131	0	3036	1518	380
Ku	Kukës	Ujmisht	3941	1810	499	3383	1691	846	2570	1713	0
Ku	Kukës	Zapod Bajram	3213	1469	97	2226	1590	0	1937	1614	0
Ku	Tropojë	Curri	9408	3309	3851	6351	3053	1832	12 314	3292	6340
Ku	Tropojë	Bujan	8781	1959	4692	4513	2257	1934	5769	679	4411
Ku	Tropojë	Bytyç	7454	2236	1668	5663	2360	944	6220	2871	1914
Ku	Tropojë	Fierzë Fshat	17 662	3095	10 804	11 633	3324	5816	15 075	5444	7119
Ku	Tropojë	Tropojë	5269	1791	872	3791	1625	0	2746	1098	1281
Ku	Tropojë	Lekbibaj	7864	3639	908	6126	3299	471	6579	4049	1012
Ku	Tropojë	Llugaj	18 628	2691	13 849	16 093	2682	11 623	7795	917	5961
Ku	Tropojë	Margegaj	9528	1887	6104	10 778	674	6736	15 441	4028	3021
Minimum			3213	912	0	2226	674	0	1937	679	0
Maksimum			18 628	4397	13 849	16 093	4511	11 623	16 220	5444	9920
Mesatare			7309	2513	2479	5929	2468	1737	6320	2659	1926
Mesatarja			6871	2236	1502	4441	2257	627	5158	2283	749
Koeficienti i variacionit			0,5	0,4	2,2	0,8	0,5	4,6	0,8	0,5	3,5


Figura 49. Shpenzimet për frymë, operative dhe kapitale 2011 në qarkun Kukës



Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative janë mjaft të larta në njësitë e qarkut Kukës, ashtu si dhe në përgjithësi në nivel vendi. Në veçanti, shpenzimet për paga e sigurime zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale për çdo njësi, duke variuar nga 32% (Margegaj) deri në 88% (Fajzë) në vitin 2012. Pësia relative e zërit të pagave në shpenzimet e përgjithshme operative është rritur në mënyrë të vazhduar nga viti 2010 në 2012-ën në thuajse të gjitha njësitë.

Figura 50. Pësia relative e shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve operative për njësi 2010 - 2012




9.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Kukës

Qeverisja vendore luan një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë seksion do të hedhim një vështrim mbi të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për qarkun e Kukësit, të dhënat mbi forcën e punës dhe punësimin (për sa të dhënat janë të disponueshme), si edhe sipërmarrjen e zhvillimin e bizneseve, të cilat analizohen si nga pikëpamja e përqendrimit në qark, ashtu edhe nga pikëpamja e të ardhurave që gjenerojnë në nivel kombëtar si dhe për çdo njësi.

a. Prodhimi i brendshëm bruto.

Pesha specifike e rajonit të Kukësit ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është më e vogla ndër gjithë rajonet me 2,44%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është 2623 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Census-it 2011, ose 20% më e ulët se mesatarja kombëtare, por më e lartë se PBB për frymë në Dibër, Lezhë, Shkodër dhe Korçë.

Figura 51 Struktura e PBB-së sipas qarqeve 2011




Burimi: INSTAT

Tabela 31. PBB totale dhe PBB për frymë sipas qarqeve

Qarku	PBB, çmime korrente (mln lekë)	Pesha specifike	PBB për frymë në lekë	PBB për frymë Euro	PBB për frymë si % e kombëtares
Shqipëria	2 800 138	100%	457 926	3271	100,0%
Dibër	137 047	3,1%	291 528	2082	63,7%
Durrës	262 785	9,4%	458 656	3276	100,2%
Kukës	85 292	2,4%	367 221	2623	80,2%
Lezhë	134 027	3,6%	349 385	2496	76,3%
Shkodër	215 347	6,0%	361 626	2583	79,0%
Elbasan	295 827	9,2%	400 484	2861	87,5%
Tiranë	749 365	36,3%	621 460	4439	135,7%
Berat	141 944	4,8%	431 071	3079	94,1%
Fier	310 331	9,9%	405 412	2896	88,5%
Gjirokastrë	72 176	2,7%	473 537	3382	103,4%
Korçë	220 357	6,2%	364 077	2601	79,5%
Vlorë	175 640	6,3%	456 462	3260	99,7%


Figura 52. PBB për frymë si përqindje e PBB-së për frymë në nivel kombëtar



Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Kukësit, vërejmë se sektori i bujqësisë ka peshën më të lartë në PBB rajonale me 34%, i ndjekur nga tregtia dhe shërbimet (20%). Industria është veçanërisht e ulët në Kukës, me një peshë specifike vetëm 3%.

Figura 53. Struktura e PBB-së sipas sektorëve për qark



b. Sipërmarrja dhe bizneset.

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Kukës janë të regjistruara 1592 biznese, ndër të cilat 54 ose pak mbi 3% janë biznese të mëdha. Pothuajse gjysma e numrit të përgjithshëm të bizneseve (si dhe e bizneseve të mëdha) operojnë në qytetin e Kukësit.

Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) janë mesatarisht 34 dhe 37 lekë për frymë në vitin 2012 dhe 2011. Këto vlera janë ndjeshëm më të ulëta se mesatarja kombëtare prej 532 dhe 621 lekësh për frymë përkatësisht në 2012 dhe 2011. Shumica dërrmuese e njësive nuk mbledhin asnjë qindarkë nga kjo taksë prej vitesh, ndërkohë që edhe në njësitë ku mblidhet (kryesisht bashkitë) të ardhurat kanë rënë në mënyrë shumë të ndjeshme nga viti në vit, me përjashtim të Bajram Currit.

Të ardhurat nga taksat e biznesit për banorë (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 32. Të ardhurat për frymë nga taksa e biznesit të vogël

			2008	2009	2010	2011	2012
Ku	Has	Fajzë	9	1	0	0	0
Ku	Has	Gjinaj	-	0	0	0	0
Ku	Has	Golaj	3	3	0	0	0
Ku	Has	Krumë	321	288	1	243	0
Ku	Kukës	Arrën	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Bicaj	3	0	0	0	0
Ku	Kukës	Bushtricë	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Grykë-Çaje	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Kalis	11	0	0	0	0
Ku	Kukës	Kolsh	16	0	0	0	0
Ku	Kukës	Kukës	658	372	330	310	64
Ku	Kukës	Malzi	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Shishtavec	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Shtiçen	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Surroj	184	36	22	0	0
Ku	Kukës	Tërthorë	-	0	81	0	0
Ku	Kukës	Topojan	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Ujmisht	-	0	0	0	0
Ku	Kukës	Zapod	-	0	0	0	0
Ku	Tropojë	Bajram Curri	593	533	515	334	775
Ku	Tropojë	Bujan	23	0	0	0	0
Ku	Tropojë	Bytyç	-	0	0	7	0
Ku	Tropojë	Fierzë	78	82	53	43	59
Ku	Tropojë	Fshat Tropojë	117	3	31	38	20
Ku	Tropojë	Lekbibaj	-	0	0	0	0
Ku	Tropojë	Llugaj	-	0	3	0	0
Ku	Tropojë	Margegaj	-	5	0	13	0
		Mesatare	75	49	38	37	34
		Min.	0	0	0	0	0
		Maks.	658	533	515	334	775
		Mesatarja Koeficienti i variacionit	0	0	0	0	0
			2,34	2,68	3,00	2,59	4,38

Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e autorëve

c. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (toka bujqësore dhe ndërtesat).

Tabela 33. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Kukës, krahasuar me mesataren kombëtare për banor

			2008	2009	2010	2011	2012
Ku	Has	Fajzë	-	39	0	0	0
Ku	Has	Gjinaj	-	-	0	0	0
Ku	Has	Golaj	-	-	0	0	30
Ku	Has	Krumë	101	98	116	71	118
Ku	Kukës	Arrën	-	-	0	0	0
Ku	Kukës	Bicaj	16,49	-	0	0	0
Ku	Kukës	Bushtricë	34,23	-	0	0	0
Ku	Kukës	Grykë-Çaje	-	-	0	0	0
Ku	Kukës	Kalis	-	104	0	0	0
Ku	Kukës	Kolsh	-	-	0	0	0
Ku	Kukës	Kukës	121,27	181	71	67	308
Ku	Kukës	Malzi	-	-	0	0	0
Ku	Kukës	Shishtavec	-	-	0	0	20
Ku	Kukës	Shtiqen	-	-	0	6	7
Ku	Kukës	Surroj	-	-	0	1	0
Ku	Kukës	Tërthorë	-	-	0	0	0
Ku	Kukës	Topojan	-	-	0	0	0
Ku	Kukës	Ujmisht	-	-	0	0	0
Ku	Kukës	Zapod	25	25	0	0	7
Ku	Tropojë	Bajram Curri	105	113	125	95	140
Ku	Tropojë	Bujan	7,8	-	1	0	0
Ku	Tropojë	Bytyç	-	-	0	0	0
Ku	Tropojë	Fierzë	21	39	2717	184	182
Ku	Tropojë	Fshat Tropojë	1,8	-	0	0	0
Ku	Tropojë	Lekbibaj	-	-	0	0	0
Ku	Tropojë	Llugaj	-	-	0	0	0
Ku	Tropojë	Margegaj	30,5	-	0	0	0
Mesatare			17	22	112	16	30
Min.			-	-	-	-	-
Maks.			121	181	2717	184	308
Mesatarja Koeficienti i variacionit			-	-	-	-	-
			2,0	2,1	4,6	2,7	2,4

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Performanca e NJQV-ve të Kukësit në lidhje me taksat e pasurisë është mjaft e dobët. Në veçanti, shumica dërrmuese e njësive nuk mbledhin asnjë të ardhur nga kjo taksë. Njësitë pak më të mëdha realizojnë disa të ardhura modeste.

9.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Kukësit ka 27 njësi administrative. Popullsia është 83 276 banorë dhe 17 126 familje.
- Qarku i Kukësit gjithashtu ka pësuar rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-25%). Kemi një kontrast për sa i përket zonave urbane dhe rurale. Zonat urbane kanë pësuar rritje popullsie me 4,2%, ndërsa ato rurale një rënie të ndjeshme (-35%). Dendësia gjithashtu ka rënë (-25%).
- Popullsia rinore (15 – 29 vjeç) është 28,7% e popullsisë.
- Qarku Kukës ka dhe përqindjen me të ulët të moshës së tretë me 8,1%.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun Kukës sipas gjinisë është 50,5% meshkuj dhe 49,5% femra.
- Popullsia në moshë pune është rreth 65% (54 832). Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Kukësit janë 11 125 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 1183 përfitojnë pagesë papunësie.
- Ndërkohë që popullsia emigruese e kthyer është 1116 persona, ku 86% e zënë meshkujt.

Strehimi

- 17 126 familje, 14 959 në pronësi ose në proces pronësimi, 677 me qira, 1490 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Kukësit ka mesatarisht 2,92 dhoma.
- 1,188 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 1,495 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 16 618 banesa të banuara) ose rreth 16,1% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 2805 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 16 618 banesa të banuara) ose 16,8% tregues këto nga më të lartët në vend.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Kukësit shënon një nivel varfërie prej 21,8%. Thellësia e varfërisë është 3,7% dhe ashpërsia 0,9%. Siç shihet ky qark ka numrin më të madh të njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë.
- Nga ana tjetër 11 705 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Kukësit ose rreth 12% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 68,3% të totalit të familjeve që e rendit në vendin e parë në Shqipëri.
- Koeficienti GINI për qarkun e Kukësit është 25,6%.
- Konsumi total për familje në qarkun Kukës është 51 410 Lekë, krahasuar me konsumin për person që është 9860 Lekë për person.

Shëndetësia

- 7,2% (6152 persona) e popullsisë, janë persona me aftësi të kufizuara nga ku gati 1% e zë grupmosha 0 - 15 vjeç.
- 3 spitale me 372 shtretër, si dhe 43 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Kukësit kemi një numër total mjekësh prej 76.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 15 minuta, ndërsa në zonat rurale 22 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 19 minuta për jo të varfrit dhe 22 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 1593 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 2,2%.

Shërbimet

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	2
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	2
Shërbime sociale për fëmijët	0	4
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	1	10
Shërbime sociale për PAK	0	0
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	1
Gjithsej	2	19

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF


10 Qarku Lezhë

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Lezhës. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasuese mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

10.1 Profili i qarkut Lezhë dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Lezhës përbëhet nga 21 NJQV të qeverisjes vendore në tre rrethe: rrethi i Kurbinit (4 njësi, qendër Laç), rrethi i Lezhës (10 njësi, qendër Lezhë) dhe rrethi i Mirditës (7 njësi, qendër Rrëshen). Popullsia e qarkut të Lezhës ishte 134 027 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 49% (65 633 banorë) jetojnë në rrethin e Lezhës, 16% (22 103) jetojnë në rrethin e Mirditës dhe rreth 35% (46 291 banorë) jetojnë në rrethin e Kurbinit. (INSTAT, Census 2011).

Figura 51. NJQV-të në qarkun e Lezhës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet tona

Qarku i Lezhës ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 37% ose mbi 78 000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012 në qarkun e Lezhës ishin të regjistruar 212 781 banorë, me përqendrim shumë të ngjashëm sipas rretheve me atë të raportuar nga Censusi 2011.

Tabela 34. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Lezhë

Qarku	Rrethi	Njësia	Census 2011	Regjistri civil 2011	Ndryshimi i popullsisë	Ndryshimi në %
Lezhë	Kurbini	Fushë-Kuqe	5460	8613	-3153	-37%
Lezhë	Kurbini	Milot	8461	11 961	-3500	-29%
Lezhë	Kurbini	Mamurras	15 284	22 168	-6884	-31%
Lezhë	Kurbini	Laç	17 086	29 596	-12 510	-42%
Kurbini Total			46 291	72 338	-26 047	-42%
Lezhë	Lezhë	Ungrej	1587	3103	-1516	-49%
Lezhë	Lezhë	Blinisht	3361	5512	-2151	-39%
Lezhë	Lezhë	Dajç	3834	6895	-3061	-44%
Lezhë	Lezhë	Kallmet	4118	6883	-2765	-40%
Lezhë	Lezhë	Kolsh	4228	6649	-2421	-36%
Lezhë	Lezhë	Zejmen	5660	9090	-3430	-38%
Lezhë	Lezhë	Balldren i Ri	6142	10 392	-4250	-41%
Lezhë	Lezhë	Shëngjin	8091	11 551	-3460	-30%
Lezhë	Lezhë	Shënkoll	13 102	15 302	-2200	-14%
Lezhë	Lezhë	Lezhë	15 510	27 415	-11 905	-43%
Lezhë Total			65 633	102 792	-37 159	-43%
Lezhë	Mirditë	Selitë	745	2108	-1363	-65%
Lezhë	Mirditë	Kaçinar	1016	2102	-1086	-52%
Lezhë	Mirditë	Orosh	1899	3349	-1450	-43%
Lezhë	Mirditë	Kthellë	2209	3221	-1012	-31%
Lezhë	Mirditë	Fan	2977	4766	-1789	-38%
Lezhë	Mirditë	Rubik	4454	7991	-3537	-44%
Lezhë	Mirditë	Rrëshen	8803	14 114	-5311	-38%
Mirditë Total			22 103	37 651	-15 548	-38%
Totali			134 027	212 781	-78 754	-37%

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Lezhë përbën më pak se 6% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 6382 banorë/NJQV,, ose 20% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Rrethi i Mirditës ka mesataren më të ulët të popullsisë në qark. Njësitë më të vogla janë Selita, Kaçinari dhe Oroshi në Mirditë dhe Ungrej në Lezhë (më pak se 2000 banorë secila).

Tabela 35. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Lezhë sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


	Nr. i njësive	Min.	Maks.	Mesatare/ njësi	Shuma	% e popullsisë	Shqipëria
Shqipëria				8016	2 311 848	100%	
Lezhë				6382	134 027	5,8%	
0-2000	4	745	1899	1312	5247	3,9%	27,61%
2001-5000	7	2209	4454	3597	25 181	18,8%	34,58%
5001-10 000	6	5460	8803	7103	42 617	31,8%	26,27%
10 001 – 20 000	3	13 102	17 086	15 960	60 982	45,5%	6,70%
20 001-30 000							1,61%
30 001-50 000							1,07%
50 000-100 000							1,61%
100 000-200 000							0,27%
200 000+							0,27%

Burimi: INSTAT, Censur 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është çuditërisht më e lartë se kombëtarja: 250 banorë/km² përkundrejt 97,4 banorë/km² në rang vendi. Megjithatë, shumica e njësive kanë dendësi shumë të ulët: gjysma janë nën nivelin 87 banorë/km², ndërkohë që dendësia mesatare e komunave është 80 banorë/km². Zonat urbane kanë dendësi më të lartë, si qyteti i Lezhës (2864 banorë/km²) apo Laçit (750 banorë/km²), ndërkohë që qytete si Rrësheni dhe Rubiku kanë dendësi të ulët (55 dhe 37 banorë/km²).

Pesha e njësive të qarkut Lezhë në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 4,2% mesatarisht në vitet 2008 - 2012, me një rritje të lehtë në 2012 krahasuar me vitin paraardhës (4,2%, përfshirë edhe rritje të lehtë në vlerë absolute).

Figura 54. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Lezhë krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale në qarkun e Lezhës, mesatarisht pothuajse 66% në vitet 2008 - 2012, dhe 71% në vitin 2012. Ndër këto,

shpenzimet për personelin janë më shumë se gjysma e shpenzimeve operative gjithsej, ose mesatarisht 33% e shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Shpenzimet kapitale kanë një peshë specifike prej 34% në strukturën totale ose 29% në vitin 2012, me ulje në krahasim me vitet paraardhëse. Ky raport është i ngjashëm me raportet kombëtare prej 34% në 5 vite, por më i lartë për vitin e fundit (26% në vitin 2012 në nivel kombëtar). Bashkia e Lezhës që ka rreth 12% të popullsisë së qarkut zë një peshë prej rreth 20% në totalin e shpenzimeve të njëjësive të qarkut në vitin 2012. Njësi të tjera me buxhete më të mëdha në qark përfshijnë bashkinë Laç (12% në 2012), Mamurras dhe Shëngjin. Ndërkohë, pothuaj një e treta e të ardhurave të veta (29%) të qarkut të Lezhës gjenerohen në bashkinë Lezhë dhe 17% në Shëngjin.


Figura 55. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Lezhë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve edhe në qarkun e Lezhës, me rreth 63% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) mesatarisht me rreth 20%. Peshja e sektorit të shërbimeve publike është rritur ndjeshëm vitin e fundit, ndërkohë që sektori i transportit ka pasur tkurrje.


Figura 56. Shpenzimet sipas sektorëve (funsioneve) në NJQV-të e qarkut Lezhë



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Lezhë përbëjnë rreth 4,6% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Në vitin 2009 të ardhurat janë më shumë se dyfishuar në krahasim me vitin 2008, por kanë rënë gradualisht çdo vit në vitet 2010 - 2012 në vlerë absolute.


Figura 57. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Lezhë kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë më pak se 20% të totalit në qarkun e Lezhës, ndërkohë që në vitet 2009 - 2012 mbi 50% e të ardhurave vijnë nga transfertat e kushtëzuara. Në vitet 2010 - 2012 të ardhurat nga burimet e veta kanë pësuar rënie të vazhdueshme, me rënien më të fortë të regjistruar në vitin 2012 (20% më pak se një vit më parë). Transferta e pakushtëzuar ka pasur rritje të lehtë nga viti në vit, ndërkohë që transfertat e kushtëzuara kanë ruajtur vlera pothuaj të njëjta ndër vite.

Figura 58. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Lezhës



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

10.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Lezhë

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Lezhë, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- a. Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.

Njësia me buxhet (të ardhurat totale) më të madh është natyrisht bashkia e Lezhës (242 milionë në vitin 2012). Qyteti i Lezhës ka një peshë specifike prej 20% në buxhetin total të njësive të qarkut, ndërsa realizon rreth 29% të të ardhurave të veta totale. Bashkia e Laçit ka një peshë specifike prej 12% në buxhetin total të njësive të qarkut, ndërsa komuna Shëngjin 10%. Shpenzimet për personelin në këto njësi kanë peshë specifike të përafërt me atë të buxhetit total.

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 36. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me të mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor

Qark	Rreth	Njësi	2010	2011		2012						
			Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Biznesi I vogël	Taksa pasuri	Ndiki m infrastruktur e	Regjistrimi i automjeteve	Tarifë pastri mi	Transf. e pak	Transf. e kusht.
LE	Kurbin	Fushë-Kuqe	0,18	0,12	0,1	0,1	0,1	0,0	0,5	0,1	0,7	3,1
LE	Kurbin	Laç	0,49	0,50	0,4	0,4	0,3	0,1	1,1	0,6	1,1	0,9
LE	Kurbin	Mamurras	0,24	0,26	0,3	0,5	0,3	0,4	0,7	0,3	1,1	0,7
LE	Kurbin	Milot	0,24	0,26	0,2	0,1	0,2	0,0	0,7	0,2	0,8	1,0
LE	Lezhë	Ballëdren	0,18	0,34	0,6	0,1	0,3	3,3	0,4	0,0	0,7	0,6
LE	Lezhë	Blinisht	0,25	0,34	0,3	0,1	0,5	-	0,5	-	0,7	4,3
LE	Lezhë	Dajç	0,19	0,56	0,2	0,1	0,4	0,4	0,4	0,2	0,7	0,8
LE	Lezhë	Kallmet	0,19	0,38	0,5	0,1	0,5	0,2	0,4	0,1	0,7	0,7
LE	Lezhë	Kolsh	0,59	0,26	0,3	0,0	0,1	1,5	0,4	-	0,7	2,0
LE	Lezhë	Lezhë	1,39	1,60	1,2	1,2	0,5	1,7	1,0	1,0	0,9	0,3
LE	Lezhë	Shëngjin	1,84	2,91	1,6	0,6	0,9	8,3	0,7	0,4	0,6	0,6
LE	Lezhë	Shënkoll	0,39	0,47	0,3	0,4	0,3	0,8	0,6	0,0	0,7	0,5
LE	Lezhë	Ungrej	0,05	0,05	0,1	0,0	0,1	-	0,2	-	1,6	13,5
LE	Lezhë	Zejmen	0,47	0,37	0,3	0,2	0,4	0,5	0,5	0,1	0,7	0,8
LE	Mirditë	Fan	0,18	0,02	0,1	0,0	0,0	-	0,3	-	1,7	3,0
LE	Mirditë	Kaçinar	0,10	0,26	0,1	0,1	0,1	-	0,3	-	2,2	5,0
LE	Mirditë	Kthellë	0,10	0,14	0,0	0,0	0,0	-	0,1	-	1,5	1,7
LE	Mirditë	Orosh	0,46	0,46	1,0	0,7	0,0	-	0,8	0,1	1,8	1,2
LE	Mirditë	Rrëshen	0,75	0,51	0,6	0,7	0,1	1,5	0,7	0,2	1,7	1,0
LE	Mirditë	Rubik	0,58	0,24	0,4	0,2	0,0	0,4	0,5	0,2	1,8	0,5
LE	Mirditë	Selitë	0,15	0,00	0,0	-	0,2	-	0,1	-	2,0	3,7
Lezhë Mesatarja			43%	48%	41%	27%	26%	91%	51%	16%	117%	219%
Shqipëria			100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Siç shihet në tabelën e mësipërme, të ardhurat e veta për banor në qarkun e Lezhës luhaten në rreth 40% të mesatares kombëtare. Në të gjithë qarkun vetëm Lezha dhe Shëngjini kanë të ardhura të veta më të larta se mesatarja kombëtare për banor për të ardhurat e veta, madje Shëngjini ka të ardhura të veta për banor edhe më të larta se Lezha. Bashkitë e tjera të qarkut, si Laçi, Mamurrasi, Rubiku dhe Rrësheni kanë gjithashtu të ardhura të veta për frymë më të ulëta se gjysma e mesatares kombëtare. Mesatarja për frymë për të ardhurat e veta është tejet e ulët për shumicën dërrmuese të njësive në Lezhë, ndërkohë që mesatarja për frymë për të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe kushtëzuar janë paksa më të larta se ajo kombëtare në vitin 2012.

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 37. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve

Qarku	Rrethi	Njësia Fushë-Kuqe	2012			2011			2010		
			Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shpenzime personeli/frymë në % të mes. kombëtare	Investime/ frymë në % të mes. kombëtare	Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shpenzime personeli/frymë në % të mes. kombëtare	Shp./frymë në % të mes. kombëtare	Shpenzime personeli/frymë në % të mes. kombëtare		
LE	Kurbin	Kuqe	0,3	0,34	0,50	0,3	0,4	1,1	0,5		
LE	Kurbin	Laç	0,8	0,67	0,13	0,7	0,7	0,7	0,7		
LE	Kurbin	Mamurras	0,6	0,54	0,52	0,5	0,5	0,8	0,6		
LE	Kurbin	Milot	0,4	0,46	0,72	0,4	0,7	0,6	0,8		
LE	Lezhë	Ballëdren	0,6	0,65	1,01	1,0	0,6	0,5	0,5		
LE	Lezhë	Blinisht	0,6	0,61	0,67	0,4	0,5	1,1	0,6		
LE	Lezhë	Dajç	0,6	0,60	0,70	0,4	0,5	1,2	0,5		
LE	Lezhë	Kallmet	1,0	1,15	1,06	1,0	0,6	0,6	0,7		
LE	Lezhë	Kolsh	0,4	0,50	0,55	0,4	0,5	0,9	0,9		
LE	Lezhë	Lezhë	1,4	1,29	1,58	1,3	1,1	1,1	1,1		
LE	Lezhë	Shëngjin	1,7	1,92	1,48	1,5	1,5	1,2	1,1		
LE	Lezhë	Shënkoll	0,4	0,52	0,56	0,5	0,4	0,5	0,4		
LE	Lezhë	Ungrej	0,5	0,79	-	0,6	0,8	0,6	1,0		
LE	Lezhë	Zejmen	0,7	0,69	1,21	0,8	0,6	0,5	0,7		
LE	Mirditë	Fan	0,6	0,62	1,03	0,5	0,9	0,8	1,0		
LE	Mirditë	Kaçinar	0,9	0,99	1,16	0,8	1,2	1,4	1,1		
LE	Mirditë	Kthellë	0,8	1,17	-	0,5	0,8	0,9	1,0		
LE	Mirditë	Orosh	1,1	1,53	1,49	1,1	1,3	0,9	1,2		
LE	Mirditë	Rrëshen	1,8	1,24	3,24	1,4	1,3	0,9	1,4		
LE	Mirditë	Rubik	1,3	1,36	1,92	1,3	1,4	1,0	1,5		
LE	Mirditë	Selitë	1,0	1,40	-	0,8	1,0	0,7	0,9		
Lezhë Min.			0,3	0,3	-	0,3	0,4	0,5	0,4		
Lezhë Maks.			1,8	1,9	3,2	1,5	1,5	1,4	1,5		
Lezhë Mesatarja			0,8	0,9	0,9	0,8	0,8	0,9	0,9		

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve


Krahasimi i shpenzimeve për frymë na jep disa indikacione të rëndësishme: mesatarisht njësitë e qarkut Lezhë kanë shpenzuar rreth 20% më pak se mesatarja kombëtare për banor.

Shpenzimet për personelin janë 10% më të ulëta se mesatarja kombëtare ndërkohë që në njësi të veçanta shpenzimet për personelin për frymë janë 20-30% mbi mesataren kombëtare në vitin 2012. Është interesante të vërehet se në mënyrë tipike njësitë që kanë më shumë shpenzime administrative janë ato që gjenerojnë më pak të ardhura nga burimet e veta, por që kanë një shkallë të lartë varësie nga transfertat e pakushtëzuar.

10.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Lezhë

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë NJQV-të e qarkut Lezhë.

Figura 59. Të ardhurat për banor përkundrejt popullsisë dhe shpenzimeve për personelin në NJQV-të e qarkut Lezhë 2011



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në NJQV-të e qarkut Lezhë ulet nga 1600 lekë (11 Euro) në vitin 2010, në rreth 1290 lekë (9,2 Euro) për frymë në vitin 2012. Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në nivel kombëtar është përkatësisht 27 Euro dhe 25,4 Euro në 2010 dhe 2012. Të ardhurat totale për frymë në Lezhë gjithashtu ulen nga 77 Euro në vitin 2010 në 68 Euro në vitin 2012. Siç është përmendur edhe më lart, njësitë me të ardhura të veta më të larta janë Lezha dhe Shëngjini, të cilat së bashku gjenerojnë rreth 46% të të ardhurave të veta gjithsej për qarkun dhe që kanë të ardhura të veta për frymë më të larta se mesatarja kombëtare. Ndërkohë bashkia Laç, e cila ka popullsinë më të madhe në qark (14% të popullsisë), gjeneron më pak se 10% të të ardhurave të veta gjithsej për qarkun.

Grafiku 58 tregon të ardhurat për frymë nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar, si edhe shpenzimet për paga e sigurime për frymë në vitin 2011. Siç shihet, në përgjithësi njësitë me popullsi më të madhe gjenerojnë të ardhura të veta më të larta për banor, ndërkohë që transfertat e pakushtëzuar ndjek drejtimin e kundërt. Ndërkohë, sjellja e treguesit të shpenzimeve për personelin (për banor gjithashtu) përgjithësisht ka lidhje inverse me të ardhurat e veta për frymë dhe popullsinë totale.

Po të shikojmë klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të njërive për qarkun Lezhë vërehet se shpenzimet totale për frymë rriten në vitin 2012, pas një uljeje të konsiderueshme në 2011. Ndërkohë, mesatarja e shpenzimeve për personelin rritet lehtësisht çdo vit. Mesatarja e investimeve kapitale pëson luhatje gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, duhet përmendur se


ecuria e investimeve kapitale duhet vrojtuar përgjatë një periudhe relativisht të gjatë, ndaj treguesit vjetorë janë më pak domethënës në këtë rast.

Siç shikohet në tabelën 48, disa prej njësive që kanë shpenzime administrative shumë të larta në 2012-ën nuk kanë kryer asnjë investim. Gjithashtu, investimet për frymë tentojnë të jenë më të larta në zonat me popullsi më të vogël se në ato me popullsi më të madhe. Duke vrojtuar strukturën e buxheteve vendore mund të arrihen në përfundimin se shumica e investimeve në njësitë më të vogla financohen me anë të granteve të kushtëzuara dhe ose konkurruese.

Tabela 38. Shpenzimet për frymë 2010 – 2012

Qar ku	Rrethi	Njësia	2010			2011			2012		
			Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë	Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	inv/ capita	Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë
LE	Kurbin	Fushë- Kuçe	8035	1126	6031	1974	1045	348	1859	813	813
LE	Kurbin	Laç	4768	1739	425	4088	1588	405	4805	1602	204
LE	Kurbin	Mamurr as	5743	1368	2495	3158	1263	361	3589	1285	842
LE	Kurbin	Milot	4260	2036	1187	2508	1588	251	2683	1090	1174
LE	Lezhë	Balldren	3707	1155	1734	6351	1347	4426	3694	1555	1652
LE	Lezhë	Blinisht	7992	1397	5625	2540	1089	-	3824	1457	1092
LE	Lezhë	Dajç	8698	1295	6172	2466	1160	580	3884	1438	1151
LE	Lezhë	Kallmet	4053	1590	1709	6102	1453	4359	6338	2737	1729
LE	Lezhë	Kolsh	6336	2133	2895	2557	1203	602	2551	1200	900
LE	Lezhë	Lezhë	8304	2711	2549	8098	2626	1933	8685	3087	2584
LE	Lezhë	Shëngjin	8735	2748	3601	9350	3463	3549	10 801	4580	2419
LE	Lezhë	Shënkoll	3961	1071	767	3202	1046	65	2868	1239	913
LE	Lezhë	Ungrej	4663	2417	903	3545	1934	322	3461	1888	0
LE	Lezhë	Zejmen	3830	1643	901	5281	1320	3080	4276	1645	1974
LE	Mirditë	Fan	5849	2383	1440	3357	2098	210	3784	1472	1682
LE	Mirditë	Kaçinar	10 287	2783	4209	5233	2854	951	5690	2371	1897
LE	Mirditë	Kthellë	6348	2367	2643	3105	1863	621	4986	2805	0
LE	Mirditë	Orosh	6309	2981	1364	6569	2986	2389	7306	3653	2435
LE	Mirditë	Rrëshen	6804	3517	716	8502	2976	3401	11 648	2965	5295
LE	Mirditë	Rubik	7323	3765	1546	8134	3254	3504	8017	3257	3132
LE	Mirditë	Selitë	4920	2270	553	4744	2372	949	6667	3333	0
Minimum			3707	1071	425	1974	1045	0	1859	813	0
Maksimum			10 287	3765	6172	9350	3463	4426	11 648	4580	5295
Mesatare			6235	2119	2355	4803	1930	1538	5306	2165	1518
Mesatarja			5160	1897	1303	3862	1736	916	3730	1819	933
Koeficienti i variacionit			0,3	0,4	0,8	0,5	0,4	1,0	0,5	0,5	0,8


Figura 60. Shpenzimet për frymë, operative dhe kapitale 2011 në qarkun Lezhë



Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative janë të larta në njësitë e qarkut Lezhë, ashtu si edhe në përgjithësi në nivel vendi. Në veçanti, shpenzimet për paga e sigurime zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale për çdo njësi, duke variuar nga 35% (Laç) deri në 78% (Fushë-Kuqe) në vitin 2012. Peshat relative të zërit të pagave në shpenzimet e përgjithshme operative është rritur nga viti 2010 (55%) në mesatarisht 60% në 2011 dhe 2012 në të gjitha njësitë.

Figura 61. Peshat relative të shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve operative për njësi 2010 - 2012




10.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Lezhë

Qeverisja vendore luan një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë seksion do të hedhim një vështrim mbi të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për qarkun e Lezhës, të dhënat mbi forcën e punës dhe punësimin (për sa të dhënat janë të disponueshme), si dhe sipërmarrjen dhe zhvillimin e bizneseve, të cilat analizohen si nga pikëpamja e përqendrimit në çdo qark, ashtu edhe nga pikëpamja e të ardhurave që gjenerojnë në nivel kombëtar si dhe për çdo njësi.

a. Prodhimi i brendshëm bruto.

Pesha specifike e rajonit të Lezhës ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është ndër më të voglat ndër gjithë rajonet me 3,65%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është 2496 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Censur-it 2011, ose 24% më e ulët se mesatarja kombëtare. PBB për frymë në rajonin e Lezhës është e dyta më e ulëta në nivel kombëtar pas Dibrës.

Figura 62. Struktura e PBB-së sipas qarqeve 2011




Burimi: INSTAT

Tabela 39. PBB totale dhe PBB për frymë sipas qarqeve

Qarku	PBB, çmime korrente (mln lekë)	Pesha specifike	PBB për frymë në lekë	PBB për frymë Euro	PBB për frymë si % e kombëtares
Shqipëria	2 800 138	100%	457 926	3271	100,0%
Dibër	137 047	3,1%	291 528	2082	63,7%
Durrës	262 785	9,4%	458 656	3276	100,2%
Kukës	85 292	2,4%	367 221	2623	80,2%
Lezhë	134 027	3,6%	349 385	2496	76,3%
Shkodër	215 347	6,0%	361 626	2583	79,0%
Elbasan	295 827	9,2%	400 484	2861	87,5%
Tiranë	749 365	36,3%	621 460	4439	135,7%
Berat	141 944	4,8%	431 071	3079	94,1%
Fier	310 331	9,9%	405 412	2896	88,5%
Gjirokastrë	72 176	2,7%	473 537	3382	103,4%
Korçë	220 357	6,2%	364 077	2601	79,5%
Vlorë	175 640	6,3%	456 462	3260	99,7%


Figura 63. PBB për frymë si përqindje e PBB-së për frymë në nivel kombëtar



Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Lezhës, vërejmë se sektori i tregtisë dhe shërbimeve ka peshën më të lartë në PBB rajonale me 26%, i ndjekur nga bujqësia (25%). Sektori financiar dhe pasuritë e paluajtshme kanë gjithashtu një peshë specifike të konsiderueshme në strukturën rajonale të PBB-së me 19%.

Figura 64. Struktura e PBB-së sipas sektorëve për qark



b. Sipërmarrja dhe bizneset.

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Lezhë janë të regjistruara 4440 biznese, ndër të cilat 91 ose pak mbi 3% janë biznese të mëdha dhe rreth 7% janë biznese të mesme. Pothuajse 30% e numrit të përgjithshëm të bizneseve (si dhe e bizneseve të mëdha) operojnë në qytetin e Lezhës, rreth 7% në Shëngjin dhe 22% në Laç.

Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) janë mesatarisht 141 dhe 215 lekë për frymë në vitin 2012 dhe 2011, me ulje të konsiderueshme nga vitet 2008 dhe 2009 (përkatësisht 247 dhe 282 lekë). Këto vlera janë ndjeshëm më të ulëta se mesatarja kombëtare prej 532 dhe 621 lekësh për frymë përkatësisht në 2012 dhe 2011. Disa njësi kanë reshtur së mbledhuri të ardhura nga kjo taksë vitet e fundit, nuk mbledhin asnjë qindarkë nga kjo taksë prej vitesh, ndërkohë që edhe në bashkinë Lezhë, që është e vetmja që merr të ardhura për frymë nga taksa e biznesit të vogël të krahasueshme me mesataren kombëtare, kemi një rënie prej pothuaj 40%. Shumica e njësive kanë rënie mbi 60% nga kjo taksë në vitin 2012.

c. Të ardhurat nga taksat e biznesit për banorë (ish-taksa e biznesit të vogël, ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 40. Të ardhurat për frymë nga taksa e biznesit të vogël

			2008	2009	2010	2011	2012
LE	Kurbin	Fushë-Kuqe	122	86	95	99	70
LE	Kurbin	Laç	464	411	360	404	205
LE	Kurbin	Mamurras	257	189	192	99	246
LE	Kurbin	Milot	184	52	68	143	40
LE	Lezhë	Ball dren	98	127	57	110	38
LE	Lezhë	Blinisht	136	106	93	73	43
LE	Lezhë	Dajç	118	77	112	156	42
LE	Lezhë	Kallmet	109	75	72	85	35
LE	Lezhë	Kolsh	97	156	65	148	21
LE	Lezhë	Lezhë	911	811	834	1046	653
LE	Lezhë	Shëngjin	328	334	163	612	329
LE	Lezhë	Shënkoll	84	64	106	210	191
LE	Lezhë	Ungrej	32	12	21	52	6
LE	Lezhë	Zejmen	99	106	115	90	107
LE	Mirditë	Fan	81	107	60	20	21
LE	Mirditë	Kaçinar	142	37	30	43	38
LE	Mirditë	Kthellë	4	26	3	4	8
LE	Mirditë	Orosh	1088	1400	238	289	391
LE	Mirditë	Rrëshen	509	514	411	558	389
LE	Mirditë	Rubik	384	474	272	282	95
LE	Mirditë	Selitë	671	20	43	0	0
Mesatare			282	247	162	215	141
Min.			4	12	3	-	-
Maks.			1088	1400	834	1046	653
Mesatarja Koefficienti i variacionit			136	106	95	110	43
			1,05	1,36	1,16	1,18	1,22

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

d. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (toka bujqësore dhe ndërtesat).

Tabela 41. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Lezhë, krahasuar me mesataren kombëtare për banor

			2008	2009	2010	2011	2012
LE	Kurbin	Fushë-Kuqe	0,01	0,02	0,01	0,05	0,1
LE	Kurbin	Laç	0,30	0,28	0,24	0,29	0,3
LE	Kurbin	Mamurras	0,12	0,12	0,13	0,14	0,3
LE	Kurbin	Milot	0,20	0,25	0,24	0,12	0,2
LE	Lezhë	Ballëdren	0,32	0,27	0,12	0,15	0,3
LE	Lezhë	Blinisht	-	-	0,00	0,84	0,5
LE	Lezhë	Dajç	0,49	0,04	0,04	0,23	0,4
LE	Lezhë	Kallmet	0,27	0,34	0,33	0,37	0,5
LE	Lezhë	Kolsh	0,08	0,15	0,47	0,17	0,1
LE	Lezhë	Lezhë	0,55	0,60	0,52	0,52	0,5
LE	Lezhë	Shëngjin	0,64	0,71	2,44	0,90	0,9
LE	Lezhë	Shënkoll	0,66	0,53	0,48	0,28	0,3
LE	Lezhë	Ungrej	0,18	0,08	0,33	0,23	0,1
LE	Lezhë	Zejmen	0,39	0,38	0,42	0,46	0,4
LE	Mirditë	Fan	0,06	-	0,08	0,00	0,0
LE	Mirditë	Kaçinar	0,05	0,07	0,09	0,16	0,1
LE	Mirditë	Kthellë	0,07	0,03	0,01	0,07	0,0
LE	Mirditë	Orosh	0,11	0,02	0,04	0,04	0,0
LE	Mirditë	Rrëshen	0,24	0,13	0,14	0,10	0,1
LE	Mirditë	Rubik	0,00	1,25	0,01	0,03	0,0
LE	Mirditë	Selitë	0,04	-	-	0,00	0,2
	Mesatare		0,2	0,3	0,3	0,2	0,3
	Min.		-	-	-	-	-
	Maks.		0,7	1,3	2,4	0,9	0,9
	Mesatarja		0,2	0,1	0,1	0,2	0,2
	Koeficienti						
	i variacionit		0,9	1,2	1,8	1,0	0,9

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Performanca e NJQV-ve të Lezhës në lidhje me taksat e pasurisë është mjaft e dobët, mesatarisht 26% e të ardhurave mesatare për frymë në nivel kombëtar në vitin 2012. Kujtojmë se niveli i mbledhjes së kësaj takse është shumë i ulët në të gjithë vendin. Në veçanti, ka mjaft njësi të cilat nuk mbledhin asnjë qindarkë nga kjo taksë. Shëngjini është i vetmi që mbledh të ardhura nga taksat e pasurisë në nivelin 90% të mesatares kombëtare, ndërsa ka njësi që nuk e mbledhin fare taksën. Lezha mbledh të ardhura në nivelin 50% të mesatares kombëtare.

10.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Lezhës ka 21 njësi administrative. Popullsia është 132 936 banorë.
- Qarku i Lezhës gjithashtu ka pësuar rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-16,5%). Për t'u shënuar është një kontrast i theksuar për sa i përket zonave urbane dhe rurale. Zonat urbane kanë pësuar rritje populsi me 56% ndërsa ruralet një rënie të ndjeshme (-49%). Dendësia gjithashtu ka rënë (-16,5%).
- Qarku i Lezhës numëron 32 236 familje.
- Popullsia rinore (15 - 29 vjeç) përbën 25,5%, mosha e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 11,4%.
- Popullsia në moshë pune 15 - 64 vjeç përbën 67,2% (89 346 persona).
- Personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë rreth 5,3% të popullsisë (7161 banorë).
- Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë është e barabartë mes meshkujve dhe femrave.
- Popullsia në moshë pune përbën 66,7% të totalit të popullsisë (89 346 banorë).
- Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Lezhës janë 15 371 persona të regjistruar si të papunë, nga këta 1077 përfitojnë pagesë papunësie.
- Popullsia emigruese që është kthyer në qarkun e Lezhës është 6837 persona, ku 73,1% e të gjithë të kthyerve janë meshkuj.

Strehimi

- 32 236 familje, 28 715 në pronësi ose në proces pronësimi, 1721 me qera, 1800 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Lezhës ka mesatarisht 3,16 dhoma – treguesi më i lartë në Shqipëri.
- 1431 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 5749 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 31 589 banesa të banuara) ose rreth 22% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm – një nga treguesit më të lartë në vend.
- Rreth 3306 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 31 589 banesa të banuara) ose 10,4%.
- Koeficienti GINI për qarkun e Lezhës, është 27,2%.

- Konsumi total për familje është 47 584 lekë krahasuar me konsumin për person që është 10 923 lekë.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Lezhës shënon një nivel varfërie prej 17,5%. Thellësia e varfërisë është 4,3% dhe ashpërsia 1,7%. Tregues të lartë varfërie krahasuar me vlerat kombëtare.
- Nga ana tjetër, 8060 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Lezhës ose rreth 8,2% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 25% të totalit të familjeve.

Shëndetësia

- 7161 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 7,3%.
- 3 spitale me 319 shtretër, si dhe 92 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Lezhës kemi një numër total mjekësh prej 155.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 23 minuta, ndërsa në zonat rurale 19 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 21minuta për jo të varfrit dhe 20 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 4150 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 3,12%

Shërbimet

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	4
Shërbime sociale për fëmijët	3	10
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	3
Shërbime sociale për PAK	0	6
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	1
Gjithsej	4	25

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF


11 Qarku Shkodër

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Shkodrës. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasimore mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

11.1 Profili i qarkut Shkodër dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Shkodrës përbëhet nga 33 NJQV në tre rrethe: rrethi i Malësisë së Madhe (6 njësi, qendër Koplik), rrethi i Pukës (10 njësi, qendër Pukë) dhe rrethi i Shkodrës (17 njësi, qendër Shkodër). Popullsia e qarkut të Shkodrës është 215 347 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 77% (166 050 banorë) jetojnë në rrethin e Shkodrës dhe 36% në qytetin e Shkodrës. Dy njësitë e tjera më të mëdha pas bashkisë së Shkodrës janë komunat Rrethinat (21 mijë banorë) dhe Bushat (14 mijë banorë). Dy bashkitë e tjera qendër rrethi – Koplik dhe Pukë kanë popullsi mjaft të vogël (më pak se 4000 banorë), ndërkohë që bashkia e dytë më e madhe e zonës është Vau i Dejës, me pak mbi 8 mijë banorë.

Figura 52. NJQV-të në qarkun e Shkodrës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Qarku i Shkodrës ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 35% ose mbi 118 000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012 në qarkun e Shkodrës ishin të regjistruar 333 355 banorë, me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011.

Tabela 42. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Shkodër

Qarku	Rrethi	Njësia	Census 2011	Regjistri civil 2011	Ndryshimi i popullsisë	Ndryshimi në %
Shkodër	Malësi e madhe	Gruemirë	8890	12 478	-3588	-29%
Shkodër	Malësi e madhe	Kastrat	6883	11 961	-5078	-42%
Shkodër	Malësi e madhe	Kelmend	3056	6306	-3250	-52%
Shkodër	Malësi e madhe	Koplik	3734	11 087	-7353	-66%
Shkodër	Malësi e madhe	Qendër	4740	5925	-1185	-20%
Shkodër	Malësi e madhe	Shkrelë	3520	5893	-2373	-40%
Malësi e Madhe gjithsej			30 823	53 650	-22 827	-43%
Shkodër	Pukë	Blerim	913	1920	-1007	-52%
Shkodër	Pukë	Fierzë	1302	2252	-950	-42%
Shkodër	Pukë	Fushë-Arrëz	2513	4945	-2432	-49%
Shkodër	Pukë	Gjegjan	2846	4484	-1638	-37%
Shkodër	Pukë	Iballë	1129	2275	-1146	-50%
Shkodër	Pukë	Pukë	3607	5046	-1439	-29%
Shkodër	Pukë	Qafë-Mali	1548	1721	-173	-10%
Shkodër	Pukë	Qelëz	1761	2541	-780	-31%
Shkodër	Pukë	Qerret	1498	3230	-1732	-54%
Shkodër	Pukë	Rrapë	1357	2412	-1055	-44%
Pukë gjithsej			18 474	30 826	-12 352	-40%
Shkodër	Shkodër	Ana e Malit	3858	5841	-1983	-34%
Shkodër	Shkodër	Bërdicë	5773	8995	-3222	-36%
Shkodër	Shkodër	Bushat	14 149	23 128	-8979	-39%
Shkodër	Shkodër	Dajç (Bregbunë)	3885	8737	-4852	-56%
Shkodër	Shkodër	Gur i Zi	8085	11 226	-3141	-28%
Shkodër	Shkodër	Hajmel	4430	6408	-1978	-31%
Shkodër	Shkodër	Postribë	7069	11 334	-4265	-38%
Shkodër	Shkodër	Pult	1529	3080	-1551	-50%
Shkodër	Shkodër	Rrethinat	21 199	22 682	-1483	-7%
Shkodër	Shkodër	Shalë	1804	4145	-2341	-56%
Shkodër	Shkodër	Shkodër	77 075	113 719	-36 644	-32%
Shkodër	Shkodër	Shllak	671	1713	-1042	-61%
Shkodër	Shkodër	Shosh	304	1615	-1311	-81%
Shkodër	Shkodër	Temal	1562	2308	-746	-32%
Shkodër	Shkodër	Vau i Dejës	8117	12 509	-4392	-35%
Shkodër	Shkodër	Velipojë	5031	8825	-3794	-43%
Shkodër	Shkodër	Vig-Mnelë	1509	2614	-1105	-42%
Shkodër gjithsej			166 050	248 879	-82 829	-33%
Qarku Shkodër gjithsej			215 347	333 355	-118 008	-35%

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Shkodër përbën rreth 32,4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 25 840 banorë/NJQV ose tre herë më e lartë se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Kjo mesatare rritet ndjeshëm për shkak të përqendrimit të madh të popullsisë

në qendrat urbane dhe periferike në rrethin e Shkodrës, ku madhësia mesatare e njësisë është pothuaj 15 mijë banorë pa llogaritur qytetin e Shkodrës. Njësitë e rrethit të Pukës janë më të vogla, me një mesatare prej 6224 banorësh ose 22% më të vogël se mesatarja kombëtare.

Tabela 43. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Shkodër sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


	<i>Nr. i njësive</i>	<i>Min.</i>	<i>Maks.</i>	<i>Mesatare/ njësi</i>	<i>Shuma</i>	<i>% e popullsisë</i>	<i>Shqipëria</i>
Shqipëria				8016		100%	
Shkodër				6256	215 347	9,3%	
0-2000	13	304	1804	1299	16 887	7,8%	27,61%
2001-5000	10	2513	4740	3619	36 189	16,8%	34,58%
5001-10 000	7	5031	8890	7121	49 848	23,1%	26,27%
10 001-20 000	1	14 149	14 149	14 149	14 149	6,6%	6,70%
20 001-30 000	1	21 199	21 199	21 199	21 199	9,8%	1,61%
30 001-50 000						0,0%	1,07%
50 000-100 000	1	77 075	77 075	77 075	77 075	35,8%	1,61%
100 000-200 000						0,0%	0,27%
200 000+							0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 147 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Dendësinë më të madhe e ka natyrisht Shkodra, me mbi 2400 banorë për km²; por dendësi të lartë kanë edhe qendra, si Rrethinat (487 banorë/km²) dhe Kopliku (285 banorë/km²). Megjithatë, gjysma e njësive të qarkut kanë dendësi më të ulët se 47 banorë/km².

Pesha e njësive të qarkut Shkodër në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 6,5% mesatarisht në pesë vitet 2008 - 2012.


Figura 65. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Shkodër krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative zënë rreth 61% të shpenzimeve totale në qarkun e Shkodrës në vitet 2008 - 2012, por pesha specifike e tyre është rritur në 70% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë në nivelin e 30% të shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Në nivel kombëtar, shpenzimet për personel në qarkun e Shkodrës zënë rreth 7% të shpenzimeve për paga dhe sigurime ose 2% të shpenzimeve gjithsej. Vetëm bashkia e Shkodrës zë një peshë prej 46% në shpenzimet totale vendore të njësive të nivelit të parë në vitin 2011 dhe 39% të shpenzimeve kapitale; ndërsa në vitin 2012 përkatësisht 41% dhe 27%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 36% në strukturën totale (25% në 2012). Ky raport është më i lartë se mesatarja kombëtare prej 34% në 5 vite, por disi më i ulët se mesatarja kombëtare 26% në vitin 2012. Mbas Shkodrës, njësitë me buxhete më të mëdha janë Bushati, Rrethinat, Velipoja, të cilat së bashku përbëjnë rreth 56% të shpenzimeve vendore; 50% të buxhetit për pagat dhe për investime (viti 2012).


Figura 66. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Shkodër



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve, me rreth 52% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) me rreth 28% mesatarisht.


Figura 67. Shpenzimet sipas sektorëve (funksioneve) në NJQV-të e qarkut Shkodër



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Shkodër kanë pësuar një ulje drastike në 1,9% të totalit të njësive vendore në Shqipëri, nga 8,4% në vitin 2008. Nga viti 2008 të ardhurat e njësive të qarkut Shkodër kanë pasur rënie të vazhdueshme.


Figura 68. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Shkodër kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Edhe të ardhurat nga burimet e veta kanë rënie të vazhdueshme në njësitë e qarkut Shkodër, si në vlerë absolute, ashtu edhe si peshë specifike në strukturën totale të të ardhurave (56% në vitet 2008-2011 dhe 67% në 2012), ndërkohë që transferta e pakushtëzuar është ulur lehtë në vlerë. Transferrat e kushtëzuara kanë ruajtur pak a shumë vlerën (ritje në vitet 2010-2011 dhe më tej ulje e lehtë), por kanë rënie në peshë specifike.

Figura 69. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Shkodrës



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

11.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Shkodër

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Shkodër, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- a. Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.

Njësitë me buxhete (të ardhurat totale) më të mëdha janë natyrisht bashkia e Shkodrës (783 milionë në vitin 2012). Asnjë njësi tjetër në qark nuk ka buxhet të krahasueshëm me Shkodrën; buxheti i dytë më i madh është i komunës Velipojë dhe Bushat. Vetëm Shkodra zë rreth 51% të të ardhurave nga burimet e veta për gjithë qarkun, ndërsa së bashku me njësitë e tjera të përmendura përbëjnë rreth 71% të buxhetit nga të ardhurat e veta për qarkun.

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Siç shihet në tabelën 54, të ardhurat e veta për banor në qarkun e Shkodrës janë më shumë se 75% më të ulëta se mesatarja kombëtare. Kjo është një situatë pothuajse uniforme. Vetëm komuna e Velipojës në të gjithë qarkun arrin të gjenerojë të ardhura më të larta se mesatarja kombëtare. Ndërkohë, edhe Shkodra, pavarësisht se është bashkia më e madhe në qark dhe një nga tetë bashkitë më të mëdha në vend, bie pothuajse 20% nën nivelin mesatar kombëtar për të ardhura për frymë në vitin 2012, pas luhatjes rreth vlerave mesatare në dy vitet pasardhëse. E njëjta situatë raportohet për Pukën, si qendër e rrethit të Pukës, që ka rënie shumë të ndjeshme të të ardhurave për frymë vitet e fundit. E njëjta situatë raportohet edhe për njësi si Bushati (një nga njësitë më të mëdha të qarkut) dhe Fushë-Arrëzi, të cilat kanë pasur ulje drastike në të ardhurat, pas niveleve të përafërta me mesataren kombëtare deri në vitin 2010.

Tabela 44. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me të mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor

			2010	2011	Të ardhurat e veta	Biznesi l vogël	Taksa pasuri	2012				
			Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta				Të ardhurat e veta	Ndikim infrastruktura	Regjistrimi i automjeteve	Tarifë pastrimi	Transf. e pak
SH	Malësi e madhe	Gruemirë	0,07	0,04	0,07	0,15	0,12	-	0,21	0,01	0,90	0,07
SH	Malësi e madhe	Kastrat	0,15	0,21	0,22	0,06	0,44	-	0,20	0,19	0,76	0,22
SH	Malësi e madhe	Kelmend	0,04	0,01	0,23	0,01	0,11	-	0,09	0,10	1,57	0,23
SH	Malësi e madhe	Koplik	0,68	0,26	0,42	0,31	0,26	0,02	0,56	0,89	1,07	0,42
SH	Malësi e madhe	Qendër	0,05	0,12	0,12	0,08	0,12	-	0,19	0,04	1,03	0,12
SH	Malësi e madhe	Shkrelë	0,26	0,14	0,71	0,04	0,14	-	0,18	0,01	1,45	0,71
SH	Pukë	Blerim	0,23	0,11	0,02	0,03	0,05	-	0,04	-	2,93	0,02
SH	Pukë	Fierzë	0,51	0,58	0,08	-	-	0,60	0,03	-	2,31	0,08
SH	Pukë	Fushë-Arrëz	0,95	0,63	0,65	0,49	1,79	0,51	0,18	0,40	1,68	0,65
SH	Pukë	Gjegjan	0,27	0,19	0,16	0,12	0,18	0,01	0,07	-	1,75	0,16
SH	Pukë	Iballë	0,14	0,01	0,05	-	0,12	-	0,02	-	2,84	0,05
SH	Pukë	Pukë	1,03	1,10	0,63	0,85	0,46	0,21	0,99	0,86	2,39	0,63
SH	Pukë	Qafë-Mali	0,34	0,24	0,45	0,04	0,32	-	0,05	0,07	2,40	0,45
SH	Pukë	Qelëz	0,02	0,02	0,07	0,02	0,35	-	0,13	-	1,73	0,07
SH	Pukë	Qerret	0,39	0,08	0,30	0,04	0,73	-	0,06	-	2,19	0,30
SH	Pukë	Rrapë	0,17	0,03	0,02	-	0,11	-	0,05	-	2,74	0,02
SH	Shkodër	Ana e Malit	0,20	0,17	0,25	0,14	0,04	-	0,69	0,13	0,73	0,25
SH	Shkodër	Bërdicë	0,41	0,37	0,30	0,14	0,29	0,34	1,14	0,30	0,70	0,30
SH	Shkodër	Bushat (neë)	0,97	0,67	0,68	0,14	0,81	1,20	1,15	1,04	0,67	0,68
SH	Shkodër	Dajç										
SH	Shkodër	Bregbunë)	0,92	0,27	0,29	0,06	1,01	-	0,67	0,52	0,72	0,29
SH	Shkodër	Gur i Zi	0,17	0,59	0,17	0,08	0,11	-	1,23	0,11	0,74	0,17
SH	Shkodër	Hajmel	0,09	0,13	0,16	0,11	0,15	-	0,63	0,08	0,74	0,16
SH	Shkodër	Postribë	0,19	0,13	0,13	-	0,13	-	0,65	0,14	1,09	0,13
SH	Shkodër	Pult	0,10	0,21	0,08	-	-	-	0,93	-	1,73	0,08
SH	Shkodër	Rrethinat	0,26	0,20	0,22	0,11	0,30	0,03	1,16	0,15	0,70	0,22
SH	Shkodër	Shalë	0,03	0,01	0,19	-	0,10	-	0,21	0,11	1,62	0,19
SH	Shkodër	Shkodër	1,06	0,98	0,79	0,72	0,60	0,25	1,92	1,15	1,15	0,79
SH	Shkodër	Shllak	0,14	0,03	0,40	-	-	-	4,14	-	2,23	0,40
SH	Shkodër	Shosh	0,00	0,00	0,13	-	-	-	0,85	-	2,25	0,13
SH	Shkodër	Temal	0,34	0,58	0,60	-	0,69	-	0,45	0,25	1,73	0,60
SH	Shkodër	Vau i Dejës	0,54	0,62	0,47	0,19	0,41	0,18	0,98	0,69	1,09	0,47
SH	Shkodër	Velipojë	0,93	2,59	2,14	2,18	3,11	0,14	1,01	0,86	0,67	2,14
SH	Shkodër	Vig-Mnelë	0,40	0,11	0,19	0,02	0,23	-	0,53	0,05	1,65	0,19
Shkodër Mesatarja			0,37	0,35	0,34	0,19	0,4	0,11	0,65	0,25	1,51	2,02
Shqipëria			100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 45. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve

Qar ku	Rrethi	Njësia	2010		2011		2012		Investime / frymë në % të mes. kombëtar e
			Shp./frym ë në % të mes. kombëtar e	Shp. personeli/ frymë në % të mes. kombëtar e	Shp./frym ë në % të mes. kombëtar e	Shp. personeli/ frymë në % të mes. kombëtar e	Shp./frym ë në % të mes. kombëtar e	Shpenzim e personeli/ frymë në % të mes. kombëtar e	
SH	Malësi e madhe	Gruemirë	0,66	0,41	0,62	0,37	0,7	0,50	1,02
SH	Malësi e madhe	Kastrat	0,68	0,57	0,36	0,53	0,4	0,45	0,77
SH	Malësi e madhe	Kelmend	0,58	0,84	0,51	0,74	0,8	0,87	0,88
SH	Malësi e madhe	Koplik	1,31	0,74	0,39	0,57	0,8	0,88	0,73
SH	Malësi e madhe	Qendër	0,65	0,63	0,35	0,50	0,5	0,64	0,31
SH	Malësi e madhe	Shkrelë	1,39	0,77	0,49	0,72	0,7	0,64	1,45
SH	Pukë	Blerim	2,76	1,53	0,58	1,10	1,2	1,32	0,77
SH	Pukë	Fierzë	2,57	2,68	0,85	1,13	1,1	1,23	1,19
SH	Pukë	Fushë-Arrëz	1,41	1,94	1,04	1,37	1,6	2,71	1,09
SH	Pukë	Gjegjan	1,16	1,44	0,93	1,04	1,3	1,43	1,81
SH	Pukë	Iballë	1,73	1,66	0,91	1,31	0,9	1,15	0,84
SH	Pukë	Pukë	1,48	2,57	1,36	2,44	1,2	2,25	0,34
SH	Pukë	Qafë-Mali	2,20	1,65	1,21	1,97	0,9	0,54	1,84
SH	Pukë	Qelëz	0,71	1,28	0,57	1,00	0,9	0,67	1,47
SH	Pukë	Qerret	1,88	1,14	0,69	0,92	1,2	1,18	1,73
SH	Pukë	Rrapë	1,25	0,96	2,26	0,70	3,0	1,84	-
SH	Shkodër	Ana e Malit	0,52	0,59	0,38	0,58	0,4	0,29	0,63
SH	Shkodër	Bërdicë	0,46	0,46	0,48	0,57	0,4	0,37	0,74
SH	Shkodër	Bushat (në)	0,77	0,60	0,91	0,66	0,9	0,88	1,06
SH	Shkodër	Dajç	0,90	0,58	0,70	0,49	0,5	0,43	1,05
SH	Shkodër	Bregbunë	0,90	0,58	0,70	0,49	0,5	0,43	1,05
SH	Shkodër	Gur i Zi	0,59	0,52	0,58	0,64	1,0	0,89	0,71
SH	Shkodër	Hajmel	1,78	0,73	0,22	0,46	0,7	0,66	0,77
SH	Shkodër	Postribë	0,87	0,78	0,42	0,75	0,5	0,85	0,43
SH	Shkodër	Pult	0,69	0,97	0,57	0,96	0,5	0,80	0,39
SH	Shkodër	Rrethinat	0,43	0,44	0,44	0,45	0,5	0,44	1,28
SH	Shkodër	Shalë	1,05	0,77	0,54	0,61	0,4	0,31	0,91
SH	Shkodër	Shkodër	0,97	0,80	1,05	0,76	1,1	0,82	0,69
SH	Shkodër	Shllak	1,03	1,63	0,84	1,49	1,0	0,72	1,74
SH	Shkodër	Shosh	0,85	1,77	0,69	1,31	0,9	2,40	-
SH	Shkodër	Temal	0,86	1,11	0,90	0,92	0,5	1,08	-
SH	Shkodër	Vau i Dejës	1,22	0,77	0,61	0,71	1,0	0,83	1,02
SH	Shkodër	Velipojë	1,34	1,27	1,12	1,73	1,4	1,88	1,99

SH	Shkodër	Vig-Mnelë	0,70	0,97	0,55	0,65	1,0	0,97	1,42
Shkodër Min.			38%	29%	22%	37%	38%	29%	0%
Shkodër Maks.			301%	271%	226%	244%	301%	271%	199%
Shkodër Mesatarja			91%	100%	73%	91%	91%	100%	94%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Krahasimi i shpenzimeve për frymë na jep disa indikacione të rëndësishme: mesatarisht njësitë e qarkut Shkodër shpenzojnë rreth 10% më pak se mesatarja kombëtare për banor në vitet 2010 dhe 2012 (27% më pak në 2011), por shpenzojnë krahasimisht më shumë për frymë për personel, në nivele që i afrohen ngushtësisht mesatares kombëtare. Rikujtojmë se të ardhurat e veta për frymë në qarkun Shkodër janë më pak se 35% e mesatares kombëtare. Në vitin 2012, shpenzimet për frymë për personelin janë rritur mesatarisht, ndërkohë që Ana e Malit, Bërdicë, Shalë mbeten njësi me nivele të ulëta shpenzimi. Ndërkohë, ka njësi që shpenzojnë shumë për personel, si Velipoja, Rrapë (pothuajse dyfishi i mesatares kombëtare për frymë) apo Fushë-Arrëzi (pothuajse trefishi). Edhe bashkia Shkodër, si bashkia me buxhetin më të madh në qark dhe popullsi të madhe, ka nivele shpenzimi për personel të krahasueshme me atë të komunave, ndërkohë që shpenzon 40% më pak për investime për frymë se mesatarja kombëtare.


11.3 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Shkodër

Qeverisja vendore luan një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë seksion do të hedhim një vështrim mbi të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për qarkun e Shkodrës, të dhënat mbi forcën e punës dhe punësimin (për sa të dhënat janë të disponueshme), si dhe sipërmarrjen dhe zhvillimin e bizneseve, të cilat analizohen si nga pikëpamja e përqendrimit në çdo qark, ashtu edhe nga pikëpamja e të ardhurave që gjenerojnë në nivel kombëtar si dhe për çdo njësi.

a. Prodhimi i brendshëm bruto.

Pesha specifike e rajonit të Shkodrës ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është 6,07%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është 20% më e ulët se mesatarja kombëtare, me 2583 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Census-it 2011.

Figura 70 Struktura e PBB-së sipas qarqeve 2011




Burimi: Instat

Tabela 46. PBB totale dhe PBB për frymë sipas qarqeve

Qarku	PBB çmime korrente (mln lekë)	Pesha specifike	PBB për frymë në lekë	PBB për frymë Euro	PBB për frymë si % e kombëtares
Shqipëria	2 800 138	100%	457 926	3271	100,0%
Dibër	137 047	3,1%	291 528	2082	63,7%
Durrës	262 785	9,4%	458 656	3276	100,2%
Kukës	85 292	2,4%	367 221	2623	80,2%
Lezhë	134 027	3,6%	349 385	2496	76,3%
Shkodër	215 347	6,0%	361 626	2583	79,0%
Elbasan	295 827	9,2%	400 484	2861	87,5%
Tiranë	749 365	36,3%	621 460	4439	135,7%
Berat	141 944	4,8%	431 071	3079	94,1%
Fier	310 331	9,9%	405 412	2896	88,5%
Gjirokastër	72 176	2,7%	473 537	3382	103,4%
Korçë	220 357	6,2%	364 077	2601	79,5%
Vlorë	175 640	6,3%	456 462	3260	99,7%


Figura 71. PBB për frymë si përqindje e PBB-së për frymë në nivel kombëtar



Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Shkodrës, vërejmë se sektori i bujqësisë dominon strukturën e PBB-së lokale, me peshë specifike prej 26% në vitin 2011, i ndjekur nga sektori i shërbimeve, përfshirë tregtinë, hotelet, transportin dhe telekomunikacionin (23%) dhe sektorin financiar të pronave (19%). Industria dhe ndërtimi sjellin më pak se 20% të vlerës së shtuar bruto në këtë qark.

Figura 72. Struktura e PBB-së sipas sektorëve për qark



b. Sipërmarrja dhe bizneset.

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Shkodër janë të regjistruara mbi 8950 biznese, ndër të cilat rreth 7300 në rrethin e Shkodrës. Vetëm në qytetin e Shkodrës janë të regjistruara mbi 62% e bizneseve të të gjithë qarkut, si edhe 62% ose 660 biznese të mëdha e të mesme të qarkut. 47% e bizneseve operojnë në fushën e tregtisë, 17% janë hotele dhe restorante, ndërsa rreth 4% në fushën e pasurive të paluajtshme. Ndërkohë, sipas të dhënave të tatimeve, të cilat regjistrojnë numrin e bizneseve aktive (pra që paguajnë tatim), rrethi i Shkodrës rezulton të ketë rreth 2400 biznese ose 4,8% e bizneseve në shkallë vendi, si edhe 1072 biznese të mëdha (subjekt i tatimit mbi fitimin) që janë rreth 4,7% e bizneseve të mëdha në shkallë vendi.

Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) kanë ulje nga viti 2009, me një rënie drastike në vitin 2012. Në vitin 2012 të ardhurat nga kjo taksë janë mesatarisht 97 lekë për frymë, me një ulje mbi 30% nga një vit më parë. Kjo ulje në vlerat mesatare duket të ketë ardhur nga realizime më të dobëta në të gjitha njësitë, përfshirë edhe bashkitë e Shkodrës dhe Pukës, ku realizimi i vitit 2012 është pothuajse sa gjysma e një viti më parë. Komuna e Velipojës është e vetmja që ka rritje të konsiderueshme të të ardhurave për frymë në vitin 2012. Ndërkohë, mbi gjysma e njësive kanë të ardhura për frymë më të ulëta se 32 lekë dhe nëntë njësi nuk e mbledhin taksën (dhe/ose nuk kanë biznese).

Të ardhurat nga taksat e biznesit për banor (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 47. Të ardhurat për frymë nga taksa e biznesit të vogël

			2008	2009	2010	2011	2012
SH	Malësi e madhe	Gruemirë	82	96	68	40	77
SH	Malësi e madhe	Kastrat	-	1	2	-	34
SH	Malësi e madhe	Kelmend	6	10	-	3	8
SH	Malësi e madhe	Koplik	387	377	342	322	164
SH	Malësi e madhe	Qendër	49	40	34	45	42
SH	Malësi e madhe	Shkrelë	47	33	19	-	22
SH	Pukë	Blerim	8	12	1	-	14
SH	Pukë	Fierzë	-	-	-	-	-
SH	Pukë	Fushë-Arrëz	357	213	206	232	256
SH	Pukë	Gjegjan	146	95	96	89	62
SH	Pukë	Iballë	16	-	-	-	-
SH	Pukë	Pukë	782	820	845	917	444
SH	Pukë	Qafë-Mali	81	85	29	-	21
SH	Pukë	Qelëz	23	11	58	21	8
SH	Pukë	Qerret	52	81	2	17	20
SH	Pukë	Rrapë	6	-	-	-	-
SH	Shkodër	Ana e Malit	56	33	65	104	72
SH	Shkodër	Bërdicë	160	198	203	285	71
SH	Shkodër	Bushat (neë)	137	164	172	230	76
SH	Shkodër	Dajç Bregbunë)	111	72	84	127	32
SH	Shkodër	Gur i Zi	48	62	65	15	43
SH	Shkodër	Hajmel	80	61	22	74	59
SH	Shkodër	Postribë	3	-	-	-	-
SH	Shkodër	Pult	-	-	-	-	-
SH	Shkodër	Rrethinat	115	80	200	132	58
SH	Shkodër	Shalë	-	-	-	-	-
SH	Shkodër	Shkodër	762	740	671	981	380
SH	Shkodër	Shllak	-	-	-	-	-
SH	Shkodër	Shosh	-	-	-	-	-
SH	Shkodër	Temal	-	-	-	-	-
SH	Shkodër	Vau Dejës	198	189	120	192	99
SH	Shkodër	Velipojë	697	532	521	631	1144
SH	Shkodër	Vig-Mnelë	-	-	-	-	10
Mesatare			134	121	116	135	97
Min.			-	-	-	-	-
Maks.			782	820	845	981	1144
Mesatarja Koefficienti i variacionit			49	40	29	17	32
			1,64	1,70	1,75	1,85	2,20

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

d. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (toka bujqësore dhe ndërtesat).

Tabela 48. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Tiranë, krahasuar me mesataren kombëtare për banor

			2008	2009	2010	2011	2012
SH	Malësi e madhe	Gruemirë	71	33	36	18	53
SH	Malësi e madhe	Kastrat	49	64	83	160	202
SH	Malësi e madhe	Kelmend	-	-	1	3	49
SH	Malësi e madhe	Koplik	115	102	108	96	118
SH	Malësi e madhe	Qendër	0	1	11	29	56
SH	Malësi e madhe	Shkrelë	26	26	33	23	66
SH	Pukë	Blerim	-	3	14	-	24
SH	Pukë	Fierzë	4	514	1,133	533	-
SH	Pukë	Fushë- Arrëz	279	308	354	108	821
SH	Pukë	Gjegjan	50	78	84	155	82
SH	Pukë	Iballë	3	-	-	-	55
SH	Pukë	Pukë	207	274	346	208	211
SH	Pukë	Qafë-Mali	136	60	86	-	147
SH	Pukë	Qelëz	183	343	-	30	158
SH	Pukë	Qerret	176	98	215	20	335
SH	Pukë	Rrapë	51	50	51	16	50
SH	Shkodër	Ana e Malit	43	46	30	86	17
SH	Shkodër	Bërdicë	229	182	91	82	133
SH	Shkodër	Bushat	339	216	404	310	370
SH	Shkodër	Dajç					
SH	Shkodër	Bregbunë	189	267	419	170	462
SH	Shkodër	Gur i Zi	75	67	68	20	52
SH	Shkodër	Hajmel	198	149	20	202	67
SH	Shkodër	Postribë	49	54	53	53	58
SH	Shkodër	Pult	173	-	196	162	-
SH	Shkodër	Rrethinat	57	41	52	60	136
SH	Shkodër	Shalë	-	-	-	-	45
SH	Shkodër	Shkodër	226	234	248	237	275
SH	Shkodër	Shllak	-	-	-	-	-
SH	Shkodër	Shosh	-	-	-	-	-
SH	Shkodër	Temal	250	356	92	299	317
SH	Shkodër	Vau Dejës	318	332	291	323	189
SH	Shkodër	Velipojë	684	572	641	1484	1427
SH	Shkodër	Vig-Mnelë	-	-	-	12	106
Mesatare			127	136	156	148	184
Min.			-	-	-	-	-
Maks.			684	572	1133	1484	1427
Mesatarja Koefficienti i variacionit			71	64	68	60	82
			1,14	1,16	1,50	1,82	1,52

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Performanca e njësive të Shkodrës në lidhje me taksat e pasurisë ka ardhur në përmirësim pothuajse çdo vit e veçanërisht në vitin 2012. Gjithashtu, mesatarja është rritur në vitin 2012 pas rënies së një viti më parë: gjysma e njësive të Shkodrës kanë të ardhura për frymë nga taksat e pasurisë mbi 82 lekë – vlera më e lartë në pesë vjet. Megjithatë, pabarazia në shpërndarje si rasti i komunës Velipojë, si komunë bregdetare me potencial në turizëm dhe vlera të larta treguese të taksës së pasurisë, ka demonstruar ulje në realizim në vitin 2012, ndonëse ka vlerat më të larta në qark, por edhe më të larta se mesatarja kombëtare. Bashkia Shkodër, me dendësi të madhe banesash dhe vlerë tregtuese të lartë, ndonëse ka pasur rritje në vitin 2012, mbledh më pak të ardhura për frymë se komuna e Dajçit, Temalit, Bushatit, Qerretit apo bashkia Fushë-Arrëz. Si në të gjithë vendin, bashkitë më të mëdha nuk performojnë aq mirë sa njësitet mesatare për taksën e pasurisë.

11.4 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Shkodrës ka 33 njësi administrative. Popullsia është 211 685 banorë.
- Qarku i Shkodrës ka pësuar gjithashtu rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-17%). Zonat urbane kanë pësuar zvogëlim me (-2,6%), ndërsa ato rurale një rënie me -26%. Dendësia gjithashtu ka rënë (-17%).
- Qarku i Shkodrës numëron 54 429 familje.
- Popullsia rinore (15 - 29 vjeç) përbën rreth 24,3% të popullsisë. Popullsia në moshë pune 15 - 64 përbën 66%, ndërsa mosha e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 12,4%.
- 5,7% e popullsisë janë persona me aftësi të kufizuara.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun e Shkodrës sipas gjinisë është 49,8% meshkuj dhe 50,2% femra.
- Popullsia në moshë pune është 65,9% e totalit të popullsisë së qarkut.
- Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Shkodrës janë 18 942 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona, 1395 përfitojnë pagesë papunësie.
- Sipas rezultateve të Census-it 2011 popullsia migruese e kthyer në qarkun e Shkodrës prej vitit 2001 deri më 2011 është 7893 persona, ku 69,2% e të kthyerve janë meshkuj.

Strehimi

- 54 429 familje, 48 027 në pronësi ose në proces pronësimi, 1618 me qira, 4784 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Shkodrës ka mesatarisht 3,09 dhoma – treguesi i dytë më i lartë në Shqipëri pas Lezhës.
- 2059 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 14 787 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 53 399 banesa të banuara) ose rreth 31,5% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm – treguesi më i lartë në vend që tregon për gjendjen e keqe të furnizimit me ujë në qarkun e Shkodrës.
- Rreth 5407 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 53 399 banesa të banuara) ose 10,1%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Shkodrës shënon një nivel varfërie prej 15,7%. Thellësia e varfërisë është 3,7% dhe ashpërsia 1,6%. Tregues të lartë varfërie krahasuar me vlerat kombëtare.
- Nga ana tjetër, 15 433 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Shkodrës ose rreth 15,8% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 28,3% të totalit të familjeve.
- Koeficienti GINI për qarkun e Shkodrës është 28,2.
- Konsumi total për familje në qarkun e Shkodrës është 50 406 lekë, krahasuar me konsumin për person që është 11 953 lekë.

Shëndetësia

- 12 318 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 7,87%.
- 2 spitale me 653 shtretër, si dhe 119 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Shkodrës kemi një numër total mjekësh prej 225.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 18 minuta, ashtu sikurse edhe në zonat rurale, 18 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 18 minuta për jo të varfrit dhe 20 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 5284 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 2,8%.

Shërbimet

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	2
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	4
Shërbime sociale për fëmijët	3	13
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	9
Shërbime sociale për PAK	1	6
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	3
Gjithsej	5	37

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF


12 Qarku Tiranë

Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Tiranës. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasimore mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

12.1 Profili i qarkut Tiranë dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Tiranës përbëhet nga 29 NJQV në dy rrethe: rrethi i Kavajës (10 njësi, qendër Kavajë) dhe rrethi i Tiranës (19 njësi, qendër Tiranë). Popullsia e qarkut të Tiranës është 749 395 banorë në vitin 2011, ndër të cilët pothuajse 56% (418 495 banorë) jetojnë në qytetin e Tiranës dhe 91% jetojnë në rrethin e Tiranës. Qyteti i dytë më i madh në qark është bashkia Kamëz me rreth 66 000 banorë, e cila është edhe një nga tetë bashkitë më të mëdha të vendit; por ka edhe njësi të tjera me popullsi të madhe për standardet e sotme, si Kashari (rreth 43 000), Paskuqani (rreth 37 000), Farka (rreth 22 000) dhe Dajti (rreth 20 000). (INSTAT, Census 2011). Kavaja, si qendër e rrethit të Kavajës është relativisht e vogël në popullsi, me rreth 20 mijë banorë.

Figura 53. NJQV-të në qarkun e Tiranës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Qarku i Tiranës ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 25% ose mbi 246 000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në janar 2012 në qarkun e Tiranës ishin të regjistruar 995 786 banorë, me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011 (pra 62% në bashkinë Tiranë dhe 88% në rrethin e Tiranës). Megjithatë, qarku i Tiranës është i vetmi në

vend, krahas Durrësit, që ka regjistruar rritje të popullsisë në krahasim me Census-in e vitit 2001: rritje 2,1%.

Tabela 49. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Tiranë

Qarku	Rrethi	Njësia	Census 2011	Regjistri civil 2011	Ndryshimi i popullsisë	Ndryshimi në %
Tiranë	Kavajë	Golem	6994	11 956	-4962	-42%
Tiranë	Kavajë	Gosë	4120	8037	-3917	-49%
Tiranë	Kavajë	Helmës	3139	4790	-1651	-34%
Tiranë	Kavajë	Kavajë	20 192	39 304	-19 112	-49%
Tiranë	Kavajë	Kryevidh	4662	8794	-4132	-47%
Tiranë	Kavajë	Lekaj	5126	9124	-3998	-44%
Tiranë	Kavajë	Luz i Vogël	4735	10 158	-5423	-53%
Tiranë	Kavajë	Rrogzhinë	7049	11 580	-4531	-39%
Tiranë	Kavajë	Sinaballaj	1191	1820	-629	-35%
Tiranë	Kavajë	Synej	5034	10 600	-5566	-53%
Kavajë gjithsej			62 242	116 163	-53 921	-53%
Tiranë	Tiranë	Baldushk	4576	5252	-676	-13%
Tiranë	Tiranë	Bërxullë	9883	9614	269	3%
Tiranë	Tiranë	Bërzhitë	4973	5734	-761	-13%
Tiranë	Tiranë	Dajt	20 139	11 862	8277	70%
Tiranë	Tiranë	Farkë	22 633	11 476	11 157	97%
Tiranë	Tiranë	Kamëz	66 841	79 404	-12 563	-16%
Tiranë	Tiranë	Kashar	43 353	21 311	22 042	103%
Tiranë	Tiranë	Krrabë	2343	3015	-672	-22%
Tiranë	Tiranë	Ndroq	5035	9170	-4135	-45%
Tiranë	Tiranë	Paskuqan	37 349	39 511	-2162	-5%
Tiranë	Tiranë	Petrelë	5542	6378	-836	-13%
Tiranë	Tiranë	Pezë	6272	5654	618	11%
Tiranë	Tiranë	Prezë	4727	6607	-1880	-28%
Tiranë	Tiranë	Shëngjergj	2186	2797	-611	-22%
Tiranë	Tiranë	Tiranë	418 495	618 288	-199 793	-32%
Tiranë	Tiranë	Vaqarr	9106	9026	80	1%
Tiranë	Tiranë	Vorë	10 901	18 393	-7492	-41%
Tiranë	Tiranë	Zall Bastar	3380	5495	-2115	-38%
Tiranë	Tiranë	Zall Herr	9389	10 636	-1247	-12%
Tiranë gjithsej			687 123	879 623	-192 500	-12%
Qarku Tiranë gjithsej			749 365	995 786	-246 421	-25%

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Tiranë përbën rreth 32,4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 25 840 banorë/NJQV ose tre herë më e lartë se mesatarja kombëtare prej 8016 banorë/NJQV. Kjo mesatare rritet ndjeshëm për shkak të përqendrimit të madh të popullsisë në qendrat urbane dhe periferike në rrethin e Tiranës, ku madhësia mesatare e njësisë është pothuaj 15 mijë banorë pa llogaritur qytetin e Tiranës. Njësitë e rrethit të Kavajës janë më të vogla, me një mesatare prej 6224 banorësh ose 22% më të vogël se mesatarja kombëtare.

Tabela 50. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Tiranë sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


	<i>Nr. i njësive</i>	<i>Min.</i>	<i>Maks.</i>	<i>Mesatare/ njësi</i>	<i>Shuma</i>	<i>% e popullsisë</i>	<i>Shqipëria</i>
Shqipëria				8016		100%	
Tiranë				25 840	749 365	32,4%	
0-2000	1	1191	1191	1191	1191	0,2%	27,61%
2001-5000	10	2186	4973	3384	38 841	5,2%	34,58%
5001-10 000	10	5034	9883	6943	69 430	9,3%	26,27%
10 001 – 20 000	1	10 901	10 901	10 901	10 901	1,5%	6,70%
20 001-30 000	3	20 139	22 633	20 988	62 964	8,4%	1,61%
30 001-50 000	2	37 349	43 353	40 351	80 702	10,8%	1,07%
50 000-100 000	1	66 841	66 841	66 841	66 841	8,9%	1,61%
100 000-200 000	0	0	0	0	0	0,0%	0,27%
200 000+	1	418 495	418 495	418 495	418 494	55,8%	0,27%

Burimi: INSTAT, *Census 2011; Llogaritjet e autorëve*

Dendësia mesatare e popullsisë është 830 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Dendësinë më të madhe e ka natyrisht Tirana, me mbi 10 000 banorë/km², por dendësi mjaft të lartë kanë edhe qendra, si Kamza (2697 banorë/km²) dhe Paskuqani (3013 banorë/km²) apo Kavaja (2531 banorë/km²). Megjithatë, gjysma e njësive të qarkut kanë dendësi më të ulët se 127 banorë/km².

Pesha e njësive të qarkut Tiranë në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 28% mesatarisht në pesë vitet 2008 - 2012.

Figura 73. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Tiranë krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore




Burimi: *Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve*

Shpenzimet operative zënë rreth 60% të shpenzimeve totale në qarkun e Tiranës në vitet 2008 - 2011, por pesha specifike e tyre është rritur në 70% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë në nivelin e 30% të shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Në nivel kombëtar, shpenzimet për personel në qarkun e Tiranës zënë rreth 24% të

shpenzimeve për paga dhe sigurime ose 9% të shpenzimeve gjithsej. Vetëm bashkia e Tiranës zinte një peshë prej 17% në shpenzimet totale vendore të njësisë të nivelit të parë në vitin 2012, por vetëm 12% të shpenzimeve kapitale. Shpenzimet kapitale zënë rreth 40% në strukturën totale (30% në 2012). Ky raport është më i lartë se mesatarja kombëtare prej 34% në 5 vite ose 26% në vitin 2012. Bashkia e Tiranës, Kamzës, Kasharit dhe Vorës, të cilat kanë buxhetet dhe popullsitë më të mëdha në rrethin e Tiranës, zënë rreth 77% në totalin e shpenzimeve të qarkut në 2012 (81% të pagave dhe 65% të investimeve).


Figura 74. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Tiranë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Sektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve, me rreth 50% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) mesatarisht me rreth 28%.


Figura 75. Shpenzimet sipas sektorëve (funsioneve) në NJQV-të e qarkut Tiranë



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Tiranë në vitin 2012 janë ulur në rreth 23% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri, nga 29% në vitin 2008. Nga viti 2008 në vitin 2009 të ardhurat e njësisë të qarkut Tiranë janë rritur me 16%, por më tej janë ulur me mesatarisht 7% çdo vit, duke arritur për herë të parë në vitin 2012 një vlerë absolute edhe më të ulët se ajo e viti 2008.


Figura 76. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Tiranë kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Të ardhurat nga burimet e veta janë rritur vazhdimisht në njësitë e qarkut Tiranë, si në vlerë absolute, ashtu edhe si peshë specifike në strukturën totale të të ardhurave (56% në vitet 2008-2011 dhe 67% në 2012), ndërkohë që transferta e pakushtëzuar është ulur lehtë në vlerë. Transferrat e kushtëzuara kanë ruajtur pak a shumë vlerën (rritje në vitet 2010-2011 dhe më tej ulje e lehtë), por kanë rënie në peshë specifike.

Figura 77. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Tiranës



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

12.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Tiranë

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Tiranë, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- a. Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.

Njësitë me buxhete (të ardhurat totale) më të mëdha janë natyrisht bashkia e Tiranës (4,1 miliardë lekë në vitin 2012), bashkia e Kamzës (303 milionë lekë) dhe komunat e Kasharit dhe Farkës (përkatësisht 454 dhe 306 milionë lekë në vitin 2012). Vetëm Tirana zë rreth 68% të të ardhurave nga burimet e veta për gjithë qarkun, ndërsa së bashku me njësitë e tjera të përmendura përbëjnë rreth 85% të buxhetit për qarkun. Në rrethin e Kavajës janë bashkia e Kavajës (93 milionë lekë) dhe komuna e Golemit (80 milionë lekë), të cilat kanë buxhetet më të mëdha. Njësitë me buxhete më të vogla në qarkun e Tiranës janë Krraba (3 milionë lekë), Zall Bastari (840 mijë lekë) dhe Baldushku (3,5 milionë lekë) me popullsi përkatësisht 2343, 3380 dhe 4576 banorë, sipas Census-it. Njësitë me buxhete më të ulëta në qarkun e Kavajës në vitin 2012 janë komunat Helmës (4,8 milionë lekë) dhe Lekaj (5,6 milionë lekë) me popullsi përkatësisht 3139 dhe 5126 banorë.

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Siç shihet në tabelën 61, të ardhurat e veta për banor në qarkun e Tiranës janë më shumë se 50% më të larta se mesatarja kombëtare. Natyrisht, kjo mesatare kaq e lartë nuk është treguese për të gjithë njësitë, pasi në këtë qark janë disa njësi të cilat, veçojnë nga të tjerat (*outliers*). Këtu mund të veçojmë komunën e Golemit në rrethin e Kavajës (të ardhura të veta për frymë mbi 2 herë mbi mesataren kombëtare) dhe komunat e Kasharit dhe Farkës në rrethin e Tiranës, me të ardhura për frymë përkatësisht 7 dhe 8 herë më të larta se mesatarja kombëtare. Në strukturën e brendshme të të ardhurave për këto komuna vërehet se taksa e ndikimit në infrastrukturë ka qenë shumëfish më e lartë se mesatarja kombëtare në vitin 2012, 6 herë për Golemin, 30 herë për Kasharin dhe 50 herë për Farkën. Po të vrojtojmë burimet kryesore të të ardhurave, vërehet se të gjitha bashkitë kryesore të qarkut luhaten mbi ose rreth mesatares kombëtare për vlerat e taksës së biznesit të vogël. Edhe komuna Dajt ka të ardhura për frymë 5 herë më të larta se mesatarja kombëtare (27 herë më të larta të ardhurat për frymë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2012). Ndërkohë, Bashkia e Tiranës, ndonëse ka buxhetin absolutisht më të madh, ka të ardhura të veta për frymë përkatësisht 1,6, 1,7 dhe 2,1 herë më të larta se mesatarja kombëtare në vitet 2010-2012. Njësitë me buxhete më të larta, si Farka, Kashari, Tirana, Kamza dhe Vora kanë edhe realizimin më të mirë për frymë nga tarifa e pastrimit, 2-4 herë më të lartë se mesatarja kombëtare.

Tabela 51. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me të mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor

			2010	2011	2012							
			Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Të ardhurat e veta	Biznesi vogël	Taksa pasuri	Ndikim infrastrukture	Regjistri mi automjeteve	Tarifë pastri mi	Transf. e pak	Transf. e kusht.
TR	Kavajë	Golem	1,44	1,61	2,12	1,13	2,22	6,78	0,42	1,43	0,77	0,16
TR	Kavajë	Gosë	0,23	0,30	0,32	0,17	1,25	0,03	0,24	0,32	0,70	0,58
TR	Kavajë	Helmës	0,62		0,31	0,29	1,00	0,16	0,18	0,24	0,72	3,78
TR	Kavajë	Kavajë	0,94	0,92	0,76	1,73	0,33	0,31	0,78	0,80	0,71	1,23
TR	Kavajë	Kryevidh	0,63	0,74	0,74	0,59	2,12	-	0,23	0,39	0,68	1,05
TR	Kavajë	Lekaj	0,33	0,27	0,20	0,58	0,26	-	0,22	0,21	0,69	0,36
TR	Kavajë	Luzi										
TR	Kavajë	Vogël	0,43	0,49	0,49	0,47	1,80	-	0,36	0,54	0,65	1,54
TR	Kavajë	Rrogozhinë	0,78	0,59	0,47	0,64	0,63	0,64	0,37	0,58	0,93	0,49
TR	Kavajë	Sinaballaj	0,27	0,20	3,37	0,06	0,93	-	48,79	-	1,27	1,27
TR	Kavajë	Synej	0,60	0,37	0,37	0,36	1,28	-	0,23	0,49	0,68	0,17
TR	Tiranë	Baldushk	0,43	0,39	0,21	0,46	0,38	0,17	-	0,06	0,92	0,34
TR	Tiranë	Bërxullë	0,63	0,80	0,65	0,48	0,59	0,24	0,10	0,32	0,67	16,14
TR	Tiranë	Bërzhitë	0,90	0,55	0,73	1,08	0,55	0,07	-	0,50	1,14	3,03
TR	Tiranë	Dajt	5,11	5,01	4,36	1,08	0,79	27,30	-	0,91	0,85	0,16
TR	Tiranë	Farkë	5,53	8,17	8,39	0,82	2,09	50,54	-	1,67	0,61	0,73
TR	Tiranë	Kamëz	1,09	1,27	1,22	0,97	1,08	0,38	-	1,88	0,95	0,89
TR	Tiranë	Kashar	8,52	13,08	6,71	2,14	8,36	30,46	-	3,60	0,58	0,85
TR	Tiranë	Krrabë	0,12	0,30	0,31	0,32	0,76	-	-	0,18	1,31	1,91
TR	Tiranë	Ndroq	0,23	0,23	0,24	0,39	0,35	0,08	-	-	0,71	0,11
TR	Tiranë	Paskuqan	0,22	0,43	0,54	0,38	0,39	0,68	-	0,39	0,70	1,33
TR	Tiranë	Petrelë	3,15	2,54	2,12	0,66	1,37	6,92	-	1,34	0,72	0,27
TR	Tiranë	Pezë	0,52	0,62	0,79	0,82	0,95	0,99	-	-	1,13	1,33
TR	Tiranë	Prezë	1,91	2,36	4,25	0,31	1,87	24,86	-	0,94	0,64	0,40
TR	Tiranë	Shëngjergj	0,85	1,16	1,08	0,45	0,44	-	-	-	2,23	1,43
TR	Tiranë	Tiranë	1,72	1,64	2,14	2,67	1,61	0,89	2,37	3,12	0,54	0,16
TR	Tiranë	Vaqarr	1,19	1,72	0,99	1,02	3,62	0,24	-	0,43	0,64	0,58
TR	Tiranë	Vorë	3,09	3,31	2,63	1,09	4,37	3,06	-	1,85	0,89	3,78
TR	Tiranë	Zall										
TR	Tiranë	Bastar	0,11	0,04	0,05	-	0,11	-	0,02	-	1,49	1,23
TR	Tiranë	Zall Herr	0,33	0,31	0,33	0,32	0,26	0,18	-	-	0,68	1,05
Tiranë Mesatarja			1,45	1,72	1,62	0,74	1,44	5,34	1,87	0,76	0,87	0,36
Shqipëria			100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tonë

c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 52. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve

Qar ku	Rrethi	Njësia	2010		2011		2012		Investime / frymë në % të mes. kombëtar e
			Shp./frym ë në % të mes. kombëtar e	Shp. personeli/ frymë në % të mes. kombëtar e	Shp./frym ë në % të mes. kombëtar e	Shp. personeli/ frymë në % të mes. kombëtar e	Shp./frym ë në % të mes. kombëtar e	Shpenzim e personeli/ frymë në % të mes. kombëtar e	
TR	Kavajë	Golem	1,4	1,2	2,3	1,2	1,5	0,31	3,12
TR	Kavajë	Gosë	0,8	0,5	0,3	0,5	0,4	0,62	-
TR	Kavajë	Helmës	0,6	0,6	0,9	0,6	0,5	0,68	-
TR	Kavajë	Kavajë	0,9	0,7	0,8	0,7	1,1	1,09	0,73
TR	Kavajë	Kryevidh	1,0	0,6	0,3	0,7	0,7	0,42	1,58
TR	Kavajë	Lekaj	0,8	0,5	0,4	0,4	0,4	0,41	0,40
TR	Kavajë	Luz i Vogël	0,9	0,5	0,4	0,5	0,5	0,45	0,54
TR	Kavajë	Rrogozhinë	0,8	0,7	0,7	0,7	0,9	0,90	0,32
TR	Kavajë	Sinaballaj	0,5	0,8	0,5	0,7	0,5	0,46	-
TR	Kavajë	Synej	0,4	0,4	0,5	0,5	0,5	0,24	1,04
TR	Tiranë	Baldushk	1,3	0,9	0,6	0,9	0,5	0,55	0,69
TR	Tiranë	Bërxullë	1,3	0,9	0,7	0,9	0,9	0,99	1,19
TR	Tiranë	Bërzhitë	0,9	1,9	1,0	1,4	1,2	1,16	2,33
TR	Tiranë	Dajt	3,7	1,7	3,2	1,8	2,7	1,59	5,24
TR	Tiranë	Farkë	3,5	1,4	3,3	1,5	4,8	1,28	14,46
TR	Tiranë	Kamëz	1,1	0,8	1,1	0,8	1,2	0,84	2,61
TR	Tiranë	Kashar	3,2	1,5	6,4	1,5	3,7	1,13	6,71
TR	Tiranë	Krrabë	0,6	0,9	0,6	1,1	0,6	0,95	-
TR	Tiranë	Ndroq	0,6	0,7	0,4	0,6	0,4	0,46	-
TR	Tiranë	Paskuqan	0,6	0,4	1,3	0,5	0,6	0,43	1,20
TR	Tiranë	Petrelë	2,1	1,6	3,4	2,0	1,7	1,43	3,52
TR	Tiranë	Pezë	0,7	1,1	0,6	1,1	0,7	1,18	0,22
TR	Tiranë	Prezë	1,6	1,2	1,3	1,1	1,3	0,75	2,02
TR	Tiranë	Shëngjergj	1,7	1,2	1,3	1,1	1,3	1,21	2,42
TR	Tiranë	Tiranë	1,1	1,1	1,1	1,2	1,2	1,16	0,82
TR	Tiranë	Vaqarr	1,1	1,0	1,1	1,2	1,0	0,97	2,02
TR	Tiranë	Vorë	2,4	1,3	2,0	1,5	1,7	1,32	2,90
TR	Tiranë	Zall Bastar	0,7	1,0	0,5	0,8	0,7	0,68	1,11
TR	Tiranë	Zall Herr	0,4	0,7	0,3	0,7	0,4	0,35	0,97
Tiranë Min.			41%	40%	32%	42%	38%	24%	0%
Tiranë Maks.			366%	194%	636%	200%	483%	159%	1446%
Tiranë Mesatarja			127%	96%	128%	97%	116%	83%	201%


Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Krahasimi i shpenzimeve për frymë na jep disa indikacione të rëndësishme: mesatarisht njësitë e qarkut Tiranë shpenzojnë 30% më shumë se mesatarja kombëtare për banorë në vitet 2010 dhe 2011 dhe rreth 5% më pak për personelin. Në vitin 2012 shpenzimet për frymë për personelin janë ulur pothuajse në të gjitha njësitë, ndonëse disa njësi mbeten sërish me shpenzimet më të larta për personel: Petrela shpenzon 45% më shumë për personel se mesatarja kombëtare apo Dajti 60% më shumë. Megjithatë, në qarkun e Tiranës shumica dërrmuese e njërive kanë shpenzime më të ulëta për personel për frymë se mesatarja kombëtare.

12.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Tiranë

Le të shikojmë sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë NJQV-të e qarkut Tiranë.

Figura 78. Të ardhurat për banorë përkundrejt popullsisë dhe shpenzimeve për personelin në NJQV-të e qarkut Tiranë 2011



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Mesatarja e të ardhurave për frymë në NJQV-të e qarkut Tiranë ulet nga 11 616 lekë (83 Euro) në vitin 2009, në rreth 9127 lekë (65 Euro) për frymë në vitin 2012. Përkundrazi, mesatarja e të ardhurave të veta për frymë rritet nga rreth 4328 lekë (31 Euro) në 2009 në 5124 lekë (36 Euro) në 2012, çka dëshmon se ulja shkaktohet për efekt të uljes së të ardhurave nga buxheti i shtetit, më e ndjeshme kjo tek transfertat e kushtëzuara për frymë, të cilat kanë qenë pothuaj dyfish më të larta në vitin 2009. Në nivel vendi, të ardhurat e veta për frymë janë rreth 3107 lekë për banor në vitin 2012.


Grafiku në Fig. 77 tregon të ardhurat për frymë nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar, si edhe shpenzimet për paga e sigurime për banorë në vitin 2011. Siç shihet, në përgjithësi njësitë me popullsi më të madhe gjenerojnë të ardhura të veta më të larta për banor, ndërkohë që transfertat e pakushtëzuar ndjek drejtimin e kundërt. Ndërkohë, sjellja e treguesit të shpenzimeve për personelin (për banor gjithashtu) përgjithësisht ka lidhje inverse me të ardhurat e veta për frymë dhe popullsinë totale.

Po të shikojmë klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të njërive për qarkun Tiranë vërehet se shpenzimet totale për frymë pësojnë ulje nga viti 2009 deri në vitin 2012. Mesatarja e shpenzimeve për personelin dhe atyre për investime gjithashtu pësojnë ulje në këtë periudhë. Sidoqoftë, duhet përmendur se ecuria e investimeve kapitale duhet vrojtuar përgjatë një periudhe relativisht të gjatë, ndaj treguesit vjetorë janë më pak domethënës në këtë rast. Siç shikohet në tabelën 5, investimet për frymë tentojnë të jenë më të larta në zonat me popullsi më të vogël se në ato me popullsi më të madhe. Duke vrojtuar strukturën e buxheteve vendore mund të përfundojmë se shumica e investimeve në njësitë më të vogla financohen me anë të granteve të kushtëzuara dhe ose konkurruese.

Tabela 53. Shpenzimet për frymë 2010 – 2012

Qarku	Rrethi	Njësia	2010			2011			2012		
			Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë	Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë	Shpenz./ frymë	Personel/ frymë	Invest./ frymë
TR	Kavajë	Golem	9901	2973	4175	14 135	2927	8615	9635	741	5106
TR	Kavajë	Gosë	6077	1250	3628	1991	1244	0	2454	1472	0
TR	Kavajë	Helmës	4372	1473	829	5637	1461	2505	3037	1620	0
TR	Kavajë	Kavajë	6385	1587	2708	5139	1577	1527	7230	2597	1197
TR	Kavajë	Kryevidh	7419	1504	4941	2161	1706	0	4594	1008	2577
TR	Kavajë	Lekaj	6100	1106	3837	2411	986	658	2589	971	647
TR	Kavajë	Luz i Vogël	6766	1198	4606	2363	1181	98	3337	1080	883
TR	Kavajë	Rrogozhinë	5778	1588	1536	4404	1727	173	5444	2160	518
TR	Kavajë	Sinaballaj	3838	1984	161	3297	1648	0	3299	1100	0
TR	Kavajë	Synej	2961	1082	563	2925	1226	755	3113	566	1698
TR	Tiranë	Baldushk	9366	2294	6137	3808	2094	952	3203	1319	1131
TR	Tiranë	Bërxullë	9563	2190	6060	4369	2080	1768	5728	2352	1943
TR	Tiranë	Bërzhitë	6372	4723	328	6104	3314	2267	7945	2763	3800
TR	Tiranë	Dajt	26 566	4052	13 849	20 233	4215	7419	17 123	3796	8562
TR	Tiranë	Farkë	25 260	3372	16 430	20 303	3486	10 718	30 841	3059	23 619
TR	Tiranë	Kamëz	8296	1879	4956	6763	1801	3501	7866	2001	4262
TR	Tiranë	Kashar	23 400	3618	13 733	39 698	3566	30 031	23 586	2707	10 967
TR	Tiranë	Krrabë	4303	2197	243	3648	2653	663	3575	2275	0
TR	Tiranë	Ndroq	4095	1694	1580	2290	1418	327	2409	1095	0
TR	Tiranë	Paskuqan	4656	965	3312	8150	1139	6226	3913	1016	1956
TR	Tiranë	Petrelë	14 999	3931	5086	21 167	4704	13 484	10 738	3424	5758
TR	Tiranë	Pezë	4771	2715	577	3537	2476	354	4410	2822	353
TR	Tiranë	Prezë	11 472	2817	6292	8022	2573	3633	8240	1798	3296
TR	Tiranë	Shëngjergj	12 176	2808	6643	8223	2503	3575	8279	2880	3960
TR	Tiranë	Tiranë	8267	2765	2360	6819	2877	1750	7589	2772	1347
TR	Tiranë	Vaqarr	8118	2515	4465	6758	2881	2770	6496	2312	3303
TR	Tiranë	Vorë	17 789	3208	11 771	12 396	3425	5981	10 964	3140	4737
TR	Tiranë	Zall Bastar	4909	2361	600	2912	2002	0	4164	1630	1811
TR	Tiranë	Zall Herr	2971	1712	551	2162	1598	282	2810	843	1592
		Min.	2961	965	161	1991	986	0	2409	566	0
		Maks.	26 566	4723	16 430	39 698	4704	30 031	30 841	3796	23 619
		Mesatare	9205	2330	4550	7994	2293	3794	7400	1976	3277
		Mesatarja	6766	2197	3837	5139	2080	1750	5444	2001	1811
		Koeficienti i variacionit	0,7	0,4	1,0	1,0	0,4	1,6	0,9	0,5	1,4


Figura 79. Shpenzimet për frymë, operative dhe kapitale viti 2012



Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Shpenzimet operative janë mjaft të larta në njësitë e qarkut Tiranë, ndonëse janë më të ulëta se mesatarja në nivel vendi. Në veçanti, shpenzimet për paga e sigurime zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale për çdo njësi, duke variuar nga 16% (Peza) deri në 72% (Bërzhita) në vitin 2012. Pësia relative e zërit të pagave në shpenzimet e përgjithshme operative ka rënë në përgjithësi nga viti 2010 në 2012, në veçanti pas pikut të arritur në vitin 2011, kur mesatarja në nivel qarku (e cila ka vlerë shumë të përafërt me mesataren në çdo vit) kishte arritur nivelin 60%, ndërkohë që maksimumi në nivelin 89%. Në vitin 2012 këto vlera kanë rënë përkatësisht në 52% dhe 72% (Figura 79).

Figura 80. Pësia relative e shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve operative për njësi 2010 - 2012



12.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Tiranë


Qeverisja vendore luan një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë seksion do të hedhim një vështrim mbi të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për qarkun e Tiranës, të dhënat mbi forcën e punës dhe punësimin (për sa të dhënat janë të disponueshme), si dhe sipërmarrjen dhe zhvillimin e bizneseve, të cilat analizohen si nga

pikëpamja e përqendrimit në çdo qark, ashtu edhe nga pikëpamja e të ardhurave që gjenerojnë në nivel kombëtar si dhe për çdo njësi.

a. Prodhimi i brendshëm bruto.

Pesha specifike e rajonit të Tiranës ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është 36,3%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është më e larta në nivel vendi, me 4439 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Census-it 2011. PBB për frymë në qarkun e Tiranës është 36% më e lartë se mesatarja në nivel kombëtar, 3271 Euro për vitin 2012.

Figura 81 Struktura e PBB-së sipas qarqeve 2011




Burimi: Instat

Tabela 54. PBB totale dhe PBB për frymë sipas qarqeve

Qarku	PBB, çmime korrente (mln lekë)	Pesha specifike	PBB për frymë në lekë	PBB për frymë Euro	PBB për frymë si % e kombëtares
Shqipëria	2 800 138	100%	457 926	3271	100,0%
Dibër	137 047	3,1%	291 528	2082	63,7%
Durrës	262 785	9,4%	458 656	3276	100,2%
Kukës	85 292	2,4%	367 221	2623	80,2%
Lezhë	134 027	3,6%	349 385	2496	76,3%
Shkodër	215 347	6,0%	361 626	2583	79,0%
Elbasan	295 827	9,2%	400 484	2861	87,5%
Tiranë	749 365	36,3%	621 460	4439	135,7%
Berat	141 944	4,8%	431 071	3079	94,1%
Fier	310 331	9,9%	405 412	2896	88,5%
Gjirokastër	72 176	2,7%	473 537	3382	103,4%
Korçë	220 357	6,2%	364 077	2601	79,5%
Vlorë	175 640	6,3%	456 462	3260	99,7%


Figura 82. PBB për frymë si përqindje e PBB-së për frymë në nivel kombëtar



Burimi: INSTAT, llogaritjet e autorëve

Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Tiranës, vërejmë se sektori i shërbimeve përfshirë tregtinë, hotelet, transportin dhe telekomunikacionin mbizotëron ekonominë rajonale (42%), i ndjekur nga sektori i ndërtimit (17%). Industria dhe ndërtimi sjellin vetëm 17% të vlerës së shtuar bruto në këtë qark. Shërbime të tjera dhe sektori financiar sjellin rreth 29% të vlerës së shtuar bruto në qark, ndërsa industria dhe bujqësia së bashku 13%.

Figura 83. Struktura e PBB-së sipas sektorëve për qark



b. Sipërmarrja dhe bizneset.

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Tiranë janë të regjistruara mbi 65 000 biznese, ndër të cilat rreth 62 000 në rrethin e Tiranës. Vetëm në qytetin e Tiranës janë të regjistruara mbi 80% e bizneseve të të gjithë qarkut, si edhe 78% prej mbi 3800 bizneseve të mëdha të qarkut. 38% e bizneseve operojnë në fushën e tregtisë, 17% janë hotele dhe restorante, ndërsa rreth 9% në fushën e pasurive të paluajjtshme. Ndërkohë, sipas të dhënave të tatimeve, të cilat regjistrojnë numrin e bizneseve aktive (pra që paguajnë tatim), rrethi i Tiranës rezulton të ketë rreth 24 000 biznese ose 49% e bizneseve në shkallë vendi, si dhe pothuaj 11 000 biznese të mëdha (subjekt i tatimit mbi fitimin) që janë rreth 48% e bizneseve të mëdha në shkallë vendi.

Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) kanë ulje nga viti 2009, kur është shënuar piku për periudhën nën shqyrtim. Në vitin 2012 të ardhurat nga kjo taksë ishin mesatarisht 388 lekë/frymë, me një ulje mbi 20% nga një vit më parë. dhe 145 lekë/frymë në vitin 2012 dhe 2011. Kjo ulje në vlerat mesatare duket të ketë ardhur nga realizime më të dobëta në njësitë më të mëdha, siç tregohet edhe nga ulja e vlerave maksimale në realizimin e taksës. Megjithatë, vlera e mesatares për realizimet për frymë të biznesit të vogël është rritur nga viti në vit, çka tregon përmirësim të realizimit në njësitë më të vogla. Kjo dëshmohet edhe nga fakti që koeficienti i variacionit merr vlera më të vogla në vitet e fundit, duke treguar një shpërndarje më të barabartë të vlerave të taksës së biznesit të vogël për banor. Qarku i Tiranës ka mesataren më të lartë të të ardhurave për frymë nga biznesi i vogël.

Të ardhurat nga taksat e biznesit për banorë (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 55. Të ardhurat për frymë nga taksa e biznesit të vogël

			2008	2009	2010	2011	2012
Tiranë	Kavajë	Golem	860	782	855	633	592
Tiranë	Kavajë	Gosë	177	236	121	344	90
Tiranë	Kavajë	Helmës	114	151	108	284	150
Tiranë	Kavajë	Kavajë	1118	1124	1513	1191	905
Tiranë	Kavajë	Kryevidh	461	363	443	468	308
Tiranë	Kavajë	Lekaj	244	206	188	51	303
Tiranë	Kavajë	Luz i Vogël	302	252	237	374	246
Tiranë	Kavajë	Rrogozhinë	664	601	311	661	334
Tiranë	Kavajë	Sinaballaj	151	45	116	8	32
Tiranë	Kavajë	Synej	232	214	296	217	189
Tiranë	Tiranë	Baldushk	78	157	261	233	239
Tiranë	Tiranë	Bërxullë	61	368	170	166	252
Tiranë	Tiranë	Bërzhitë	154	224	286	122	566
Tiranë	Tiranë	Dajt	377	813	-	1109	566
Tiranë	Tiranë	Farkë	586	919	388	241	430
Tiranë	Tiranë	Kamëz	379	516	634	544	511
Tiranë	Tiranë	Kashar	172	1740	1037	1086	1122
Tiranë	Tiranë	Krrabë	36	42	246	351	167
Tiranë	Tiranë	Ndroq	13	171	307	161	205
Tiranë	Tiranë	Paskuqan	27	84	139	104	200
Tiranë	Tiranë	Petrelë	288	474	182	68	347
Tiranë	Tiranë	Pezë	82	230	470	658	432
Tiranë	Tiranë	Prezë	250	995	282	101	160
Tiranë	Tiranë	Shëngjergj	-	66	132	179	234
Tiranë	Tiranë	Tiranë	1613	1523	1493	1554	1399
Tiranë	Tiranë	Vaqarr	377	676	818	936	536
Tiranë	Tiranë	Vorë	1123	2319	701	792	572
Tiranë	Tiranë	Zall Bastar	5	17	72	3	-
Tiranë	Tiranë	Zall Herr	203	145	259	189	166
		Mesatare	350	533	416	442	388
		Min.	-	17	-	3	-
		Maks.	1613	2319	1513	1554	1399
		Mesatarja Koefficienti i variacionit	232	252	282	284	303
			1,11	1,06	0,94	0,92	0,81

Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet e autorëve

d. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (toka bujqësore dhe ndërtesat).

Tabela 56. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Tiranë, krahasuar me mesataren kombëtare për banor

			2008	2009	2010	2011	2012
Tiranë	Kavajë	Golem	1002	1080	1184	744	1019
Tiranë	Kavajë	Gosë	318	563	449	308	573
Tiranë	Kavajë	Helmës	764	730	715	673	460
Tiranë	Kavajë	Kavajë	174	177	100	120	153
Tiranë	Kavajë	Kryevidh	1017	1143	1015	875	971
Tiranë	Kavajë	Lekaj	535	574	562	560	117
Tiranë	Kavajë	Luz i Vogël	594	487	636	659	827
Tiranë	Kavajë	Rrogzhinë	239	200	261	196	288
Tiranë	Kavajë	Sinaballaj	500	409	808	588	428
Tiranë	Kavajë	Synej	630	583	618	527	586
Tiranë	Tiranë	Baldushk	234	264	240	242	176
Tiranë	Tiranë	Bërshullë	256	259	149	179	268
Tiranë	Tiranë	Bërzhitë	272	384	106	131	252
Tiranë	Tiranë	Dajt	458	526	434	333	364
Tiranë	Tiranë	Farkë	529	224	234	228	957
Tiranë	Tiranë	Kamëz	421	316	422	490	493
Tiranë	Tiranë	Kashar	432	1241	2945	3516	3835
Tiranë	Tiranë	Krrabë	149	106	79	80	347
Tiranë	Tiranë	Ndroq	155	198	71	50	159
Tiranë	Tiranë	Paskuqan	106	103	67	77	180
Tiranë	Tiranë	Petrelë	651	316	304	480	626
Tiranë	Tiranë	Pezë	101	282	199	301	436
Tiranë	Tiranë	Prezë	430	386	1625	467	858
Tiranë	Tiranë	Shëngjergj	232	66	212	203	202
Tiranë	Tiranë	Tiranë	635	619	613	555	737
Tiranë	Tiranë	Vaqarr	250	813	1155	1211	1658
Tiranë	Tiranë	Vorë	481	660	1528	1633	2004
Tiranë	Tiranë	Zall Bastar	50	44	8	4	50
Tiranë	Tiranë	Zall Herr	209	254	135	70	118
Mesatare			408	449	582	534	660
Min.			50	44	8	4	50
Maks.			1017	1241	2945	3516	3835
Mesatarja Koefficienti i variacionit			421	384	422	333	436
			0,62	0,71	1,09	1,27	1,15

Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Performanca e NJQV-ve të Tiranës në lidhje me taksat e pasurisë ka ardhur në përmirësim çdo vit. Vlerat mesatare të të ardhurave nga taksat e pasurisë janë rritur, por ashtu si edhe vlerat minimale e maksimale. Gjithashtu, median është rritur në vitin 2012 pas rënies së një viti më parë: gjysma e njësive të Tiranës kanë të ardhura për frymë nga taksa e pasurisë mbi 436 lekë - vlera më e lartë në pesë vjet. Megjithatë, pabarazia në shpërndarje është rritur, çka tregon se jo të gjitha njësitë kanë ecur në të njëjtin drejtim. Për shembull, komuna

bregdetare me potencial në turizëm dhe vlera të larta treguese të taksës së pasurisë si Golemi e Kryevidhi kanë pasur ulje në realizim. Ndërkohë, njësitë me vlerat më të larta janë Kashari dhe Vora, që mund të shpjegohet edhe me përqendrimin e madh të bizneseve në këto zona. Bashkia e Tiranës ka realizim mjaft të dobët të taksës së pasurisë, që tregon vëmendje të pamjaftueshme të administratës në këtë drejtim. Si në të gjithë vendin, bashkitë më të mëdha nuk performojnë aq mirë sa njësitë mesatare për taksën e pasurisë.

12.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Tiranës është unik në Shqipëri, si nga shkalla, ashtu dhe diversiteti. Minibashkitë dhe ish-komunat e qytetit të Tiranës janë “qytete” në vetvete. Qarku Tiranë ka 29 njësi administrative. Popullsia e Tiranës sipas Census 2011 është 749 365 banorë rreth 26,75% e të gjithë popullsisë së Shqipërisë dhe është rreth 2,5 herë më e madhe se qarku i Fierit – i dyti për nga popullsia në Shqipëri.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun e Tiranës sipas gjinisë është 49,6% e popullsisë së qarkut janë meshkuj dhe afërsisht 50,4% femra.
- 284,68 persona që përfaqësojnë rreth 3,7% të popullsisë, janë persona me aftësi të kufizuara.
- Popullsia në moshë pune në qarkun e Tiranës është 69,7% të totalit të popullsisë së qarkut. Sipas të dhënave të katër mujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Tiranës janë 20 422 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 18,09 përfitojnë pagesë papunësie.
- Qarku i Tiranës ka shënuar një popullsi në rritje prej 28% në krahasim me 2001. Rritja më e madhe ka ndodhur në zonat urbane (45%) ndërsa zona rurale ka ardhur duke u tkurrur (-2%). Dendësia gjithashtu ka ardhur duke u rritur (28%).
- Tirana mbetet epiqendra e migrimit të brendshëm në Shqipëri. Qarku ka rreth 196 000 familje – 27% e numrit të familjeve në Shqipëri (722 262) dhe fëmijët (0 – 18 vjeç) shënojnë 27% të popullsisë.
- Ndërkohë që popullsia emigruese e cila është kthyer në qarkun e Tiranës është 39 320 persona, të kthyer prej vitit 2001 deri më 2011, ku 64,3% të të gjithë të kthyerve janë meshkuj. Çka thekson dhe karakterin gjinor të migrimit të jashtëm.
- Popullsia rinore (15 – 29 vjeç) është rreth 35% e popullsisë. Popullsia në moshë pune 15 – 64 është 509 mijë ose rreth 89%, ndërsa mosha e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 10%.
- Madhësia mesatare e familjes është me 3,7 persona.

Strehimi

- 196 218 familje, 170 229 në pronësi ose në proces pronësimi, 19 761 me qira, 6228 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Tiranës ka mesatarisht 2,86 dhoma.
- 3684 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 17 964 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 192 658 banesa të banuara) ose 11,2% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 6000 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 192 658 banesa të banuara) ose 3,1%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Tiranës shënon një nivel varfërie prej 14,2%. Thellësia e varfërisë është 2,8% dhe ashpërsia 0,8%. Këta tregues janë të ngjashëm me nivelin kombëtar të varfërisë (14,3%, 2,9% dhe 1%).
- Pak më shumë se 11 000 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Tiranës ose rreth 11% në rang vendi (viti 2010).
- Numri i familjeve në qarkun e Tiranës është 196 218, nga këta 14 338 familje trajtohen me Ndihmë Ekonomike, që e shprehur me përqindje përbën 13,5% të totalit të qarkut Tiranë.
- Koeficienti GINI për qarkun e Tiranës është 28,2%.
- Konsumi total për familje në qarkun e Tiranës është 533 349 (Lekë të vjetra) krahasuar me konsumin për person që është 131 489 (Lekë të vjetra).

Shëndetësia

- 7 spitale me 2190 shtretër, si dhe 369 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Tiranës kemi një numër total mjekësh prej 1013.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 15 minuta, ndërsa në zonat rurale diçka më e madhe, 19 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 16 minuta për jo të varfrit dhe 19 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 12 000 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 1,8%.

Shërbimet

Rreth 23% të institucioneve publike të shërbimit social dhe 34% të atyre jo publike janë në Tiranë; 92% e tyre ofrojnë shërbime në zonën urbanë të qarkut.

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	3	9 (+1)
Shërbime sociale për gra dhe vajza	1 ⁴	6
Shërbime sociale për fëmijët	4	21
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	1	29
Shërbime sociale për PAK	1	16
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	11
Gjithsej	10	92

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

13 Qarku Vlorë


Në këtë kapitull prezantohet një panoramë e situatës dhe performancës fiskale dhe financiare të NJQV-ve në qarkun e Vlorës. Kapitulli fillon me një profil të përgjithshëm të qarkut dhe njësive vendore që bëjnë pjesë në të, vazhdon me një analizë krahasimore mes NJQV-ve të qarkut duke evidentuar pabarazitë dhe dallimet mes njësive vendore, performancën e tyre financiare dhe fiskale, si dhe mundësitë dhe pamundësitë në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë mes njësive vendore.

13.1 Profili i qarkut Vlorë dhe pozicioni i NJQV-ve në qark

Qarku i Vlorës përbëhet prej 3 rretheve: Delvinë, Sarandë dhe Vlorë, si dhe 26 NJQV-ve të organizuara: 4 në rrethin e Delvinës, 9 në rrethin e Sarandës dhe 13 në rrethin e Vlorës. Qarku i Vlorës ka një popullsi prej 175 640 banorësh (në rrethin e Delvinës 11 717 banorë, në rrethin e Sarandës 37 798 banorë dhe në rrethin e Vlorës 126 125 banorë) (INSTAT, Census 2011).

⁴ Qendra Antitrafik (nivel kombëtar)

Figura 54. NJQV-të në qarkun e Vlorës sipas popullsisë



Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Këto shifra paraqiten konsiderueshëm më të ulura (rreth 54% më pak) referuar të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas të cilit në janar 2012 popullsia e qarkut të Vlorës rezultoi 374 675 banorë (në rrethin e Delvinës 31 405 banorë, në rrethin e Sarandës 99 106 banorë dhe në rrethin e Vlorës 244 164 banorë).

Tabela 17. Diferenca mes popullsisë sipas INSTAT-it dhe RGJC-së në 2011 për qarkun Vlorë

RRETHI	NJQV-ja	INSTAT 2011	RGJC 2011	DIFERENCA
Delvinë	Delvinë	5754	14 214	-8460
Delvinë	Finiq	1333	6782	-5449
Delvinë	Mesopotan	2786	6363	-3577
Delvinë	Vergo	1844	4046	-2202
Total Delvinë		11 717	31 405	-19 688
Sarandë	Aliko	3849	8812	-4963
Sarandë	Dhivër	1396	6589	-5193
Sarandë	Konispol	2123	3072	-949
Sarandë	Ksamil	2994	9224	-6230
Sarandë	Livadhja	1165	10 417	-9252
Sarandë	Lukovë	2916	9609	-6693
Sarandë	Markat	1859	3074	-1215
Sarandë	Sarandë	17 233	40 744	-23 511
Sarandë	Xarë	4263	7565	-3302
Total Sarandë		37 798	99 106	-61 308
Vlorë	Armen	2965	6819	-3854
Vlorë	Brataj	2849	5003	-2154
Vlorë	Himarë	2822	13 250	-10 428
Vlorë	Kotë	3516	6504	-2988
Vlorë	Novoselë	8209	16 593	-8384
Vlorë	Orikum	5503	11 511	-6008
Vlorë	Qendër	7621	18 430	-10 809
Vlorë	Selenice	2235	6957	-4722
Vlorë	Sevaster	1720	3238	-1518
Vlorë	Shushicë	3981	9443	-5462
Vlorë	Vllahine	3111	7266	-4155
Vlorë	Vlorë	79 513	135 065	-55 552
Vlorë	Vranisht	2080	4085	-2005
TOTAL VLORË		126 125	244 164	-118 039
TOTAL QARKU VLORË		175 640	374 675	-199 035

Burimi: INSTAT, Census 2011; RGJC 2012 dhe Llogaritjet e autorëve

Popullsia e qarkut Vlorë përbën rreth 6,27% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 6755 banorë/NJQV. Kjo mesatare është rreth 15% më e ulët se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV). Nisur nga morfologjia e territorit, por edhe lëvizjet migratore e demografike të viteve të fundit rreth 77% e NJQV-ve kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë dhe vetëm 8% e NJQV-ve kanë popullsi më të lartë se 10 000 banorë (Saranda 17 233 banorë dhe Vlora 79 513 banorë).

Tabela 18. Klasifikimi i NJQV-ve të qarkut Vlorë sipas numrit të popullsisë krahasuar me shifrat në nivel vendi


Klasifikimi i NJQV-ve sipas numrit të popullsisë	Vlorë	Shqipëria
Popullsia	6,27%	100,00%
Popullsia mesatare për NJQV	6,755	8,016
< 2000	23,08%	27,61%
2000-5000	53,85%	34,58%
5000-10 000	15,38%	26,27%
10 000-20 000	3,85%	6,70%
20 000-30 000	0,00%	1,61%
30 000-50 000	0,00%	1,07%
50 000-100 000	3,85%	1,61%
100 000-200 000	0,00%	0,27%
> 200 000	0,00%	0,27%

Burimi: INSTAT, Census 2011; Llogaritjet e autorëve

Dendësia mesatare e popullsisë është 174 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Vlora (2900 banorë/km²) dhe Saranda (483 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësi më të lartë, ndërsa komuna Livadhja (6,79 banorë/km²) është njësia me dendësinë më të ulët. Me dendësi të ulët janë edhe njësitë Vergo, Dhivër, Sevaster, Orikum e Lukovë.

Njësitë vendore të qarkut Vlorë zënë rreth 8,4% të totalit të shpenzimeve vendore, ose 0,21% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve vihet re në vitin 2010 – rreth 9,6% e buxhetit vendor krahasuar me 8,2% në vitin 2012. Tendenca e shpenzimeve të NJQV-ve të qarkut Vlorë është disi e ndryshme prej pjesës më të madhe të qarqeve, në të cilat vihet re në nivelin më i lartë i shpenzimeve gjatë vitit 2009 dhe rënie e ndjeshme e tyre gjatë viteve 2010 - 2012.

Figura 55. Shpenzimet e NJQV-ve të qarkut Vlorë krahasuar me shpenzimet e përgjithshme vendore




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Pjesa më e madhe e shpenzimeve në të gjitha NJQV-të e qarkut shkon për shpenzime operative – mesatarisht gjatë viteve 2008 – 2012 rreth 64%, nga të cilat pagat dhe sigurimet përbëjnë 26% ose mesatarisht 6,8% të totalit të shpenzimeve vendore në Shqipëri.

Shpenzimet kapitale kanë pësuar njëfarë rritje në raport me shpenzimet operative gjatë viteve 2009 dhe 2010, por fillojnë të bien në 2011, për të arritur nivelin më të ulët prej vetëm 27,5% të totalit të shpenzimeve në nivel qarku në vitin 2012.

Ndërkohë, shpenzimet për paga dhe sigurime arrijnë nivelin më të lartë si në përqindje ashtu edhe në vlerë nominale në vitin 2011 – 29,7% e totalit të shpenzimeve vendore. Pjesa që zënë pagat dhe sigurimet në totalin e shpenzimeve të NJQV-ve të qarkut Vlorë është ndër më të ulëtat krahasuar me qarqet e tjera.


Figura 56. Shpenzimet kapitale në raport me shpenzimet operative në NJQV-të e qarkut Vlorë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Vlorë përbëjnë rreth 10,8% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Ato ndjekin të njëjtin trend të shpenzimeve të NJQV-ve të qarkut, duke pësuar një rritje në vitin 2010 për të vazhduar pastaj me trendin rënës gjatë viteve 2011 - 2012.

Figura 57. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Vlorë kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Vlorë përbëhen në një pjesë të konsiderueshme (thuhet 42,5%) prej të ardhurave të veta të NJQV-ve. Të ardhurat nga grantet e pakushtëzuara përbëjnë rreth 29% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Vlorë, ndërsa të ardhurat nga

transfertat e kushtëzuara kanë përbërë nga 14% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 35% të këtij totali në vitin 2011. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2011 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin.

Figura 58. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Vlorës




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

13.2 Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Vlorë

Për të vlerësuar pabarazitë dhe dallimet që ekzistojnë mes NJQV-ve të qarkut Vlorë, veçanërisht në lidhje me situatën financiare dhe fiskale, do të shikojmë një sërë treguesish, që kanë të bëjnë me:

- a. Buxhetin vendor të NJQV-së në raport me mesataren e buxhetit vendor të NJQV-ve të qarkut.


Tabela 19. Raporti mes buxheteve të NJQV-ve me mesataren e buxheteve të NJQV-ve të qarkut Vlorë



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

- b. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor.


Tabela 20. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor (në qarkun Vlorë) krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve në Shqipëri për banor



Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

- c. Shpenzimet e NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e shpenzimeve të NJQV-ve në Shqipëri për banor.

Tabela 21. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor (në qarkun Vlorë) krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve për banor të NJQV-ve




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet e autorëve

Duke iu referuar të tre treguesve të zhvilluar në grafikët më sipër evidentojmë një numër të konsiderueshëm prej NJQV-ve të qarkut Vlorë, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë me NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banor, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banor. Të tilla janë komunat Brataj, Markat, Vllahinë, Dhivër, Vergo, Mesopotam etj.

13.3 Performanca financiare dhe fiskale e NJQV-ve të qarkut Vlorë

Le të shohim sesi prezantohen në nivel të të ardhurave dhe shpenzimeve për frymë NJQV-të e qarkut Vlorë.

Figura 59. Të ardhurat dhe shpenzimet për banor në NJQV-të e qarkut Vlorë (2008 – 2011)



Të ardhurat totale/banorë


Shpenzimet totale / banorë

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Mesatarja e të ardhurave për banor në NJQV-të e qarkut Vlorë është rreth 54,91 Euro në vitin 2011, krahasuar me 68 Euro në nivel vendi. E ardhura më e lartë për banor rezulton në Sarandë dhe Himarë (respektivisht 101,63 dhe 87,57 Euro/banor), ndërsa më e ulëta në Finiq, Aliko dhe Qendër (rreth 35 Euro/banor).

Thuajse i njëjti trend vihet re edhe në shpërndarjen e shpenzimeve vendore për banor.

Figura 60. Shpenzimet totale për banor krahasuar me të ardhurat e veta të NJQV-së për banor në qarkun e Vlorës



Shpenzimet totale/banor


Të ardhurat e veta të NJQV-së/banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet tona

Referuar hartës për të ardhurat e veta të NJQV-së/banor, vazhdon të ruhet dhe në njësitë e këtij qarku një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësia vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 16,07 Euro/banor (Aliko) në 68,28 Euro/banor (Himarë), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga 3,1 Euro/banor (Markat) në 119,38 Euro/banor (Himarë).

Le të shohim se çfarë ndodh në lidhje me investimet kapitale në NJQV-të e qarkut Vlorë, duke përdorur si bazë krahasimore sërish investimet kapitale për banor në NJQV të ndryshme.

Figura 61. Investimet kapitale krahasuar me shpenzimet totale të NJQV-ve dhe grantet e kushtëzuara për banor në NJQV-të e qarkut Vlorë



Investimet kapitale/Totalin e Shpenzimeve


Grantet e kushtëzuara/banor

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësive të qeverisjes vendore (Shushicë, Vllahinë, Hore - Vranisht, Mesopotam, Aliko, Livadhja, etj). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, NJQV-të në qarkun e Vlorës shpenzuan mesatarisht 12,7 Euro/banor për investime kapitale, ndërkohë që mesatarja në rang vendi është 14,3 Euro/banor. Dhjetë NJQV shpenzuan gjatë këtij viti më tepër sesa mesatarja në nivel vendi për banor për investime kapitale (Mesopotam, Sarandë, Ksamil, Vlorë, Orikum, Himarë, Novoselë, Brataj, Horë Vranisht dhe Vllahinë). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme lexohet qartë që në një pjesë të NJQV-ve investimet kapitale janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara (Vllahinë, Horë Vranisht, Brataj, Mesopotam).

Mesatarja e granteve të kushtëzuara për banor në NJQV-të e Vlorës është rreth 21,73 Euro/banor në vitin 2011, krahasuar me mesataren kombëtare prej rreth 30 Euro/banor. Duke iu referuar gjithmonë vitit 2011, nivelin më të ulët të granteve të kushtëzuara për banor e ka bashkia Himarë (8,67 Euro/banor) dhe nivelin më të lartë komnat Sevaster, Hore Vranisht dhe Bashkia Delvinë (rreth 30-35 Euro/banor)

Figura 62. Shpenzimet operative dhe shpenzimet për paga e sigurime të NJQV-ve të qarkut Vlorë



Shpenzimet operative / Shpenzimet totale

Shpenzimet për paga e sigurime/ shpenzimet operative

Burimi: Ministria e Financave; INSTAT; Llogaritjet e autorëve

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Vlorë zënë mesatarisht 70% të totalit të shpenzimeve, diçka më lart krahasuar me mesataren në nivel vendi prej 66%. Ndërkohë që për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në mbi 90% të buxhetit vendor (Finiq, Lukovë, Dhivër, Xarë dhe Aliko). Kjo lidhet me faktin se këto njësi jo vetëm që nuk kanë pasur mundësi për të kryer investime kapitale me të ardhurat e tyre, por nuk kanë pasur akses as në grantet konkurruese (FZHR) apo nuk kanë përfituar grante të tjera të kushtëzuara.


Ndërkohë që shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Vlorë mesatarisht 64%, raport gati 9% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Aliko, Selenicë, Vllahinë, Armen etj.).

13.4 Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Vlorë

Disa prej treguesve që mund të konsiderojmë për të vlerësuar klimën dhe mundësinë për zhvillim ekonomik që ofron një NJQV, janë listuar më poshtë dhe do të shtjellohen më tej në dokument.

- a. Të ardhurat nga taksat e biznesit për banor (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Tabela 22. Taksa e biznesit të vogël (TBV) për banor sipas NJQV-ve të qarkut Vlorë krahasuar me mesataren për banor në nivel kombëtar




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Referuar këtij treguesi janë fare pak NJQV në qarkun Vlorë që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banor prej biznesit. Ato janë Sarandë, Konispol, Vlorë e Orikum.

Le të shikojmë edhe treguesit e tjerë për të vlerësuar se cilat prej NJQV-ve të qarkut të Vlorës mundësojnë kushte për zhvillimin ekonomik e cilat jo.

- b. Të ardhurat nga taksat e pasurisë (tokë dhe ndërtesë), nga taksa e automjeteve, etj.

Tabela 23. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banor sipas NJQV-ve të qarkut Vlorë, krahasuar me mesataren kombëtare për banor




Burimi: Ministria e Financave; Llogaritjet tona

Pak NJQV rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë (Mesopotam, Sarandë, Konispol, Xarë, Aliko, Orikum, Qendër etj.). Komuna Xarë duket se ka një performancë më të mirë në grumbullimin e të ardhurave prej taksës së pasurisë krahasuar me NJQV-të e qarkut Vlorë.


- c. Numri i bizneseve sipas njësive të qeverisjes vendore; numri i bizneseve për banorë.

Figura 63. Numri i bizneseve dhe lloji i aktiviteteve sipas NJQV-ve në qarkun Vlorë



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet e autorëve

Figura 64. Numri i bizneseve për 1000 banorë në NJQV-të e qarkut Vlorë



Burimi: INSTAT 2012, Llogaritjet tona

Duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në qarkun e Vlorës dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t’ju ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitet më të theksuar janë Vlora, Orikumi, Himara, Saranda, Delvina etj.

13.5 Profili social

Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Vlorës ka 26 njësi administrative. Popullsia është 173 130 banorë.
- Qarku i Vlorës gjithashtu ka pësuar rënie të lehtë në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-10%). Zonat urbane kanë pësuar rritje me (12,6%), ndërsa ato rurale një rënie me -37%. Dendësia gjithashtu ka rënë (-10%).
- Qarku i Vlorës numëron 50 961 familje.
- Popullsia në moshë pune është 118 192 ose 67,3% të totalit të popullsisë së qarkut. Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun Vlorë janë 6941 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 1372 përfitojnë pagesë papunësie.
- Popullsia emigruese e kthyer në vend janë 17,609 persona, ku 62% e të gjithë të kthyerve janë meshkuj.

Strehimi

- 50 961 familje, 45 136 në pronësi ose në proces pronësimi, 3824 me qira, 2001 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Vlorës ka mesatarisht 2,8 dhoma.
- 980 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 2397 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 50 566 banesa të banuara) ose rreth 6,67% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 2028 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 50 566 banesa të banuara) ose 4%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Vlorës shënon një nivel varfërie prej 11,7%. Thellësia e varfërisë është 2,4% dhe ashpërsia 0,8%. Tregues të kënaqshëm krahasuar me vlerat kombëtare.
- Nga ana tjetër 1932 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Vlorës ose rreth 2% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 3,8% të totalit të familjeve – përsëri tregues të kënaqshëm.
- Koeficienti GINI për qarkun e Vlorës është 26,8.
- Konsumi total për familje në këtë qark është 46 885 lekë krahasuar me konsumin për person që është 12 517 lekë.

Shëndetësia

- 10 319 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 7,8%.
- 4 spitale me 706 shtretër, si dhe 128 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Vlorës kemi një numër total mjekësh prej 256.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 17 minuta, ndërsa në zonat rurale 20 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 18 minuta për jo të varfrit dhe 18 minuta për të varfrit.

Arsimi

- Rreth 4242 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 2,7%.

Shërbimet

	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	2	
Shërbime sociale për gra dhe vajza		
Shërbime sociale për fëmijët	2	1
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	1	1
Shërbime sociale për PAK	1	
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	1	
Gjithsej	7	2

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

13.6 Përfundime

Popullsia e qarkut Vlorë përbën rreth 6,27% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 6755 banorë/NJQV. Kjo mesatare është rreth 15% më e ulët se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8016 banorë/NJQV). Nisur nga morfologjia e territorit por edhe lëvizjet migratore e demografike të viteve të fundit rreth 77% e NJQV-ve kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë dhe vetëm 8% e NJQV-ve kanë popullsi më të lartë se 10 000 banorë (Saranda 17 233 banorë dhe Vlora 79 513 banorë).

Dendësia mesatare e popullsisë është 174 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Vlora (2900 banorë/km²) dhe Saranda (483 banorë/km²) janë njësitë vendore me dendësinë më të lartë, ndërsa komuna Livadhja (6,79 banorë/km²) është njësia me dendësinë më të ulët. Me dendësi të ulët janë edhe njësitë Vergo, Dhivër, Sevaster, Orikum e Lukovë.

Njësitë vendore të qarkut Vlorë zënë rreth 8,4% të totalit të shpenzimeve vendore ose 0,21% të PBB-së. Niveli më i lartë i shpenzimeve vihet re në vitin 2010 – rreth 9,6% e buxhetit vendor krahasuar me 8,2% në vitin 2012.

Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Vlorë përbëhen në një pjesë të konsiderueshme (thuajse 42,5%) prej të ardhurave të veta të NJQV-ve. Të ardhurat nga grantet e pakushtëzuara përbëjnë rreth 29% të të ardhurave të NJQV-ve të qarkut Vlorë, ndërsa të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara kanë përbërë nga 14% të totalit të të ardhurave vendore në vitin 2008, në 35% të këtij totali në vitin 2011. Rritja e vlerës së transfertës së kushtëzuar gjatë viteve 2009 - 2011 ndjek pak a shumë të njëjtën tendencë në të gjithë vendin.

Pabarazitë dhe dallimet mes NJQV-ve të qarkut Vlorë: janë evidentuar një numër i konsiderueshëm prej NJQV të qarkut Vlorë, të cilat na prezantohen në pozitë të pabarabartë më NJQV-të e tjera të qarkut. Këto NJQV rezultojnë të kenë një nivel të ulët të të ardhurave të gjeneruara prej NJQV-së për banorë, por njëkohësisht nuk arrijnë as nivelin mesatar të shpenzimeve mesatare të NJQV-ve në rang vendi për banorë. Të tilla janë komunat Brataj, Markat, Vllahinë, Dhivër, Vergo, Mesopotam etj.

Performanca financiare dhe fiskale: vihet re se vazhdon të ruhet dhe në njësitë e këtij qarku një korrelacion pozitiv mes numrit të banorëve të NJQV-së dhe të ardhurave për banor të gjeneruar nga vetë njësi vendore. Por ndërkohë, kur krahasojmë të dhënat me shpenzimet për banor sipas NJQV-ve vëmë re se ky korrelacion nuk ruhet. Pra, ndërkohë që shpenzimet totale për banor variojnë nga 16,07 Euro/banor (Aliko) në 68,28 Euro/banor (Himarë), të ardhurat e veta të NJQV-ve variojnë nga 3,1 Euro/banor (Markat) në 119,38 Euro/banor (Himarë).

Niveli i investimeve kapitale për banor varion nga një vit në tjetrin, veçanërisht në një pjesë të njësisive të qeverisjes vendore (Shushicë, Vllahinë, Hore-Vranisht, Mesopotam, Aliko, Livadhja etj.). Po ashtu, ky nivel varion nga një njësi vendore në tjetrën. Për vitin 2011, NJQV-të në qarkun e Vlorës shpenzuan mesatarisht 12,7 Euro/banor për investime kapitale, ndërkohë që mesatarja në rang vendi është 14,3 Euro/banor. Dhjetë NJQV shpenzuan gjatë këtij viti më tepër se mesatarja në nivel vendi për banorë për investime kapitale (Mesopotam, Sarandë, Ksamil, Vlorë, Orikum, Himarë, Novoselë, Brataj, Hore-Vranisht dhe Vllahinë). Duke iu referuar të ardhurave të veta të NJQV-ve të mësipërme lexohet qartë që në një pjesë të NJQV-ve investimet kapitale janë bërë nëpërmjet granteve të kushtëzuara (Vllahinë, Hore-Vranisht, Brataj, Mesopotam).

Në vitin 2011, shpenzimet operative të NJQV-ve të qarkut Vlorë zënë mesatarisht 70% të totalit të shpenzimeve, diçka më lartë krahasuar me mesataren në nivel vendi prej 66%. Ndërkohë që për disa njësi shpenzimet operative gjatë vitit 2011 rezultojnë në mbi 90% të buxhetit vendor (Finiq, Lukovë, Dhivër, Xarë dhe Aliko). Kjo lidhet me faktin se këto njësi jo vetëm që nuk kanë pasur mundësi për të kryer investime kapitale me të ardhurat e tyre, por nuk kanë pasur akses as në grantet konkurruese (FZHR) apo nuk kanë përfituar grante të tjera të kushtëzuara.

Ndërkohë që shpenzimet për paga e sigurime në raport me shpenzimet operative zënë në NJQV-të e qarkut Vlorë mesatarisht 64%, raport gati 9% më i lartë se mesatarja në nivel vendi po për vitin 2011. Në disa prej NJQV-ve vlerat e këtij raporti janë edhe më të larta (si p.sh. në Aliko, Selenicë, Vllahinë, Armen etj.).

Konkurreshmëria mes NJQV-ve dhe mundësia për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor: Janë fare pak NJQV në qarkun Vlorë që arrijnë të gjenerojnë të ardhura të krahasueshme për banorë prej biznesit. Ato janë Saranda, Konispoli, Vlorë dhe Orikumi. Pak NJQV rezultojnë të gjenerojnë të ardhura më të larta se ato mesatare në nivel kombëtar nga taksat mbi pasurinë (Mesopotam, Sarandë, Konispol, Xarë, Aliko, Orikum, Qendër, etj). Komuna Xarë duket se ka një performancë më të mirë në grumbullimin e të ardhurave prej taksës së pasurisë krahasuar me NJQV-të e qarkut Vlorë. Së fundmi, duke iu referuar shpërndarjes së bizneseve në NJQV-të në këtë qark dhe duke e lidhur atë me infrastrukturën dhe mundësitë që NJQV-të kanë për t'ju ofruar shërbimet e nevojshme bizneseve, mund të themi se qendrat me aktivitet më të theksuar janë Vlorë, Orikumi, Himara, Saranda, Delvina, etj.

II Përfundime

Niveli i parë i qeverisjes vendore në Shqipëri përfaqësohet nga 65 bashki dhe 308 komuna. Bashkitë dhe komunat kanë funksione, kompetenca dhe përgjegjësi të barasvlershme. Ligji organik për qeverisjen vendore përcakton qartë funksionet dhe përgjegjësitë e bashkive dhe komunave, të përkufizuara si funksione të vetat (ekskluzive), funksione të përbashkëta, dhe të deleguara.

Madhësia nga pikëpamja e popullsisë e bashkive/komunave luhet shumë. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë (Census) 2011, ka 330 njësi (88%) me popullsi më të vogël se 10 000 banorë, ndërkohë që 232 njësi (62%) kanë popullsi më të vogël se 5000 banorë. Popullsia mesatare për komunat është 4300, ndërkohë që gjysma e komunave kanë popullsi më të ulët se 3100 banorë. Rreth 53% e popullsisë jeton në bashki, ndërkohë që 64% e popullsisë urbane (ose 34% e popullsisë gjithsej) jeton në 8 qytetet më të mëdha të vendit – Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Kamëz, Fier dhe Korçë. Vetëm 15 njësi të qeverisjes vendore kanë popullsi më të madhe se 20 000 banorë. Mesatarja e banorëve në bashki është 22 600 banorë, por mbi gjysma e bashkive kanë popullsi më të vogël se 7800 banorë.

Numri i njësive të qeverisjes vendore është relativisht i lartë, ndaj është e kuptueshme që ka luhata dhe pabarazi të larta mes tyre për sa u përket kapaciteteve lokale, aftësisë për mobilizimin e të ardhurave si edhe ofrimit të shërbimeve. Tema e konsolidimit të njësive të qeverisjes vendore është ripërtërirë në mënyrë të vazhdueshme nga aktorë e politikëbërës të ndryshëm që nga viti 2003, por nuk ka qenë e qartë nëse do të kishte vërtet të mira e përfitime për sa u përket kursimeve në kosto administrative apo potencialet më të mira për zhvillim ekonomik.

Ngritja e kapaciteteve në nivel vendor është një shqetësim tjetër i arsyeshëm, sidomos duke marrë në konsideratë faktin se shumë njësi vendore ndodhen në zona të largëta e nuk janë në gjendje të tërheqin punonjës të kualifikuar. Shumë njësi vendore, në veçanti bashkitë, kanë përfituar nga programe asistence teknike dhe trajnimesh nga një sërë donatorësh. Është e vështirë të arrihet në një përfundim të vetëm për cilësinë e administratës lokale në përgjithësi, pasi kjo e fundit varet nga konteksti lokal dhe nevojat e përparësitë e çdo komuniteti. Administrata bashkiake (dhe ajo komunale pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për shërbimin civil) është pjesë e shërbimit civil, çka përveç cilësisë së personelit nënkupton edhe kosto shtesë për rekrutimin, trajtimin si edhe standardet e kualifikimit. Kjo nuk do të thotë se ndryshimi në cilësi mes bashkive e komunave është po kaq i qartë dhe i mprehtë: edhe ndërmjet këtyre dy kategorive ekzistojnë asimetri të mëdha.

Vetëm popullsia nuk është kriter për të bërë dallimin mes bashkive e komunave, pasi ka shumë komuna me popullsi disa herë më të madhe se disa bashki. Gjithashtu, një numër i madh bashkish (ashtu edhe komuna), kanë përjetuar një reduktim të ndjeshëm të popullsisë për shkak të lëvizjeve demografike, ndërkohë që mjaft komuna, në veçanti ato në afërsi të qyteteve të mëdha apo në zonat me aktivitet industrial më të theksuar kanë potencial të mirë rritjeje dhe mundësi të tërheqin personel më të kualifikuar.

Bashkitë dhe komunat janë niveli i parë i qeverisjes vendore, të cilat kanë kompetenca të plota në fushat administrative, rregullatore, atë të shërbimeve dhe investimeve mbi funksionet e veta (ekskluzive), ku përfshihen një gamë e gjerë shërbimesh publike vendore – shërbimet komunale, si dhe ato të zhvillimit ekonomik dhe shërbimet shoqërore dhe kulturore. Sot bashkitë dhe komunat ushtrojnë një gamë të gjerë funksionesh ekskluzive, që nga ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe menaxhimi i mbeturinave, deri tek funksionet shoqërore dhe argëtuese.

Bashkitë dhe komunat kanë gjithashtu përgjegjësi të përbashkët për disa funksione të tjera si mirëmbajtja dhe investimet në objektet e arsimit parauniversitar, si dhe asistencën shoqërore dhe lehtësimin e varfërisë.

Në kushtet e “konkurrencës” për fonde buxhetore dhe të kapacitetit modest për gjenerimin e të ardhurave lokale, njësitë e qeverisjes vendore vazhdojnë të kenë mungesa të mëdha burimesh për investime, veçanërisht për ato që kërkojnë kapitale të mëdha, si infrastruktura rrugore dhe ajo e ujësjellës-kanalizimeve. Si pasojë e fragmentarizimit të NJQV-ve, buxhetet e tyre janë në përgjithësi të vogla dhe nuk mund të përballojnë financimin për projekte të mëdha përmirësimi infrastrukture.

Pavarësisht nga rritja në shifra absolute e të ardhurave të pushtetit vendor në krahasim me vitet e para të decentralizimit, pesha e tij specifike ndaj buxhetit të shtetit dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto ka rënë në vazhdimësi. Të ardhurat e veta të njësitë të pushtetit vendor kanë ardhur gjithashtu në ulje të lehtë që nga viti 2009. Ndryshimet në kuadrin ligjor për sistemin e taksave vendore⁵, që cenonin autoritetin fiskal vendor duke ulur ndjeshëm diskrecionin vendor në vendosjen e disa taksave si dhe duke kufizuar barrën fiskale nga disa taksa të tjera vendore në jo më shumë se 10% të nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, patën efekte të mëdha në potencialin e të ardhurave nga burimet e veta.

Ndonëse pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor nuk ka ndryshuar shumë në terma relativë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe buxhetit të shtetit, ato janë rritur në mënyrë konstante nga viti në vit. Është e rëndësishme të theksohet që përqindja e shpenzimeve të pakushtëzuara ndaj totalit të shpenzimeve të buxhetit vendor është rritur në mënyrë të ndjeshme, nga rreth 45% në vitin 2005, në rreth 57% në vitin 2009 e 61% në vitin 2012, çka dëshmon për diskrecionin në rritje të vendimmarrjes. Por këto të dhëna duhet të trajtohen me kujdes: rritja e diskrecionit është përqendruar qartë në qytetet e mëdha që përfitojnë si shkak i madhësisë dhe popullsisë, ndërkohë që shumica dërrmuese e njësitë vendore kanë varësi absolute ndaj të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare, kjo për shkak të fragmentarizimit të këtyre njësive që kanë popullsi shumë të vogël dhe kriter kryesor për ndarjen e grantit të pakushtëzuar është popullsia.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve të buxhetit vendor janë shpenzime për personelin, ndjekur nga shpenzime operative dhe mirëmbajtjeje. Shpenzimet e personelit në nivel total të qeverisjes vendore zënë 37%, por në pjesën dërrmuese të 308 komunave kjo shifër i kalon 60% të buxhetit vendor. Komunat mesatarisht kanë 12 vetë personel, nga të cilët rreth 80% janë staf administrativ që kryejnë shërbime mbështetëse dhe vetëm 20% janë staf që janë të punësuar në shërbime publike direkte për qytetarët. Kjo kam sjellë një mos efikasitet të theksuar kryesisht të administratave në nivel komune, për shkak qartazi të fragmentarizimit. Kostoja e lartë e shpenzimeve të personelit administrativ mbështetës, është e shoqëruar edhe me kosto të lartë shpenzimeve operative për funksionimin e zyrave. Kostoja për njësi në këto raste është dy herë më e lartë se në njësitë e mëdha.

Në njësitë e mëdha vendore raporti i shpenzimeve të personelit është gjithashtu i lartë në fashën 20%-50%, por në dallim me njësitë e vogla, kjo kosto shpërndahet në shpenzime personeli për shërbime direkte për qytetarët, ndërsa kostot administrative për funksionet mbështetëse janë më të ulta për njësi.

⁵ Ligji nr. 10117, datë 23.04.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar

Këto përfundime janë në të njëjtën linjë edhe me analizat e kryera në nivel evropian ku është vërtetuar se kostot administrative për njësi, vijnë duke u ulur me rritjen e popullsisë në segmentin e njësive bendore nga 25000 deri në 250000 banorë dhe mbi këtë shifër fillojnë të ngrihen sërish.

Pesha e investimeve nga fondet e pakushtëzuara të buxhetit vendor (të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar) është rritur që nga vitet 2002, kur ishte më pak se ¼, në rreth pothuaj 45% në vitin 2009, por është ulur në mënyrë drastike sërish në vitet e fundit (26% në 2012). Megjithatë, buxhetet nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta shërbejnë kryesisht për të financuar ndërhyrje relativisht modeste në infrastrukturën vendore (pjesa dërrmuese ndërhyrje në rrugë); ndërkohë që për investime më të mëdha pjesa dërrmuese e njësive vendore varen nga transfertat nga buxheti i shtetit.

Ka pabarazi shumë të mëdha në nivelet e realizimit të të ardhurave mes njësive të ndryshme vendore. Kryeqyteti dhe shtatë qytetet më të mëdha të vendit⁶ realizojnë pjesën dërrmuese të të ardhurave të veta, me një peshë specifike prej 73% në vitin 2012. Pesha specifike e qyteteve më të mëdha është rritur nga rreth 53% në vitin 2006, çka tregon se njësitë më të mëdha vendore kanë përparësi në sistemin aktual, pavarësisht vështirësive të viteve të fundit. Përqëndrimi ekonomik në qytetet e mëdha, ka sjellë uljen e kapacitetit fiskal dhe pabarazi fiskale të theksuar midis njësive të mëdha dhe atyre të vogla. Kjo mund të korrektohet me rishpërndarjen fiskale që vjen nga riorganizimi territorial i njësive vendore.

Shpërndarja për frymë e të ardhurave tatimore lokale, një tregues më i saktë për të parë pabarazitë, gjithashtu tregon luhajtje të mëdha në shpërndarje.

Koeficienti i variacionit për gjithë të ardhurat tatimore është mjaft i lartë (1,22). Shpërndarja më normale vërehet për taksën e biznesit të vogël dhe tarifën e pastrimit. Shpërndarja për frymë e të ardhurave bëhet më e barabartë për të ardhurat totale lokale, çka tregon se sistemi i transfertave i arrin deri diku qëllimet e ekualizimit. Mbi 70% e taksës së biznesit të vogël dhe 80% e tarifës së pastrimit mbledhet në tetë njësitë më të mëdha të vendit. Pas ekualizimit shpërndarja e të ardhurave bëhet më uniforme.

Në përfundim theksojmë:

1. Ndryshimet demografike të dekadës së fundit kanë sjellë ndryshime të ndryshme edhe në madhësinë e NJQV-ve, duke rritur presionin e zhvillimit mbi qendrat e mëdha urbane dhe duke rritur koston administrative për njësi në NJQV-të e vogla.
2. Niveli i lartë i fragmentimit të NJQV-ve ka penguar thellimin e mëtejshëm të decentralizimit, si rezultat i mungesës së kapaciteteve dhe pamundësisë për të ofruar shërbime me efikasitet të lartë. Kjo është arsyeja kryesore e nevojës dhe avantazhit nga riorganizimi administrativo-territorial.
3. Niveli i lartë i fragmentimit të NJQV-ve ka bërë që edhe demokratizimi i qeverisjes, që ishte objektivi kryesor i ndarjes territoriale të vitit 2000, të mos rezultojë i suksesshëm, duke sjellë deformime dhe disbalanca në përfaqësim dhe legjitimitetin demokratik të përfaqësuesve vendorë.
4. Procesi i decentralizimit të qeverisjes gjithashtu ka bërë hapa mbrapa. Ai ka rezultuar asimetrik në nivel vendor duke krijuar pabarazi mes NJQV-ve në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Është evidentuar qartazi se vetëm 15% e NJQV-ve (që përkohë me njësitë e mëdha vendore) kryejnë paketën e plotë të funksioneve dhe kompetencave sipas ligjit organik 8652.

⁶ Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë, Kamëz

5. Fragmentimi i NJQV-ve ka sjellë dhe fragmentimin e shërbimeve publike (transporti publik, ujësjellësi, trajtimi i mbetjeve urbane, etj.), kryesisht si rezultat i potencialit të ulët të NJQV-ve për të gjeneruar të ardhura dhe kryer investime.
6. Fragmentimi i NJQV-ve i pasuar edhe nga procesi i lënë përgjysmë i decentralizimit ka krijuar një sërë pabarazish të ndjeshme mes NJQV-ve, të cilat pavarësisht disa përpjekjeve për t'u adresuar nëpërmjet granteve ekualizuese kanë nevojë të zgjidhen përfundimisht, nëpërmjet reformës administrativo-teritoriale.
7. Nevoja për konsolidim të komunave/bashkive për të garantuar efikasitet në shërbime dhe demokratizim më të madh, vjen si emergjencë në kushtet e fragmentarizimit të lartë.
8. Ka nevojë për rishikimin e bazës ligjore që përcakton qartë përgjegjësitë në funksionet e përbashkëta, shoqëruar me faturë financiare, dhe që mundëson efikasitetin ekonomik.
9. Nevojë për të saktësuar kufijtë territorialë në përputhje me të gjithë faktorët e ndarjes administrativo-teritoriale.